

ASPEKTE TEORIKE DHE PRAKTIKE TË QEVERISJES DHE PËRGJEGJËSISË SOCIALE TË KORPORATAVE STUDIM KRAHASIMOR MES KOSOVËS, SHQIPËRISË DHE KROACISË

Doktoranti

Kemajl ADEMAJ

Dorëzuar

Universitetit European të Tiranës

Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës
në Shkenca Juridike, me profil e Drejtë Biznesi,
për marrjen e gradës shkencore “Doktor”

Udhëheqës shkencor:

Prof. Dr. Riza SMAKA

Numri i fjalëve: 51.038

Tiranë 2018

DEKLARATA E AUTORËSISË

Nën përgjegjësinë time personale, deklaroj se ky studim është punë origjinale dhe nuk përmban plagjiaturë. Punimi është shkruar prej meje, nuk është prezantuar asnjëherë para një institucioni tjetër për vlerësim dhe nuk është botuar i tëri ose pjesë të veçanta të tij. Punimi nuk përmban material të shkruar nga ndonjë person tjetër, përveç rasteve të cituara dhe të referuara.

Kemajl ADEMAJ_____

ABSTRAKTI

Qeverisja e Korporatave në Republikën e Kosovës është një temë, për të cilën, sidomos nga viti 2000, është rritur interesimi dhe është shtuar intensiteti i debateve. Fillimi i organizimit të jetës së pavarur politike, juridike dhe ekonomike në vend, ishte faktor i cili ngriti interesimin për këtë temë, e cila në rrethana të reja erdhi si domosdoshmëri e kohës.

Kjo domosdoshmëri, u bë e karakterit urgjent në Kosovë, sidomos për faktin se që në fillimin e zbatimit praktik së sajë, ajo koincidoi me daljen në skenë të problemeve të njohura korporative në nivel botëror. Si rrjedhojë, problemet korporative të njohura nga konfliktet klasike të agjencisë, në Kosovë u paraqitën që në fillimin e konsolidimit të jetës ekonomike dhe juridike në vend, menjëherë pas vitit 1999.

Paraqitja e konflikteve të përmendura, burimin e kishte nga mbrojtja e pamjaftueshme e aksionarëve, shkelja e detyrave *fiduciare* nga ana e drejtorëve dhe, në përgjithësi, në përcaktimin e pamjaftueshëm të të drejtave të ekzekutivëve.

Përpos kësaj, lidhja midis korporatës dhe aktorëve të tjerë, nocion i cili rrjedh nga një perceptim më i gjerë i qeverisjes korporative, nxiti pyetje të shumta rrjedhur nga përkufizimi i "interesit të korporatës", dilema këto të cilat domosdoshmërisht kërkojnë definimin e qartë të përgjegjësisë, detyrimeve dhe të drejtave të primarëve, agjentëve dhe palëve të interesuara.

Prandaj, për të trajtuar problemin në mënyrë sa më të gjithanshme, jemi përcaktuar që deri tek e vërteta të arrijmë duke përdorur metodën e krahasimit dhe metodave të tjera ndihmëse, duke analizuar dhe vlerësuar në mënyrë kritike legjislacionin e Kosovës, i cili ka të bëjë me aspektet kryesore të qeverisjes korporative dhe, duke e krahasuar këtë, me legjislacionin e Kroacisë dhe Shqipërisë. Aspektet kryesore, të cilat janë trajtuar në këtë punim, i dedikohen: detyrimeve, përgjegjësisë dhe të drejtave të aksionarëve, detyrimeve, përgjegjësisë dhe të drejtave të ekzekutivëve dhe mbrojtjes së palëve të tjera të interesuara në lidhje me korporatat, në të tria legjislacionet e përmendura. Punimi analizon, hulumtimet se si janë rregulluar këto aspekte deri më tani, duke gjetur të përbashkëtat dhe dallimet në qasjet e ndjekura nga juridiksionet e zgjedhura dhe pretendon të nxjerrë në pah, dilemat dhe perspektivat që përcjellin, secilën nga juridiksionet e përmendura.

Gjithashtu, një vështrim i posaçëm është hedhur edhe mbi faktin se: në çfarë niveli, në secilin nga legjislacionet e përzgjedhura, zbatohen principet e Organizatës për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ekonomik (OECD), lidhur me qeverisjen e korporatave, si dhe faktin se sa janë të harmonizuara këto legjislacione me Direktivat e UE-së, dedikuar qeverisjes së korporatave.

Fjalët kyç: *Qeverisje korporative, Kuvendi i aksionarëve, Bordi i drejtorëve, Këshilli drejtues, Këshilli mbikëqyrës, Palë të interesuara.*

ABSTRACT

The Intensity of debate on governance of Corporations in Kosovo is a theme, on which the interest is increased especially from 2000 together with the intensity of debates. With the initiation of independent organization of political, legal and economic life interest for this theme is presented as necessity of the time. This necessity, was made of urgent character especially with the presence of known corporation problems in world level.

So corporation problems known from classical conflicts of the agency in Kosovo were presentet in the beginning of economic and judicial consolidation of life immediately after 1999.

Appearance of mentioned conflicts, has its origin from inadequate protection of shareholders, violation of fiduciary duties by the directors and at all in the inadequate determination of the executive rights.

In addition relation between corporation and its actors, notion which flows from wider perception of corporation governance, had opened numerous questions in relation with definition of “corporation interests”, those dilemma which necessarily require exact definition of responsibilities, duties and the rights of primaries, agents and interested parties.

So, to treat the problem in generally, we are determined to do that with comparative method, by analyzing and evaluating in critical way legislation of

Kosovo which has to do with main aspects of corporation governance and by analyzing the same, with the legislation of Croatia and Albania. Main aspects which are treated in this thesis, were dedicated to the obligations, responsibilities of executives and protection of other interested parties in three mentioned legislations. Thesis analyze investigations and differences in followed approaches from featured jurisdictions and emphasize dilemmas and perspective which follows each of mentioned jurisdictions.

Also, special overview was made on the fact that: in which level, of each featured legislations, are approved principles of Organization for Organisation for Economic Co-operation and Development (OECD) in relation with governance of corporations and because the fact that these legislations are harmonized with EU Directives, which are dedicated for corporation governance.

Key words: *Corporate governance, Assembly of shareholders, The Board of Directors, Management Board, Supervisory Council, Stakeholders.*

DEDIKIMI

Punimi, fillimisht, i dedikohet përmbushjes së detyrimeve të programit të Doktoratës në Fakultetin Juridik, me profil: E drejtë biznesi, për marrjen e gradës shkencore “Doktor”, në Shkollën Doktorale, në Universitetin Europian të Tiranës. Po ashtu, është produkt i punës praktike shumëvjeçare dhe hulumtimit shkencor të autorit, në lëmin e të drejtës së biznesit. Prandaj, punimi si i tillë, përpos qëllimit të përmbushjes së kriterëve akademike të përmendura më lartë, iu dedikohet edhe studentëve dhe praktikuesve të së drejtës së korporatave, si: komunitetit të biznesit, gjyqtarëve, prokurorëve, avokatëve etj., si dhe atyre të cilët në çfarëdo niveli qoftë, kanë të bëjnë me zbatimin e të drejtës biznesore, konkretisht, me aspektet ligjore të qeverisjes së korporatave.

Punimi, paraqet edhe një kontribut modest, i cili mundë të jetë i dobishëm edhe për praktikuesit e qeverisjes korporatave, përkatësisht për komunitetin e biznesit, sidomos për atë në Kosovë dhe në Shqipëri. Posaçërisht, ky punim mund të jetë i dobishëm për aktorët kryesorë të qeverisjes së korporatave, aksionarët, drejtorët dhe palët e tjera të interesuara, siç janë: punëtorët, kreditorët, investitorët, konsumatorët etj., pasi, secili nga këto subjekte, më për së afërmi do të njihet me përgjegjësitë, detyrimet dhe të drejtat që u takojnë, si dhe mënyrën më të drejtë dhe më të mirë të realizimit dhe mbrojtjes së këtyre të drejtave.

FALENDERIME

Falënderoj mentorin Prof.Dr.Riza Smaka, për përkrahjen e vazhdueshme, pa ndihmën e të cilit nuk do të arrija përfundimin me sukses të këtij punimi. Kjo për faktin sepse ai, asnjëherë nuk hezitoi të më jepte ndihmën e kërkuar, si për udhëzimin për literaturën e duhur, ashtu edhe në gjetjen e rrugëve më efikase të hulumtimit dhe trajtimit të tezës së këtij punimi.

Gjithashtu, një falënderim të veçantë kam edhe për gjithë stafin akademik të Universitetit European të Tiranës, të cilët gjithashtu dhanë kontributin e tyre të çmuar në përgatitjen dhe formësimin tim, për t'iu qasur në mënyrë të drejtë studimeve të doktoraturës dhe përfundimit me sukses të këtij punimi.

Dhe në fund, falënderoj shumë familjen time, bashkëshorten, vajzën dhe të tre djemtë, të cilët në çdo moment më përkrahën dhe më dhanë kurajë e forcë për të përfunduar këtë projekt, i cili, që prej fillimi, ishte dëshirë dhe projekt yni i përbashkët.

PËRMBAJTJA E LËNDËS

ABSTRAKT	II
ABSTRACT	IV
DEDIKIM.....	VI
FALENDERIME	VII
PËRMBAJTJA E LËNDËS.....	VIII
LISTA E SHKURTIMEVE DHE E FJALORIT	XVIII
KAPITULLI I : HYRJE	20
1.1. Tema qëllimi dhe rëndësia e hulumtimit	20
1.1.1. Tema	20
1.1.2. Qëllimi	26
1.1.3. Rëndësia.....	28
1.2. Aspekte metodologjike dhe strukturale	32
1.2.1. Aspekte metodologjike	32
1.2.2. Aspekte strukturore	39
1.3. Përfundimet nga kapitulli i parë	41
KAPITULLI II: SKELETI TEORIK DHE MODELI ANALITIK I TEMËS.....	43
2.1. Teoria e Agjencisë	43
2.2. Teoria e administrimit/kujdestarisë	45
2.3. Teoria e pretendentëve	46
2.4. Hipoteza dhe pyetjet kërkimore.....	48
2.4.1. Hipoteza e ngritur në punim dhe që kërkon vërtetim	48
2.4.2. Pyetjet kërkimore në këtë punim	49
2.5. Mundësitë dhe kufizimet.....	50
2.5.1. Mundësitë.....	50
2.5.2. Kufizimet.....	51
2.6. Përfundimet nga kapitulli i dytë	55

KAPITULLI III: KONTEKSTI HISTORIK.....	58
3.1. Hyrje në historinë e qeverisjes së korporatave.....	58
3.1.1. Historia e qeverisjes së korporatave në Kosovë.....	61
3.1.2. Historia e qeverisjes së korporatave në Shqipëri	64
3.1.3. Historia e qeverisjes së korporatave në Kroaci.....	64
3.2. Përfundimet nga kapitulli i tretë.....	66
KAPITULLI IV: KUVENDI I SHOQËRISË - ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME	
.....	68
4.1. Kuvendi i shoqërisë-Asambleja e përgjithshme e aksionarëve në Kosovë.....	68
4.1.1. Të drejtat qeverisëse-politike.....	68
4.1.2. E drejta për emërimin dhe shkarkimin e drejtorëve menaxhues.....	68
4.1.3. Mënyra e zgjedhjes dhe mandatimit të drejtorëve menaxhues	70
4.1.4. Votimi Kumulativ për zgjedhjen e drejtorëve	71
4.1.5. Parimi i Përgjegjësisë së aksionarëve.....	75
4.2. Kuvendi i shoqërisë-Asambleja e përgjithshme e aksionarëve në Shqipëri	77
4.2.1. Të drejtat qeverisëse-politike.....	77
4.2.2. E drejta për emërimin dhe shkarkimin e drejtorëve menaxhues.....	79
4.2.3. Mënyra e zgjedhjes dhe mandatimit të drejtorëve menaxhues	81
4.2.4. Mungesa e votimit komulativ për zgjedhjen e drejtorëve	84
4.2.5. Përgjegjësia e aksionarëve në rast të abuzimit me detyrën dhe formën e shoqërisë	87
4.3. Kuvendi i aksionarëve-Asambleja e përgjithshme e korporatve në Kroaci.....	89
4.3.1. Të drejtat qeverisëse- politike.....	89
4.3.2. E drejta për emërimin dhe shkarkimin e drejtorëve menaxhues.....	92
4.3.3. Mënyra e zgjedhjes dhe mandatimit të drejtorëve menaxhues	95
4.3.4. Votimi Kumulativ për zgjedhjen e drejtorëve	97
4.3.5. Përgjegjësia e aksionarëve	97
4.4. Përfundimet nga kapitulli i katërt	98

KAPITULLI V: BORDI I DREJTORËVE-KËSHILLI DREJTUES DHE KËSHILLI MBIKËQYRËS	100
5.1. Bordi i Drejtorëve dhe roli i tij në qeverisjen e korporatave në Kosovë	100
5.1.1. Emërimi dhe shkarkimi i drejtorëve menaxhues	103
5.1.2. Autorizimi për formimin e Bordit menaxhues në SH.P.K. dhe SH.A	105
5.1.3. Autorizimi i drejtorit menaxhues për të vepruar në emër të shoqërisë	107
5.1.4. Autoriteti dhe Kompetencat e Bordit të Drejtorëve	108
5.1.5. Dorëheqja dhe shkarkimi i Drejtorëve	109
5.1.6. Mbledhjet e bordit të drejtorëve, kuorumi dhe votimi.....	110
5.1.7. Veprimet e Bordit drejtues, pa mbajtjen e mbledhjes	111
5.1.8. Zyrtarët	113
5.1.9. Detyrimi për mbajtjen e librave dhe arkivës dhe sigurimi i qasjes	114
5.1.10. Parimi i kujdesi dhe vlerësimit afarist.....	115
5.1.11. Detyrimi për lajmërimin e interesave personale dhe financiare dhe.....	117
detyrimi për lojalitet	117
5.1.12. Detyrimi për moskonkurrencë.....	119
5.1.13. Kryerja e detyrave fiduciare nga drejtorët menaxhues personalisht ose ...	120
si rrjedhojë e një vendimi gjyqësor	120
5.1.14. E drejta e drejtorëve ekzekutivë për kompensim.....	121
5.2. Këshilli i Administrimit-Këshilli Mbikëqyrës dhe administratorët dhe roli i.....	122
tyre në qeverisjen e korporatave në Shqipëri	122
5.2.1. Administrimi i korporatës me një nivel të qeverisjes	124
5.2.2. Administrimi i korporatës me dy nivele të qeverisjes.....	133
5.3. Këshilli i Administrimit/Këshilli Mbikëqyrës dhe administratorët dhe roli	139
i tyre në qeverisjen e korporatave në Kroaci	139
5.3.1. Administrimi i korporatës me një nivel të qeverisjes	139
5.3.2. Administrimi i korporatës me dy nivele të qeverisjes.....	148
5.3.3. Përgjegjësitë e veçanta të drejtorëve në korporata në Kroaci, në të dyja	159
format e organizimit të administratës	159
5.3.4. Të drejtat e veçanta të drejtorëve, në të dyja format e organizimit të	162

<i>administratës</i>	162
5.4. Përfundimet nga kapitulli i pestë	165
KAPITULLI VI: PËRGJEGJËSIA SOCIALE E KORPORATAVE	168
6.1. Përgjegjësia sociale e korporatave në Kosovë	168
6.1.1. Punëtorët dhe roli i tyre në qeverisjen korporative në Kosovë	168
6.1.2. Konsumatorët dhe banorët rezident dhe roli i tyre në qeverisjen korporative	172
6.2. Përgjegjësia sociale e korporatave në Shqipëri	174
6.2.1. Punëtorët dhe roli i tyre në qeverisjen korporative në Shqipëri.....	174
6.2.2. Detyrat fiduciare ndaj kreditorëve	180
6.2.3. Detyrat fiduciare ndaj konsumatorëve	180
6.3. Përgjegjësia sociale e korporatave në Kroaci.....	181
6.3.1. Punëtorët dhe roli i tyre në qeverisjen korporative në Kroaci	181
6.3.2. Detyrat fiduciare ndaj kreditorëve	183
6.3.3. Detyrat fiduciare ndaj konsumatorëve	184
6.4. Përfundimet nga kapitulli i gjashtë	185
KAPITULLI VII: KODET E BRENDSHME DHE ROLI I TYRE	188
NË QEVERISJEN E KORPORATAVE.....	188
7.1. Aplikimi i kodit të qeverisjes së korporatave në Kosovë	188
7.2. Aplikimi i kodit të qeverisjes së korporatave në Shqipëri	190
7.3. Aplikimi i kodit të qeverisjes së korporatave në Kroaci.....	193
7.4. Përfundimet nga kapitulli i shtatë	197
KAPITULLI VIII: KONKLuzionET DHE REKOMANDIMET	202
8.1. Konkluzionet	202
8.2. Rekomandimet.....	206
8.2.1. Rekomandimet e përbashkëta për qeverisjen e korporatave në Kosovë dhe Shqipëri	206
8.2.2. Rekomandimet për qeverisjen e korporatave në Kosovë.....	209
8.2.3. Rekomandimet për qeverisjen e korporatave në Shqipëri	209
LISTA E REFERENCave/BIBLIOGRAFIA	211

LISTA E SHKURTIMEVE DHE E FJALORIT

ARBK: Agjencia për regjistrimin e bizneseve në Kosovë

LQKR: Ligji për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit

LSHTK: Ligji nr.02/L-123 për Shoqëritë Tregtare në Kosovë

LSHTKR: Ligji për Shoqëritë Tregtare në Kroaci

LTSHSTH: Ligji për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare në Shqipëri

KDPSH: Kodi i punës i Shqipërisë

LPK: Ligji i punës i Kosovës

LPKR: Ligji i punës i Kroacisë

MSA: Marrëveshja për Stabilizim-Asociim

OBZHE: Organizata për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ekonomik

OECD: Organisation for Economic Co-operation and Development

RSFJ: Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë (1945-1992)

SH.P.K.: Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar

SHA: Shoqëri Aksionare

UE: Unioni Europian

APA: Asambleja e përgjithshme e aksionarëve

BD: Bordi drejtues

KM: Këshilli mbikëqyrës

KD: Këshilli drejtues

PPAP: Programet për Pronësinë e Aksioneve nga Punonjësit

REG/UNMIK: Rregullorja e UNMK-ut

CEO: Chief Egzekutive Officer (Kryeshefi ekzekutiv)

IFC: International Finance Corporation-Korporata Financiare Ndërkombëtare

ecoDa: The European Confederation of Directors' Associations-Konfederata Europiane e Shoqatave të Anëtarëve të Këshillave të Administrimit

HANFA: Hrvatska agencija za nadzor finansijkih usluga - Agjencia kroate për mbikëqyrjen e shërbimeve financiare

GIZ: Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit - Shoqëria Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar

KAPITULLI I: HYRJE

1.1. Tema, qëllimi dhe rëndësia e hulumtimit

1.1.1. Tema

Për të kuptuar temën, e cila është objekt studimi i këtij disertacioni të doktoraturës, paraprakisht, kërkohet që të jepen disa shpjegime themelore për vetë emrin – përkatësisht, termin korporatë. Në teori hasim shpjegime të shumta lidhur me prejardhjen etimologjike të termit Korporatë, si: *lat. corpus = trup; angl. Corporation; gjerm. Körperschaft, Kapitalgesellschaft, Aktiengesellschaft, Handelsgesellschaft*, e tj. Në fakt, termi korporatë paraqitet si term i cili, për nga koha e paraqitjes së tij, është i ri. Në gjuhën shqipe, termi korporatë historikisht e ka gjetur kuptimin tek *esnafët* (Korporata e zejtarëve-tregtarëve), kurse në kuptimin ekonomik, me korporatë kuptojmë “Shoqëri e madhe aksionare që krijohet nga bashkimi i kapitalistëve të mëdhenj - Trustet dhe korporatat”¹. Kjo formë e organizimit të shoqërisë haset në paraqitjen ose lindjen e formave të organizimit të shoqërisë së kapitalit, të cilat kategorizohen në grupin e korporatave.² Korporata, nga shumë autorë identifikohet me shoqërinë aksionare³, si forma më e lartë e organizimit të biznesit, e cila rregullohet me ligj.

Sipas doktrinės dhe të drejtës pozitive, në Kosovë dhe në Kroaci, korporata konsiderohen: shoqëria aksionare (SH.A.) dhe shoqëria me përgjegjësi të kufizuar

¹ Shif, fjalori i gjuhës së sotme shqipe, Akademia e shkencave të Shqipërisë, Botimet Toena, Tiranë 2002, fq.64; Gjithashtu, shih; <https://sq.wiktionary.org/wiki/korporat%C3%AB>.

² <https://hr.wikipedia.org/wiki/Korporacija>, shiquar për herë të fundit me 14.07.2015.

³ Llaci Sh & Tabaku J. (2010). *Qeverisja e Korporatave*, Albpaper, Tiranë, fq.7.

(SH.P.K.).⁴ Për dalim nga këto dy sisteme, në Republikën e Shqipërisë, korporatë konsiderohet, vetëm shoqëria aksionare.

Për këtë arsye shoqëritë tregtare ndahen në dy grupe themelore, siç janë: shoqëritë e personave dhe shoqëritë e kapitalit.

Dallimi i kësaj ndarje qëndron në atë se, shoqëritë tregtare të personave (ndërmarrja individuale, shoqëria kolektive dhe shoqëria komandite) janë shoqëri tregtare, të cilat konsistojnë në bashkimin e personave (anëtarëve) që e përbëjnë shoqërinë, dhe si rrjedhojë e kësaj, këto shoqëri edhe karakterizohen si shoqëri *intuitu personae*. Te kjo formë e organizimit të shoqërisë tregtare, është esenciale se kush janë anëtarët, kurse, kusht themelorë për anëtarësim në shoqëri është cilësia e personit, i cili anëtarësohet në shoqëri. Te ky lloj i organizimit të shoqërisë tregtare, pranimi i anëtarëve të rinj në shoqëri mund të bëhet, vetëm nëse me këtë pranim, paraprakisht janë pajtuar të gjithë anëtarët e shoqërisë.

Nga ana tjetër, shoqëritë tregtare të sendeve ose kapitalit - korporatat (shoqëria me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqëria aksionare), paraqiten si shoqëri të sendeve-kapitalit, të cilat formohen përmes bashkimit të kapitalit të tyre të depozituar në shoqëri. Në këtë formë të organizimit juridik të shoqërisë tregtare, aspekti personal i anëtarëve nuk është element me rëndësi vendimtare⁵.

Për këtë arsye, mund të përfundojmë se, sa i përket nocionit të shoqërisë tregtare në sistemin anglosakson, këtij nocioni i përgjigjet bashkësia e termeve

⁴ Shih nenin 78 par.1 dhe 126 par.1 i LSHTK dhe neni 2 par.3 i LSHTKR.

⁵ Barbić J (2006). *Pravo Društava, Knjiga prva, Opći dio, Drugo izmenjeno i dopunjeno izdanje*, organizator Zagreb. (E drejta e shoqërive, Libri i parë, Pjesa e përgjithshme, Botimi i dytë i ndërruar dhe plotësuar, Organizator Zagreb), fq.149-151.

“partner-ship” dhe “company” (Corporation).⁶ Sipas kësaj, edhe në të gjitha vendet, në literaturë, për këto forma të organizimit të shoqërive tregtare, është pranuar emërtimi i përgjithshëm korporatë. Si rrjedhojë, kjo formë e organizimit të shoqërisë, është një nga format më të sofistikuar të shoqërive tregtare, e cila dallohet dhe ka përparësi të shumta në krahasim me format tjera të shoqërive tregtare. Kjo përparësi determinohet nga fakti se, kjo formë e organizimit të shoqërisë ka arritur të mënjanojë shumë dobësi dhe rreziqe të shoqërisë së ortakërisë, përkatësisht, të shoqërisë së personave, ato, të cilat kanë të bëjnë me rrezikun e humbjes së pasurisë së përgjithshme të themeluesve.

Nga fakti se korporata paraqitet si forma më e sofistikuar e shoqërisë tregtare, si shoqëri e kapitalit, rezulton nevoja dhe domosdoshmëria e gjetjes dhe përpunimit të mekanizmave efikas për udhëheqjen, përkatësisht, qeverisjen e saj. Kjo nevojë dhe domosdoshmëri e organizimit rrjedh nga vetë elementet esenciale të korporatës, siç janë: ndarja e pronësisë nga menaxhimi i shoqërisë, cilësia e bordit të drejtorëve, i cili luan rol kyç në qeverisjen e shoqërisë, përgjegjësia mbi grupet e interesit, si dhe çështje tjera të rëndësishme të bazuara në parimet e Qeverisjes së mirë të Korporatave. Por, për t’u arritur këto synime të qeverisjes korporative, duhet doemos “njohje, respektim dhe zbatim i ligjeve, si dhe një kulturë e lartë në qeverisjen dhe menaxhimin e shoqërisë”⁷.

E gjithë kjo, me të vetmin qëllim: arritjen e qëllimit ekonomik për të cilin themelohet shoqëria tregtare e që është maksimizimi i fitimit si qëllim primar i aksionarëve, në njërën anë, dhe njëkohësisht, respektimin dhe kënaqjen e interesave

⁶ Po Aty.

⁷ Vasiljević M. (1993). *Trgovinsko pravo (poslovno pravo), Savremena administracija d.d.*, Beograd, god. fq.46.

të aktorëve të tjerë, siç janë: drejtorët dhe menaxherët, në anën tjetër. Qeverisja e korporatave ka për qëllim edhe kënaqjen dhe mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të aktorëve të tjerë të brendshëm, si që janë punëtorët. Dhe për të shkuar edhe më tutje, qeverisja e korporatave ka për qëllim edhe në respektimin e interesave të naktorve të jashtëmjastëm, që janë kreditorët, investitorët dhe konsumatorët. Madje kohët e fundit, me zgjimin e interesimit të madh për mbrojtjen e ambientit, paraqiten përpjekje për mbrojtjen e një numri të papërcaktuar të personave, të cilët kanë interes për qeverisje të mirë korporative, duke përdorur të drejtat e garantuara, të drejta të cilat edhe atyre u japin mundësi të kërkojnë nga korporatat, që ato (korporatat) të kufizohen në veprimet e tyre, sidomos kur është fjala në detyrimin për mbrojtjen e ambientit dhe natyrës në përgjithësi.

Lidhur me qeverisjen e korporatave ekzistojnë një sërë përkufizimesh, të cilat dallojnë nga njëra-tjetra, varësisht nga historia, tradita, kultura dhe organizimi i sistemit ekonomik të vendit. E konsiderojmë të drejtë dhe gjithëpërfshirës, përkufizimin e qeverisjes së korporatave të përcaktuar nga OECD-ja, i cili konsiston në atë se, qeverisja korporative është:

“Mjeti i brendshëm me anë të së cilit korporatat veprojnë dhe kontrollohen(...) në të cilin përfshihen një sërë marrëdhëniesh të menaxhimit të një shoqërie, bordit të saj, aksionarëve të saj dhe aktorëve të tjerë. Qeverisja e korporatave ofron edhe strukturën nëpërmjet së cilës vendosen objektivat e shoqërisë, përcaktohen mjetet e arritjes së këtyre objektivave dhe monitorimit të performancës. Mirëqeverisja e korporatave duhet të ofrojë nxitësit e duhur për bordin dhe menaxherët për të realizuar objektiva që janë në interes të shoqërisë dhe aksionarëve dhe për të lehtësuar monitorimin efektiv, duke

nxitur kompanitë të përdorin burimet e tyre në mënyrë më efikase”⁸.

Nga kjo konsiston fakti se qeverisja e korporatave fillimisht rregullon dhe përcakto marrëdhënie midis aksionarëve (pronarëve të korporatës) dhe administratorëve (menaxhmentit të korporatës). Këto marrëdhënie, bazohen në faktin që aksionarët u vënë në dispozicion menaxherëve, kapitalin e tyre, me qëllim që të arrihet maksimizimi i fitimit mbi kapitalin e tyre. Për t’u arritur ky qëllim, menaxherët duhet t’u japin raporte të vazhdueshme aksionarëve. E gjithë kjo, nuk mundë të arrihet, pa një rregullim të mirëfilltë të paketave ligjore si dhe kodeve të brendshme të korporatave, me të cilat qartë rregullohet raporti dhe ndërvlarësia e veprimeve të organeve-aktorëve të qeverisjes së korporatave. Nga kjo arsye, aksionarët si njëri ndër aktorët kryesor të qeverisjes korporative, zgjedhin organet për administrimin e korporatës, si: këshillin Administrativ në rastin e shoqërive me sistem administrimi në një nivel ose këshillin mbikëqyrës në rastin e shoqërive me sistem administrimi në dy nivele. Raportet në mes të ndërvlarësisë dhe veprimeve qeverisëse, të drejtave, detyrimeve dhe përgjegjësisë të subjekteve të lartpërmendura janë temë-bosht i këtij punimi, duke mos përjashtuar edhe përfshirjen e marrëdhënieve të palëve të tjera të interesuara siç janë: punëtorët, investitorët, konsumatorët dhe rezidentëve të tjerë të pa përcaktuar.⁹

Nga kjo që u tha më lartë, duhet dalluar aspektet ekonomike dhe menaxheriale të qeverisjes së korporatave, në njërën anë, nga aspektet ligjore ose juridike të

⁸ Qeverisja e Korporatave/Manual, International Finance Corporation (ifc) World Bank Group, suported by Confederzzion Svizra-State Sekretariat for Economic Affairs SEKO, fq.9, Botuar në Tiranë, Shqipëri, 2009.

⁹Me rezidentë të tjerë të papërcaktuar, nënkuptojmë grupet ose bashkësitë tjera të interesit, interesat e të cilëve në mënyrë direkte ose indirekte, preken nga aktiviteti i korporatave.

qeverisjes së korporatave, në anën tjetër. Kjo për faktin se aspektet ekonomike dhe menaxheriale, qeverisjen e korporatave e trajtojnë nga këndvështrimi i maksimizimit të interesave ekonomike të korporatës, si dhe nga prizmi i organizimit sa më racionalë, me qëllim të rritjes së produktivitetit dhe rentabilitetit me të lartë të korporatës.

Në anën tjetër, aspektet juridike të qeverisjes së korporatave kanë të bëjnë me arritjen e këtyre qëllimeve, duke siguruar respektimin e hierarkisë së normave juridike, duke rregulluar raportet dhe ndërvlerësinë mes organeve qeverisëse të korporatave dhe duke siguruar kushte për të mbrojtur interesat dhe të drejtat e të gjithë aktorëve, në kuadër të qeverisjes së korporatave, njëkohësisht duke mos cënuar të drejtat e palëve tjera të interesuara.

Qeverisja e korporatave tradicionalisht është definuar si sistem dhe proces, të cilin korporatat e përdorin me qëllimin e arritjes së efekteve më të mira financiare për aksionarët dhe investitorët e tyre, kurse menaxherët rolin e tyre e kanë kuptuar si të orientuar drejtë kësaj ideje. Por, në fund të shekullit të kaluar dhe në fillim të këtij shekulli, janë rritur edhe kërkesat e organeve shtetërore, edhe të aktorëve të tjerë, që korporatat të mos interesohen vetëm për interesat e aksionarëve, por edhe për interesat e palëve të tjera të interesuara ose pjesëmarrësve të tjerë në qeverisjen korporative (*stakeholderëve*). Në praktikë, një numër i konsiderueshëm i korporatave edhe më tej, edhe pse këtë nuk e demonstrojnë në mënyrë të hapur, i përkasin atij blloku, i cili angazhohet për idenë se përgjegjësia primare e korporatave është rritja e fitimit të aksionarëve të saj, kurse, në anën tjetër, është në rritje blloku, i cili konsideron se vetëm balancimi i përgjegjësisë shoqërore dhe ekologjike me arritjen e fitimit në stadi të gjatë, siguron suksesin ekonomik dhe zhvillim të qëndrueshëm të

shoqërisë, në përgjithësi.

Paralelisht me këtë proces rriten kërkesat që korporatat në aktivitetet e tyre të ngrenë edhe standardet e etikës afariste, përkatësisht, që të kenë përgjegjësi shoqërore. Me fjalë tjera, të ekzistojë një sjellje e përgjegjshme, jo vetëm ndaj aksionarëve, por edhe ndaj rrethit natyror, shtetit dhe bashkësisë që i rrethon, konsumatorëve, partnerëve afarist, të punësuarve dhe shoqërisë, në përgjithësi. Kështu këto dy procese, nën tryshninë e faktorëve të shumëllojshëm, si dhe procesit të globalizimit, nga faza e *dihotomisë-divergjencës* (ndarjes) kalon në fazën e *konvergjencës* (*ofrimit-bashkimit*). Megjithatë, këto dy sisteme nuk është e mundur që thjeshtë të njësohen ose reciprokisht të ndërrohen, pasi qeverisja e korporatave, edhe më tej, më shumë është e orientuar nga aksionarët, kurse përgjegjësia shoqërore korporatave, ndaj *stejkholderëve* (bartësve tjerë të interesit) edhe më tejë mbetet në plan të dytë.

Për t'u arritur qëllimi për qeverisjen e mirë të korporatave, shtetet kanë nxjerrë ligje dhe akte tjera nënligjore. Gjithashtu, në kuadër të UE-së janë miratuar shumë direktiva dhe akte të tjera me të cilat rregullohet kjo lëmi e së drejtës, me qëllim, unifikimin dhe përafrimin e saj në nivel global. Përpos rregullores së përmendur ligjore, korporatat nxjerrin edhe rregulloren e tyre të brendshme, e cila duhet të jetë në kuadër të hierarkisë së akteve të përmendura juridike dhe më nga afër rregullon këtë materie, duke ia përshtatur kushteve të brendshme të korporatës në fjalë.

1.1.2. Qëllimi

Qëllimi i parë i punimit të kësaj tem, është analiza juridike e natyrës,

karakteristikave dhe zbatimit praktik të rregullave të qeverisjes korporatave, të njohura si “e drejtë e butë” (*soft law*) me vështirësi të posaçëm në praktikën e Unionit European, gjë e cila është edhe në frymën e Marrëveshjes për stabilizim dhe asociim, në të cilën është paraparë harmonizimi i legjislacionit të Kosovës me të drejtën komunitare.

Qëllim i dytë i hulumtimit është përcaktimi përfundimtar i karakteristikave dhe kompleksiteti i sistemit të qeverisjes korporative dhe përgjegjësisë shoqërore të korporatave, si dhe aplikimit në praktikë të tyre.

Qëllimi i tretë i hulumtimit janë kodet e brendshme të qeverisjes korporative, përmbajtja dhe rëndësia e aplikimit të tyre, në kontekstin e vënies në zbatim të rregullave dhe standardeve të reja në afarizmin e korporatave, posaçërisht atyre multinacionale, nga të cilat shumë syresh janë më të “fuqishme” se shumë shtete dhe kanë mundësi madje edhe t’i rrezikojnë institucionet demokratike. Vëmendje e posaçme në këtë punim, i është kushtuar çështjes së efikasitetit, implementimit dhe specifikave të kodeve të brendshme të korporatave, të cilat janë të kushtëzuara me rregullimin shoqëror, modelin juridik dhe ekonomik të vendit konkret. Prandaj kemi parasysh Direktivën e UE-së 2006/46/EC¹⁰, e cila ka përcaktuar detyrimin e korporatave të listuara në bursë, për t’u deklaruar në lidhje me qeverisjen e tyre korporative, në bazë të rregullit “zbato ose shpjego” (*comply or explain*).

Qëllimi i katërt është që, rrethit të gjerë të subjekteve afariste, t’u ofrohet një studim kompleks, i cili mundet, sado pak, të kontribuojë në kuptimin më të mirë të natyrës juridike, domethënies dhe rëndësisë që ka aplikimi i principeve të përgjegjësisë shoqërore në qeverisjen moderne korporative, duke pasur parasysh

¹⁰ <http://eur-lex.europa.eu/eli/dir/2006/46/oj>, Parë për herë të fundit, me 17.07.2014, ora 22,12h.

faktin se, kjo praktikë në vendin tonë nuk ka traditë të gjatë, kurse zgjidhjet autentike të vijnë me konstatimin që vlen për të gjitha vendet në zhvillim, se në të gjitha nivelet ekziston një deficit i kulturës korporative.

Qëllimi i pestë është që, qeverisja e mirë e korporatave njëkohësisht të sigurojë të drejtat e aksionarëve, duke respektuar të drejtat e bartësve të tjerë të interesave, duke siguruar publikimin me kohë dhe të saktë të të gjitha gjërave dhe veprimeve të cilat janë të rëndësishme për korporatën, duke përfshirë edhe gjendjen financiare, rezultatet, pronësinë dhe qeverisjen me korporatën. E gjithë kjo, me qëllim që të sigurojë udhëheqje strategjike për korporatën dhe mbikëqyrje efikase të drejtorëve, nga ana e bordit, dhe përgjegjësinë e bordit ndaj korporatës dhe aksionarëve.

Me qëllim të arritjes së këtyre qëllimeve, do të duhej të krijohej infrastrukturë e duhur ligjore për qeverisje efikase të korporatave, e cila ndikon njëkohësisht dhe drejtpërsëdrejti në “sigurimin e fuqizimit të shfrytëzimit të kapitalit, ngritjen e standardit jetësor dhe ngritjen e besimit të investitorëve”.¹¹

1.1.3. Rëndësia

Rëndësia e madhe e qeverisjes së korporatave del në pah, sidomos, pas paraqitjes së skandaleve të mëdha financiare, të cilat ndodhën në fillim të këtij shekulli, në disa nga firmat me famë botërore, si “Enron”¹² në SHBA, etj. Këto skandale, paraqitën nevojën e organizimit më të avancuar të korporatave, duke e

¹¹ Hatunić E & Kuč H. (2009). *Korporativno upravljanje imenadžment-Osnovni priručnik za menadžere*, OFF-SET, Tuzla, , fq.13, shkarkuar nga <http://www.scribd.com/doc/24215736/KORPORATIVNO-UPRAVLJANJE-IMENAD%C5%BDMENT-Emin-Hatuni%C4%87-Harun-Ku%C4%8D> (parë më 18.07.2015).

¹² <http://scholarlycommons.law.wlu.edu/cgi/viewcontent.cgi?article=1230&context=wlulr>, (parë më 20.07.2014).

ngritur këtë temë, dhe nevojën për rregullimin e saj, sidomos në aspektin ligjor, jo vetëm në nivel nacional, por edhe në nivel botërorë-global. Kjo për arsye se, tani më është vërtetuar qartë se ekziston nevojë e domosdoshme për harmonizimin e interesave të ndryshme, të cilat ekzistojnë natyrshëm, fillimisht mes të aktorëve kryesorë të qeverisjes së korporatave (aksionarëve dhe menaxherëve-drejtorëve) e më tej, edhe mes aktorëve të përmendur dhe aktorëve tjerë. Konflikti kryesorë i interesit i njohur si konflikti primar agjent¹³, bazuar në parimet e OECD-së për qeverisjen e korporatave, i cili ka për qëllim t'i japë përgjigje pyetjes, se; Si të gjendet mundësia që personi A të motivoj personin B për të vepruar për interes të personit A, më tepër sesa personi B të ndjekë interesin e vet¹⁴ dhe, njëkohësisht, me këtë rast të mos preken në kuptimin negativ, përkatësisht, të mbrohen edhe interesat e aktorëve të tjerë? Duke dhënë përgjigje në pyetjen e parashtruar, rezulton se; qeverisja e korporatave ka për qëllim që të gjejë rrugët dhe mundësitë që aksionarët, si zotërues të kapitalit, të motivojnë drejtorët të cilët administrojnë korporatën, përkatësisht, kapitalin e aksionarëve, për të vepruar në interesin e aksionarëve më tepër se sa të interesohen për interesat e veta dhe njëkohësisht në këtë rast të mos preken interesat e aktorëve të tjerë, siç janë punëtorët, investitorët, kreditorët, konsumatorët etj., madje, njëkohësisht të gjenden mundësitë edhe për motivimin e këtyre të fundit, që të veprojnë për interesin më të mirë të korporatës.

Diskutimet e mësipërme paraqesin kornizën bazë për të shtjelluar thelbin e kësaj teze, fokusi i së cilës është të analizojë, krahasojë dhe vlerësojë në mënyrë kritike, të tri aspektet themelore të qeverisjes së korporatave dhe atë; sigurimin e

¹³ Hatunić E & Kuć H. (2009). *Korporativno upravljanje imenadžment-Osnovni priručnik za menadžere*, fq.35 dhe shpjegimi i * 2 në faqen 55.

¹⁴ Për më tepër shih; www.oecd.org.

kushteve ligjore për garantimin e të drejtave të aksionarëve, arritjen e të drejtave të drejtorëve si dhe përcaktimin e detyrimeve të tyre, si dhe njëkohësisht të respektohen edhe të drejtat e palëve të tjera të interesuara, në korporatat në Kosovë, Shqipëri dhe Kroaci. Diskutimet e përmendura, posaçërisht shtjellojnë veprimin dhe ndërvarësinë e organeve qeverisëse në korporatë, përkatësisht, ndërvarësinë e veprimeve të kuvendit-asamblesë së aksionarëve, në njërën anë, dhe (bordit të drejtorëve në korporatat në Kosovë) dhe (këshillit drejtues përkatësisht drejtorisë dhe këshillit mbikëqyrës në korporatat në Shqipëri dhe në Kroaci), në anën tjetër. Përmes këtij hulumtimi, ne jemi përpjekur që të krahasojmë tri aspektet e mësipërme dhe të shpjegojmë se si ato janë të rregulluara në aspektin juridik dhe si funksionojnë në aspektin praktik. Nga kjo, jemi munduar që, të gjejmë të përbashkëtat dhe dallimet në qasjet e ndjekura nga juridiksionet e zgjedhura dhe të konstatojmë se, cilat janë dilemat që kanë të bëjnë në lidhje me secilën prej tyre.

Nga e gjithë kjo që u theksua më sipër, buron edhe rëndësia e hulumtimit të kësaj problematike së cilës i jemi qasur, çka ka për qëllim analizimin, hulumtimin dhe gjetjen e zgjidhjeve më të avancuara dhe të pranueshme për qeverisjen e korporatave në Kosovë. Hulumtimi ka rëndësi shumë të madhe edhe për faktin se, organizimi i jetës shoqërore, juridike dhe ekonomike në Kosovë, e cila që në hapat e parë të saj, u përballë edhe me problemet e qeverisjes korporative, ishte koïncidencë¹⁵, e cila edhe më tepër zgjoi interesimin për këtë fushë të së drejtës. Gjithashtu, rëndësia e studimit të kësaj teme qëndron edhe nga fakti se qeverisja e korporatave është temë e re në

¹⁵ Koïncidenca, konsiston në faktin se problemet e mëdha në qeverisjen e korporatave në nivelin global, u paraqitën në vitin 2000-2001, atëherë kur Kosova po sa filloi hapat e parë në organizimin e jetës politike dhe ekonomike, si dhe nxjerrjen e ligjeve (atëherë rregulloreve të UNMIK-ut, me të cilat duhej të rregullohej qeverisja e korporatave.

mjedisin juridik kosovar. Këtijë punimi, edhe më tepër i jep rëndësi fakti se, mungon tradita e organizimit dhe funksionimit të shoqërive tregtare, në përgjithësi, dhe tradita e organizimit dhe funksionimit korporatave në veçanti. Sipas kësaj, edhe përvojat tona në fushën e qeverisjes së korporatave, konsiderohet se tani sa kanë filluar t'i bëjnë hapat e para, gjë e cila njëkohësisht është paraqitur si vështirësi në realizmin e punimit.

Rëndësia e këtij punimi shtohet edhe me tepër, kur dihet mirëfilli se, që me fillimin e organizimit të jetës ekonomike dhe juridike në Kosovë, pra, në fillimet e para të qeverisjes së korporatave, u paraqitën probleme në mes të aktorëve kryesor të qeverisjes së korporatave. Këto probleme buronin nga përcaktimi jo i qartë i interesave në mes pronarëve (aksionarëve), në njërën anë, dhe ekzekutivëve (administratës, bordit drejtues), në anën tjetër.

Gjithashtu, ka qenë dhe ende është nevoja edhe për harmonizimin e interesave në mes të aksionarëve dhe drejtorëve në njërën anë dhe pretendentëve të tjerë, posaçërisht, punëtorëve, investitorëve dhe konsumatorëve, në anën tjetër. Nga analiza e përgjithshme e problemit të përmendur, është vërtetuar se edhe përkundër përpjekjeve 19-vjeçare për të shënuar avancim në këtë sferë të së drejtës në Republikën e Kosovës, avancimi i mirëfilltë për të arritur një qeverisje kualitative të korporatave, ende mbetet një objektiv, për arritjen e të cilit mbetet shumë punë për t'u bërë. Për këtë arsye, e konsiderojmë të drejtë dhe tërësisht pajtohemi me konstatimeinse: "Qeverisja korporative duhet të jetë një prioritet i lartë për sektorin e biznesit të Kosovës, sepse për fat të keq kjo nuk është praktikuar aq sa është dashur dhe standardet e qeverisjes së korporatave në Kosovë janë më të ulëta nga ajo çka

konsiderohet normale, apo e pranueshme... në Evropë”.¹⁶

Nga të gjeturat, si në aspektin teorik, ashtu edhe në atë praktik, konstatohet se mbisundon mendimi se, një gjendje e tillë e qeverisjes korporative në Kosovë, vjen nga arsyeja se, “Korniza ligjore, e cila merret me qeverisjen e korporatave të kompanive private, duke përfshirë bizneset familjare në Kosovë, është e dobët dhe e mangët”¹⁷. Për këtë arsye, por edhe shumë të tjera të ngjashme, gjithsesi lind nevoja për qeverisje të mirë të korporatave, duke synuar rritjen e llogaridhënies së Korporatave¹⁸. Një kërkesë e tillë duhet të jetë në të gjitha korporatat, si në ato private, ashtu edhe ato publike, ku edhe më tutje kërkohet të avancohet me transparencën, pjesëmarrjen publike, llogaridhënien, teknologjinë dhe inovacionin.¹⁹

1.2. Aspekte metodologjike dhe strukturale

1.2.1. Aspekte metodologjike

Besojmë se metodologjia e aplikuar, do t’i përgjigjet arritjes së qëllimeve të

¹⁶http://www.kosovalive360.com/standardet-e-qeverisjes-se-korporatave-ne-kosove-jane-te-uleta_.htm, parë për herë të fundit me 14.07.2015. Megjithatë, nga kjo konferencë pati edhe tone optimiste, siç ishin ato se “...përmirësimet në qeverisjen e korporatës kanë rezultuar me përfitime për kompaninë nëpërmjet demonstrimit të përgjegjshmërisë ndaj aksionarëve, duke ruajtur besimin e publikut dhe gjithashtu u ka ndihmuar për të ulur koston financiare.”

¹⁷<https://koha.net/?id=27&l=66381>, parë për herë të fundit me datë 14.07.2015.

¹⁸http://www.kryeministriks.net/repository/docs/PLANI_NACIONAL_I_VEPRIMIT_2014_-_2016_P_QH.pdf, parë për herë të fundit më 14.07.2015, Republika e Kosovës- Qeveria - Ministria e Integritimit Evropian; PLANI NACIONAL I VEPRIMIT 2014-2016 PARTNERITETI PËR QEVERISJE TË HAPUR - PQH (OPEN GOVERNMENT PARTNERSHIP – OGP) Prill, 2014.

¹⁹<http://kfos.org/wp-content/uploads/2014/01/Identifikimi-i-Politikave-t%C3%AB-Qeverisjes-s%C3%AB-Hapur-n%C3%AB-Evrop%C3%ABn-Juglindore-ALB.pdf>, parë për herë të fundit më 14.07.2015- Forumi 2015, Projekt i Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur; Identifikimi i Politikave të Qeverisjes së Hapur në Kosovë.

këtij punimi. Është i njohur një parim për kërkimin shkencor, sipas së cilit, metodat janë të varura nga teoritë, teoritë të ndërlidhura me hipoteza dhe hipotezat me pyetjet kërkimore, dhe të gjitha këto varen nga të dhënat respektive, të cilat duhen interpretuar dhe analizuar. Pikërisht, në varësi të hipotezës apo pyetjeve që ngrihen në kapituj të veçantë të punimit, janë zbatuar edhe metodat e hulumtimit shkencor.

Qasja kryesore metodike në këtë punim është qasja normative, e cila konsiston rreth asaj se “si duhet të jetë” vlera, e jo se “si është ajo tani”.

Punimi është ndërtuar duke u bazuar në përdorimin e metodave cilësore (kualitative) të kërkimit, përmes së cilave kemi siguruar kuptimin dhe sqarimin e rasteve studimore, objekteve të hulumtimit nga prizmi historik dhe juridik, duke grumbulluar të dhëna e informacione me qëllim krahasimor dhe analitik.

Metodat sasiore (kuantitative) të kërkimit, janë përdorur vetëm si metoda plotësuese dhe si të tilla janë aplikuar vetëm në disa aspekte (pjesë) të punimit. Prandaj, mund të thuhet pa mëdyshje se, këto dy paradigma të kërkimit shkencor (përqasja cilësore dhe ajo sasiore), ekzistojnë të ndara nga njëra-tjetra, nëse i referohemi mënyrës në të cilën secila prej këtyre dy metodave e mbledhë informacionin dhe trajton të dhënat e mbledhura.²⁰

Duke iu referuar fushës së studimit dhe hipotezave të ngritura në këtë kuptim, ky i fundit na paraqitet si një studim kryesisht i të dhënave cilësore. Punimi paraqitet në mbledhjen dhe analizën e të dhënave të doktrinës juridike të së drejtës së korporatave, të dhëna këto të shtjelluara në literaturën ku mbështetet punimi. Gjithashtu, sinteza dhe analiza e të dhënave janë adresuar në kuadrin e brendshëm normativ dhe atë ndërkombëtar, shoqëruar edhe me interpretimin e këtij kuadri nga

²⁰ Brannen, J. (1992) “Kombinimi i qasjeve cilësore dhe sasiore: një përmbledhje”, fq.13.

jurisprudenca. Për aq sa ka qenë e mundur edhe në disa kapituj të veçantë janë shfrytëzuar, analizat numerike (sasiore) të të dhënave. Ne nuk kemi zhvilluar metoda studimi sasiore, pasi që ato nuk përfshiheshin në fokusin e metodologjisë së punimit. Por, ndërkohë, janë shfrytëzuar studime sasiore të autorëve apo subjekteve të tjerë, të cilët janë realizuar kohët e fundit në lidhje me aspekte të ndryshme të qeverisjes së korporatave, si në planin kombëtar, ashtu edhe në planin ndërkombëtar. Shembuj të përdorimit të të dhënave të tilla, janë dhënë në kapitujt V dhe VI, ku përmes shpjegimeve dhe tabelave janë dhënë shpjegime për dukuri të caktuara, të cilat janë trajtuar në këta kapituj. Ndërmjet këtij kombinimi të metodave të studimit, jemi përpjekur të arrijmë në përfundime sa më pranë realitetit dhe, sa më tepër që ka qenë e mundur, të liruar nga shprehja e bindjeve personale. Prandaj, nga aspektet e trajtuara metodologjike, në këtë punim janë zbatuar këto metoda të kërkimit:

1.2.1.1. Metoda “Rishikimi i literaturës”

Para se të krijojmë një dije të re, fillimisht ne kemi nevojë të njohim dijen ekzistuese mbi subjektin e kërkimit. Në këtë kuptim, rishikimi i literaturës ka pasë për qëllim të hedhë një vështrim dhe të bëjë një përmbledhje të dijes së mëparshme të besueshme. Në këtë metodë, synimi ka qenë që të mësohet sa më shumë që është e mundur nga përpjekjet dhe puna që kanë bërë të tjerët, punë e cila është botuar si “literaturë shkencore”.

Gjetjet në literaturë, janë të lidhura me projektin e kërkimit në një numër rrugësh, përfshirë përcaktimin e problemit, objektivave, kuadrit konceptual dhe metodave e procedurave. Kjo metodë kërkimi është zbatuar, përgjithësisht, në dy kapituj:

Kapitulli teorik “Historiku i qeverisjes së korporatave”, ku metoda e kërkimit

“Rishikimi i literaturës” na ka shërbyer për të sqaruar teoritë kryesore juridike të elaboruara nga doktrina e qeverisjes së korporatave. Kjo për faktin se, është shumë e nevojshme për kërkuesin por edhe për lexuesin, që të kërkojë natyrën juridike dhe veçoritë që paraqet fenomeni, në rastin konkret, instituti i së drejtës-qeverisja korporative, që është objekt i fokusit të vet punimit. Metoda e kërkimit “Rishikimi i literaturës”, paraqitet si metodë me vlerë për këtë kapitull, pikërisht në qasjen që ky i fundit bënë në shtjellimin e veçorive dhe vlerave të qeverisjes së korporatave. Këto momente paraqiten si vlera të veçanta në krijimin e disa mekanizmave të rëndësishëm dhe shumë të vlefshëm juridik në fazën e implementimit të këtyre teorive. Kërkuesi (autori), por edhe lexuesi, duhet të njihet me trajtimin që literatura shkencore juridike iu bën këtyre mekanizmave, për të kuptuar rëndësinë e dokumentit në fokusin e punimit.

1.2.1.2. Metoda komparative-krahasuese.

Kjo metodë perceptohet si proces i konstatimit të ngjashmërisë dhe dallimeve mes dukurive të ndryshme. Ajo ka vlerën e vet praktike në këtë punim, sepse duke krahasuar dukuritë e ndryshme shoqërore dhe duke zbuluar vetitë e njëjta ose të ndryshme nga ky krahasim, konstatohen përparësitë apo mangësitë konkrete të dukurisë të cilën dëshirojmë ta studiojmë dhe ta njohim²¹. Në punimin tonë është shumë i rëndësishëm studimi krahasues midis rendeve juridike të vendeve të krahasuara dhe rendit juridik ndërkombëtar. Kjo metodë i referohet në studim, analizës së legjislacionit kosovar, në njërën anë, dhe atij shqiptar dhe kroat, në anën tjetër, në fushën e qeverisjes së korporatave, veçorive dhe karakteristikave të tij, për të kuptuar përparësitë që kanë sistemet e krahasuara dhe rendi juridik ndërkombëtar,

²¹ Shih për këtë, Llukic D. Branimir. (2012). *Metodologjia e së drejtës* - Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, (shpëruar dhe përshtatur nga Dr.sc.Osman Ismajli), fq.183.

si dhe për të vënë në pah mangësitë që ka sistemi juridik kosovar.

Aplikimi i kësaj metode, ishte i determinuar edhe nga arsyeja se për të dhënë përgjigjen në pyetjet kërkimore, lidhur me qeverisjen e korporatave në Kosovë, ishte e domosdoshme që legjislacioni dhe praktika juridike e saj në këtë lëmi, të trajtohet duke krahasuar aspektet juridike të qeverisjes së korporatave në vendet e përmendura, si Shqipëria dhe Kroacia. Për këtë arsye, gjatë përgatitjes së punimit është bërë një studim i hollësishëm i aspekteve ligjore të qeverisjes së korporatave, në secilin prej vendeve të përmendura, dhe të gjeturat janë krahasuar mbi bazën e një grupi kriteresh të përbashkëta. Si kriter të përbashkët krahasues kemi përdorur rregulloren ligjore të Kroacisë, pasi ky shtet është anëtar me të drejta të plota në UE, kurse rregullorja që i dedikohet qeverisjes së korporatave në këtë vend, është shumë e përafruar me rregulloren e UE-së, e cila i dedikohet problematikës së përmendur. Gjatë punimit janë konstatuar ngjashmëritë dhe dallimet në mes qeverisjes së korporatave në shtetet e zgjedhura në njërën anë, si dhe shteteve të zhvilluara të UE-së nga ana tjetër. Metodë qendrore ose bazë të krahasimit, paraqet analiza e dispozitave ligjore dhe praktikës gjyqësore të vendeve të përzgjedhura, si dhe funksionin e tyre në jetën praktike të qeverisjes korporative. Kjo, për arsyen se “në ligj, të vetmet gjëra që janë të krahasueshme, janë ato të cilat plotësojnë të njëjtin funksion”²².

Krahasimin e përmendur dhe trajtimin e Kroacisë si model, e kemi bërë për arsyen se Kroacia tani është vend i aderuar në UE, kurse si theksuam më lart, ky shtet edhe rregulloren e tij ligjore në përgjithësi dhe atë për qeverisjen e korporatave, në

²² Gorezi, A. *Shareholder Rights, Executive Compensation and Stakeholder Protection: A Comparative Overview of United States of America and chosen European Union Jurisdictions*, S.J.D. DISSERTATION, Budapest, September 10th, 2011.

veçanti, e ka më të përafruar me rregulloren e UE-së. Përpos kësaj, Kroacia ka një histori dhe traditë më të gjatë të të drejtës së biznesit, në përgjithësi, edhe të veprimit praktik të korporatave dhe qeverisjes së tyre, në veçanti. Gjithashtu arsyeja e krahasimit të qeverisjes së korporatave në mes të këtij shteti dhe shtetit të Kosovës, është edhe fakti se, ky shtetë, së bashku me Kosovën, me ose pa vullnetin e tyre më se 70 vite kanë qenë pjesë përbërëse e një bashkësie shtetërore, edhe pse jo plotësisht në kushte dhe pozita të njëjta.²³

Gjithashtu, Shqipëria e cila synon anëtarësimin në UE, tanimë ka nënshkruar marrëveshjen e MSA-së²⁴ dhe ka marrë detyrime shtesë për përafrimin e legjislacionit të saj me legjislacionin e UE-së. Edhe Kosova e ka nënshkruar MSA-së dhe gjithashtu ka marrë detyrime për përafrimin e legjislacionit të saj me legjislacionin e UE-së.²⁵

Sistemet juridike të përzgjedhura për t'u krahasuar janë të përshtatshme edhe për faktin se, të tria legjislacionet radhiten në sistemin juridik kontinental (Civil Law) dhe kanë një të kaluar të përbashkët historike, gjë e cila bën që sistemet e tyre

²³ Fillimisht dallimet egzistonin në Mbreterin Serbo, Koroate, Sllovene sepse Kroacia edhe aso kohe kishte një subjektivitet kurse Kosova jo, por edhe pas vitit 1945 Kroacia kishte statusin e republikës federative me të drejta të plota, kurse Kosova deri në vitin 1974, kishte një autonomi të kufizuar, madje edhe pas kësaj kohe edhe pse pozita e saj politike dhe juridike u avancua, megjithatë ajo nuk kishte të gjitha të drejtat të cilat i takonin një republike në kuadër të Federatës Jugosllave.

²⁴ MSA hyri në fuqi me 1 prill 2009, pas ratifikimit të saj nga 25 vendet anëtare të BE-së, të cilat ishin pjesë e BE-së në momentin e nënshkrimit të MSA-së, si dhe miratimin e saj nga Parlamenti shqiptar. Procesi i ratifikimit u krye në më pak se 3 vjet dhe u finalizua me ratifikimin e marrëveshjes nga parlamenti Grek në 15 Janar 2009, duke hapur kështu rrugën Shqipërisë drejt aplikimit në BE për marrjen e statusit të vendit kandidat; <http://www.integrimi.gov.al/al/dokumenta/dokumente-strategjike/marreveshja-e-stabilizim-asociimit&page=1>,

²⁵ U nënshkrua marrëveshja e stabilizim-asociimit ndërmjet BE-së dhe Kosovës, Strasburg, 27 tetor 2015; <http://www.kryeministri-ks.net/?page=1,9,5321>.

juridike, të jenë lehtë të krahasueshme dhe të përshtatshme për krahasim.²⁶

1.2.1.3. Metoda normative juridike.

Me anë të kësaj metode është konstatuar përmbajtja e legjislacionit, i cili rregullon qeverisjen e korporatave dhe funksionimin-zbatimin në praktikë të tij. Aplikimi i metodës normative, na ka mundësuar trajtimin në aspektin kritik shkencorë të së drejtës, përkatësisht ligjeve pozitive, duke krijuar hapësirën e nevojshme për dhënien e ideve të reja për përmbajtjen dhe funksionimin e normave, përkatësisht legjislacionit, i cili rregullon qeverisjen e korporatave. Gjithashtu, aplikimi i kësaj metode ka mundësuar theksimin dhe evidentimin e të metave dhe vështirësive gjatë zbatimit praktik të legjislacionit, si dhe ka bërë të mundur sugjerimin për mënjanimin e të metave të legjislacionit përkatës.

1.2.1.4. Metoda historike.

Kjo metodë, na ka mundësuar studimin dhe analizimin e aspekteve ligjore të qeverisjes së korporatave që nga paraqitja e tyre e deri në ditët e sotme, duke i vënë në pah karakteristikat dhe veçoritë e zhvillimit të tyre nëpër periudha të ndryshme kohore-historike.

1.2.1.5. Metoda e analizës interpretuese.

Kjo metodë, është zbatuar në këtë studim, kryesisht, duke synuar interpretimin e dispozitave të kuadrit ligjor kombëtar dhe ndërkombëtar. Kjo metodë

²⁶ Kosova, në periudhën deri në fillim të shekullit XX ishte teritor i pandarë nga Shqipëria, në kuadër të Perandorisë Osmane. Pas pavarësisë së Shqipërisë, në vitin 1912, Kosova mbetet në sovranitetin e Serbisë, e cila deri në vitin 1991, bënte pjesë në Federatën Jugosllave, ku ishte edhe Kroacia. Pas pavarësisë së Kosovës, ajo ka bashkëpunim të thelluar ekonomik me të dyja vendet e përmendura, posaçërisht me Shqipërinë. Dhe e përbashkëta e tretë për të tria këto legjislacione është se, të gjitha që nga viti 1945 e deri në rrëzimin e komunizmit, ishin pjesë e sistemeve ku ishte restauruar sistemi komunist, gjegjësisht ekonomia e planifikuar.

i referohet në studim, analizës së legjislacionit kosovar në fushën e qeverisjes së korporatave, veçorive dhe karakteristikave të tij, duke tentuar që të nxjerrë në pah anët e dobëta apo mangësitë në funksion të hipotezës dhe pyetjeve hulumtuese të punimit. Gjithashtu, kjo metodë është aplikuar në studimin e vendimeve gjyqësore, duke analizuar interpretimet e jurisprudencës kosovare në lidhje me dispozitat e qeverisjes korporative.

1.2.1.6. Metoda “Studimi i rastit të veçuar” (metodë induktive).

Si metodë mjaft e popullarizuar në studimin e shkencave shoqërore, është edhe modeli i rasteve të veçanta studimore (case study), i cili në këtë punim ka gjetur zbatim, për aq sa ka qenë e mundur. Nëpërmjet metodologjisë së mësipërme është bërë nxjerrja e të dhënave, përvijimi i analizës dhe nxjerrja e konkluzioneve për të vërtetuar hipotezën dhe për t’iu dhënë përgjigje pyetjeve të ngritura kërkimore. Konsiderojmë se situata metodologjike e mësipërme garanton përqasjen e një studimi induktiv, mbi bazën e konstatimeve të rezultuara nga hulumtimi i literaturës, krahasimi i fenomeneve, analiza e dokumenteve dhe rasteve studimore. Nga kjo janë nxjerrë edhe përfundime objektive dhe janë dhënë rekomandime konkrete për qeverisjen e korporatave, si fenomen i trajtuar në këtë studim.

1.2.2. Aspekte strukturore

1.2.2.1. Struktura e tezës.

Struktura e tezës, gjithashtu i përshtatet përmbajtjes së vetë temës së shtjelluar. Kështu, në kapitullin I- Hyrje, janë shtjelluar dhe trajtuar: tema, qëllimi dhe rëndësia e hulumtimit. Në këtë pjesë të punimit, janë dhënë shpjegimet bazë lidhur me nocionin e korporatave dhe qeverisjes së korporatave. Më pastaj, është dhënë një shpjegim i shkurtër për të shpjeguar se, cili ishte qëllimi i përcaktimit tonë

për të shtjelluar këtë temë të disertacionit të doktoraturës. Dhe gjithashtu, janë dhënë shpjegimet tona lidhur me atë, se çfarë rëndësie teorike dhe praktike mund të priten nga punimi i kësaj teme. Po në këtë kapitull, kemi trajtuar aspektet metodologjike dhe strukturale të temës, ku kemi shpjeguar metodat e përdorura gjatë hulumtimit të temës së përmendur, e që si rrjedhojë e këtyre metodave, vjen edhe strukturimi i temës, i cili është dhënë këtu menjëherë pas shpjegimit të metodave në fjalë. Në kapitullin II- Skeleti teorik dhe modeli analitik, janë dhënë shpjegimet e përgjithshme lidhur me teoritë kryesore të qeverisjes së korporatave, siç janë teoria e agjencisë- Agency theory (Shareholder vs. Stakeholder theory), teoria administrimit/kujdestarisë (stjuard theory) dhe teoria e aktorëve të tjerë (staceholder theory). Më tutje, në këtë kapitull janë dhënë shpjegimet për hipotezat dhe pyetjet kërkimore, dhe në fund të kapitullit të përmendur janë shpjeguar mundësitë-avantazhet dhe kufizimet për punimin e kësaj teme. Në kapitullin III- Konteksti historik, janë dhënë dhe shpjeguar aspekte historike të qeverisjes së korporatave, në të tria vendet e trajtuara. Në kapitullin IV- Kuvendi i shoqërisë - Asambleja e përgjithshme, janë trajtuar mekanizmat për mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave të aksionarëve, si aktor kryesor të qeverisjes korporative, si dhe aspekte ligjore dhe praktike të përcaktimit të përgjegjësive dhe detyrimeve të aksionarëve. Në kapitullin V- Bordi i drejtorëve, është trajtuar roli dhe rëndësia e tij në qeverisjen e korporatave, pastaj janë shpjeguar përgjegjësitë, detyrimet dhe të drejtat e drejtorëve, gjithashtu, janë trajtuar aspektet ligjore dhe praktike të përcaktimit, fillimisht, të përgjegjësive dhe detyrimeve e pastaj edhe mekanizmat për mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave të drejtorëve, gjithashtu, si aktor kryesor i brendshëm në qeverisjen e korporatave. Në kapitullin VI- Faktorët e jashtëm-ekstern të qeverisjes korporative, janë dhënë shpjegime mbi sigurimin e

kushteve për pjesëmarrjen dhe format e ndikimit të këtyre faktorëve në qeverisjen e korporatave siç janë; punëtorët, kreditorët, investitorët, konsumatorët dhe aktorë tjerë të qeverisjes së korporatave. Në kapitullin e VII- Kodet e brendshme dhe roli i tyre në qeverisjen e korporatave janë dhënë shpjegime lidhur me kodet e brendshme dhe zbatimin e tyre në qeverisjen korporatave, në të tria juridiksionet e krahasuara. Në kapitullin e VIII- Konkluzionet dhe rekomandimet, nga të gjeturat analitike janë dhënë konkluzionet dhe rekomandimet, nga ku, kemi arritur te përfundimi se strukturimi i shpjeguar më lartë, është i përshtatshëm për trajtimin dhe shpjegimin e punimit të këtij disertacioni të doktoraturës, i cili, në radhë të parë, është i natyrës teorike.²⁷

1.3. Përfundimet nga kapitulli i parë

Nga përmbajtja e kapitullit të parë, kemi arritur në përfundimet, se;

Me Qeverisjen e korporatave, në rendë të parë synohet arritja e qëllimit ekonomik për të cilin themelohet shoqëria tregtare ose korporata. Ky qëllim është maksimizimi i fitimit, si qëllim primar i aksionarëve, dhe njëkohësisht, duke respektuar dhe kënaqur edhe interesat e aktorëve të tjerë. Për arritjen e këtij qëllimi, rregullimi ligjor i kësaj lëmie paraqitet si kusht i domosdoshëm, përkatësisht kusht pa të cilin nuk mund të funksionojë kjo sferë shumë e rëndësishme e jetës shoqrore.

Lidhur me qeverisjen e korporatave ekzistojnë një sërë përkufizimesh, të cilat dallojnë nga njëra-tjetra, varësisht nga historia, tradita, kultura dhe organizimi i sistemit ekonomik dhe juridik të vendit. Duke pasur parasysh numrin e madh të përkufizimeve lidhur me qeverisjen e korporatave, pajtohem duke e konsideruar të drejtë dhe gjithëpërfshirës përkufizimin e qeverisjes së korporatave të përcaktuar nga

²⁷ Kächelein, H. (2011). *Shkrimi akademik*, Seria e publikimeve në ekonomiks, Volumi I, albPAPER, Tiranë, fq.92.

OECD-ja, e cila qeverisjen e korporatave e përkufizon si:

*“Mjeti i brendshëm me anë të së cilit korporatat veprojnë dhe kontrollohen(...), në të cilin përfshihen një sërë marrëdhëniesh të menaxhimit të një shoqërie, bordit të saj, aksionarëve të saj dhe aktorëve të tjerë. Qeverisja e korporatave ofron edhe strukturën, nëpërmjet së cilës vendosen objektivat e shoqërisë, përcaktohen mjetet e arritjes së këtyre objektivave dhe monitorimit të performancës. Mirëqeverisja e korporatave duhet të ofrojë nxitësit e duhur për bordin dhe menaxherët për të realizuar objektiva, që janë në interes të shoqërisë dhe aksionarëve dhe për të lehtësuar monitorimin efektiv, duke nxitur kompanitë të përdorin burimet e tyre në mënyrë më efikase”.*²⁸

Qëllimi i temës është, që të sigurojë kushtet ligjore për udhëheqje efektive për korporatën dhe mbikëqyrje efikase të drejtorëve nga ana e bordit dhe përgjegjësinë e bordit ndaj korporatës dhe aksionarëve. Rëndësia e studimit qëndron në atë se, ekziston nevojë e domosdoshme për harmonizimin e interesave të ndryshme, të cilat natyrshëm ekzistojnë, fillimisht në mes të aktorëve kryesorë të qeverisjes së korporatave (aksionarëve dhe menaxherëve-drejtorëve), e më pastaj, edhe në mes të aktorëve të përmendur dhe aktorëve tjerë.

Gjithashtu, gjithnjë ka ekzistuar dhe akoma ekziston nevoja edhe për harmonizimin e interesave në mes aksionarëve dhe drejtorëve si indikator të brendshëm - intern të qeverisjes korporatave, në njërën anë, dhe pretendentëve të tjerë, posaçërisht punëtorëve, investitorëve dhe konsumatorëve si indikator të jashtëm-ekstern të qeverisjes korporatave, në anën tjetër.

²⁸ Qeverisja e Korporatave/Manual, International Finance Corporation (ifc) World Bank Group, suported by Confederzzion Svizra-State Sekretariat for Economic Affairs SEKO, fq.9, Botuar në Tiranë, Shqipëri, 2009.

KAPITULLI II: SKELETI TEORIK DHE MODELI ANALITIK I

TEMËS

Në domenin doktrinar, praktik dhe teorik, ekzistojnë qasje të ndryshme teorike për shpjegimin e qeverisjes së korporatave. Këto qasje teorike, përdorin terminologji dhe teknika të ndryshme për qeverisjen e korporatave. Dhe qasjet ose teoritë e qeverisjes së korporatave nuk janë të dhëna pa u bazuar në specifika, të cilat burojnë nga sisteme që kanë specifikat e veta ekonomike, sociale dhe ligjore, si dhe prapavijë dhe të kaluar të ndryshme historike. Nga kjo arsye në botë mbisundojnë dy teori kryesore. Ato janë teoria e agjencisë dhe teoria e aktorëve, të cilat njëkohësisht paraqesin edhe dy teoritë me të debatuar.²⁹

2.1. Teoria e Agjencisë

Teoria e agjencisë - Agency theory³⁰, u zhvillua paralelisht me krijimin dhe zhvillimin e tregut të aksioneve, si burim i ri financimi për kompanitë. Fillimi dhe zhvillimi i kësaj teorie paraqitet në Mbretërinë e Bashkuar dhe në SHBA. Pajtohemi me citimin e autorëve Pajaj Roden, Ferzaj Rezart, sipas të cilit, “Themelet e Teorisë së agjencisë, të njohura në literaturë edhe si “Teoria Principal -Agjent” ose “Vlera e Aksionarit”, bazohen në ndarjen e pronësisë nga kontrolli mbi kompaninë.

²⁹ (Smerden 2010), cituar ne: Kuadri ligjor dhe praktika e qeverisjes së korporatave në sektorin bankar Shqiptar - Pajaj Roden, Ferzaj Rezart - Tiranë: Banka e Shqipërisë, 2013, fq. 20-24. Shkarkuar nga; https://www.google.com/webhp?sourceid=chrome_com/webhp?sourceid=chrome, parë për herë të fundit me 05.09.2015 AM.

³⁰ Agency theory, e paraqitur për herë të parë në Mbretërinë e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, e cila trajton raportet mes të aksionarëve dhe menaxherëve, i njohur si raporti primar axhend.

Sipas kësaj teorie aksionari - principali - i delegon menaxherëve – agjentëve drejtimin e kompanisë. Këta të fundit kanë detyrimin për besnikëri ndaj pronarëve, duke njohur e pranuar supremacinë e interesit të aksionarëve - maksimizimin e vlerës së aksioneve - ndaj çdo interesi tjetër, (Solomon 2010, Wearing 2005, Minzt 2004, Smerdon 2010, dhe Stephen dhe Backhaus 2003). Agjentët, të cilëve u është besuar drejtimi i përditshëm i biznesit, kanë kontrollin real mbi kompaninë, duke krijuar një asimetri midis tyre dhe principalëve. Kjo asimetri është burim për konflikt të interesave ndërmjet principalit dhe agjentit. Shkaku kryesor i këtij problemi ka të bëjë me faktin se menaxherët duke pasur më shumë informacion dhe njohuri mbi kompaninë mund të joshen për të vendosur interesat e tyre, si p.sh. bonuse më të larta, mbi interesat e aksionarëve. Ky fenomen njihet në literaturë si “problemi i agjencisë”. Për të parandaluar këtë problem, shpesh bizneset mbartin kostot e agjencisë, të cilat përfshijnë kostot e monitorimit që rëndojnë mbi principalin, kostot lidhëse që rëndojnë mbi agjentin si dhe kostot që rezultojnë nga reduktimi i mundshëm i vlerës së aksioneve, si pasojë e vendimeve të agjentit, të marra në kundërshtim me interesat e principalit”³¹.

Në doktrinë, mbisundon mendimi se, kjo teori bazohet në ndarjen e pronësisë nga qeverisja ose kontrolli mbi korporatën. Për t’u arritur ky qëllim, principali-agjenti ose aksionari, është i detyruar që menaxhimin e korporatës t’ia besojë personave të tjerë, pra, drejtorëve dhe menaxherëve. Menaxherët janë të detyruar për besnikëri ndaj aksionarëve. Prandaj, për tu arritur dhe mbrojtur qëllimet dhe interesat e këtyre dy

³¹ Agency theory, e paraqitur për herë të parë në Mbretërinë e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, e cila trajton raportet mes të aksionarëve dhe menaxherëve i njohur si raporti primar axhend, fq. 20-24.

grupeve të interesit, duhet të vendosen dhe të funksionojnë një sërë mekanizmash në rendë të parë juridike, me qëllim që interesat kontradiktore të aksionarëve dhe menaxherëve, të harmonizohen dhe rregullohen në atë mënyrë që të funksionojnë në të mirë të korporatës, njëkohësisht, duke kënaqur edhe interesat e pretendentëve të tjerë.

Për zgjidhjen e problemit të agjencisë, ekziston një larmi zgjidhjesh të cilat pretendojnë zgjidhjen e këtij problemi aq sa është e mundur dhe njëkohësisht duhet pranuar faktin se edhe përkundër përpjekjeve të vazhdueshme për harmonizimin e këtyre interesave kontradiktore, “problemi i agjencisë nuk mund të zgjidhet asnjëherë në mënyrë të përsosur”³².

Ndërsa, sipas gjetjeve kryesore në literaturë, zgjidhjet potenciale të këtij problemi, mund të konsiderohen si: domosdoshmëria e monitorimit të sjelljes së agjentëve nga aksionarët, nëpërmjet ngritjes të një Bordi Drejtues profesional. Si rrjedhojë, drejtorët ngarkohen me përgjegjësi mbikëqyrëse dhe u jepen kompetenca për të punësuar apo pushuar menaxherët, zbatimi i mirë i kontratave dhe përcaktimi i qartë i të drejtave dhe përgjegjësisë të principalëve dhe agjentëve, të hartuara për të siguruar sjelljen e agjentëve në interesin më të mirë të aksionarëve.

2.2. Teoria e administrimit/kujdestarisë

³² Agency theory, e paraqitur për herë të parë në Mbretërinë e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, e cila trajton raportet mes aksionarëve dhe menaxherëve, i njohur si raporti primar axhend., fq.20-24.

Teoria e administrimit³³, konsiston në atë se menaxherët ose drejtorët, në parim kanë një mirëbesim (*fiduciary*) ndaj aksionarëve të korporatës, në të cilën janë të punësuar. Prandaj kjo konsiston në parimin se duhet t'u besohet menaxherëve-drejtorëve, me arsyetimin se, ata nuk kanë interes që të keqpërdorin besimin, i cili u është dhënë nga ana e aksionarëve. Sipas kësaj teorie, interesat e menaxherëve janë të harmonizuara me interesat e aksionarëve, pasi, duke arritur pikësynimet e aksionarëve për korporatën përmbushen edhe interesat dhe pikësynimet e menaxherëve-drejtorëve. Sipas kësaj teorie, CEO³⁴, duhet të jetë edhe kryetar i bordit dhe se nuk ka nevojë që dikush tjetër si kryetar i bordit, të ndërhyjë në urdhrat dhe vendimmarrjet e drejtorëve.³⁵

2.3. Teoria e pretendentëve

Deri sa, teoria e agjencisë bazohet në të drejtën ligjore dhe morale të aksionarëve për të mbikëqyrur kompaninë, mbi të cilën gëzojnë pretendime ligjore në lidhje me flukset e mbetura dhe të drejtat e pronësisë, teoria e pretendentëve³⁶ kërkon që menaxherët t'u japin llogari jo vetëm aksionarëve, por edhe pretendentëve të tjerë të

³³ Stewardship theory, e njohur si teoria e shërbimit, e bazuar në teoritë sociologjike, e cila bazohet në mirëbesimin, të cilin aksionarët duhet ta kenë ndaj menaxherëve dhe drejtorëve.

³⁴ Chief Executive Officer (Kryeshefi ekzekutiv).

³⁵ Për më hollësisht, shih Llaci, Sh. (2012). *Qeverisja e Korporatave*, AlbPAPER, Tiranë, fq. 95/96.

³⁶ Stakeholders theory, e njohur si teoria e pretendentëve, për herë të parë e zbatuar në Evropë, sipas së cilës drejtorët ekzekutiv dhe menaxherët përpos që duhet të përkujdesen për realizimin e interesave të aksionarëve dhe t'u japin llogari atyre, duhet të përkujdesen edhe për të drejtat e aktorëve të tjerë të qeverisjes së korporatave dhe, gjithashtu, të japin llogari për respektimin e të drejtave të këtyre të fundit.

përfshirë (*stakeholders*).

Ky arsyetim bazohet në argumentin se përveç aksionarëve, “interes” mbi kompaninë kanë edhe subjekte të tjerë, për aq kohë sa ata atakohen nga veprimtaria e saj. Këta aktorë mund të jenë punonjësit e kompanisë, kreditorët, investitorët, klientët ose konsumatorët e saj, dhe komuniteti në përgjithësi. Madje, duke pasë parasysh rëndësinë e madhe të aktorëve të tjerë dhe detyrimet ligjore të korporatës për respektimin e interesave edhe të këtyre aktorëve, e konsiderojmë të arsyeshme që të theksojmë edhe mendimet sipas të cilave; “në disa qasje ekstreme të kësaj teorie, grupi i aktorëve të interesuar mund të përfshijë mjedisin, specie kafshësh, ashtu si dhe brezat e ardhshëm të shoqërisë”. Është fjala, për të drejtat e aktorëve të tjerë (ekstern) për ruajtjen e ambientit, biodiversitetit si dhe të drejtës për ambient dhe mjedis të qëndrueshëm.

Kjo teori gjen zbatimin e saj, në vendet e Evropës perëndimore, si: në Francë dhe Gjermani, ku punonjësit si aktorë të interesuar kanë një zë të rëndësishëm në drejtimin e kompanisë. Në këto vende, përfaqësuesit e punonjësve janë pjesë e anëtarësisë së Këshillit Drejtues ose punonjësit zotërojnë aksione të kompanisë. Në këtë mënyrë, ata (punëtorët) ndikojnë mbi politikën, strategjitë dhe drejtimin e përditshëm të korporatës, nëpërmjet ushtrimit të së drejtës së votës.³⁷

“Në këtë këndvështrim, përgjegjësia shoqërore e korporatës – një çështje e lidhur ngushtë me teorinë e aktorëve - po kthehet në një instrument kyç në fitimin dhe ruajtjen e besimit të tregut në kompani.

³⁷ Me gjerësisht për teorinë e pretendentëve, “duke inkorporuar përgjegjësinë e korporatës në një diapazon të gjerë stakeholders-ish”, shih Llaci, Sh., op.cit., fq.97-99.

Përkrah vetëndërgjegjësimin të kompanive dhe vetëdijes shoqërore, si elemente kyçe të motivimit të kompanive për të përqafuar përgjegjësinë shoqërore, mjedisi social dhe politik po i shtyn gjithashtu bizneset që të jenë më të përgjegjshëm ndaj komuniteteve dhe aktorëve të tjerë të interesuar.

Teoria e aktorëve duket se është në konflikt me themelet e teorisë së agjencisë. Prandaj, pyetja kryesore që lind nga trajtimi i kësaj teorie është: A munden korporatat që në të njëjtën kohë të kënaqin interesat e aksionarëve, duke plotësuar edhe nevojat e aktorëve të tjerë të interesuar?”³⁸.

2.4. Hipoteza dhe pyetjet kërkimore

2.4.1. Hipoteza³⁹ e ngritur në punim dhe e cila kërkon vërtetim është:

Referuar rendit juridik të vendeve të zgjedhura për studim, posaçërisht në Kosovë dhe në Shqipëri, vihet re se qeverisja e korporatave ballafaqohet me mungesën e një kuadri të mirëfilltë ligjor bashkëkohor dhe me një jurisprudencë të pa konsoliduar kombëtare, e cila duket se është në hapat fillestar të saj.⁴⁰

Duke e vlerësuar rendin juridik të brendshëm në të dy komponentët e tij (legjislacioni dhe praktika gjyqësore), si dhe duke konsideruar metodologjinë shkencore të nevojshme

³⁸ Po aty.

³⁹ Hipoteza është një pohim i shprehur si një deklaram. Është një premisë që mund të përdoret si bazë për kërkimin shkencor. Babie (1986) e përcakton hipotezën si “një pritje rreth asaj se si gjërat duhet të jenë në botë, nëse parashikimet teorike janë të sakta”. Hipoteza duhet konsideruar si version formal i hamendësimit të studiuesit, i cili më pas ia nënshton këtë hipotezë një procedure të komplikuar dhe të hollësishme testimi. Kjo procedurë njihet si Testimi i Hipotezës. Hipoteza mund të parashikojë një drejtim ose të shprehë një madhënie të pranueshme mes variableve.

⁴⁰ Hipoteza bazë e kërkimit (H. 0.)

për aplikim, hipoteza e mësipërme trajtohet, në këtë kuptim, e ndarë në dy nën hipoteza:

- *Kuadri ligjor kosovar dhe shqiptar, që rregullon qeverisjen e korporatave, është i paplotë dhe ka nevojë për reformime, pasi nuk i përgjigjet plotësisht parashikimeve dhe frymës së Direktivave të UE-së, të cilat i referohen qeverisjes së korporatave, e gjithashtu as parimeve të OECD-së për qeverisjen e korporatave.*⁴¹
- *Po kështu, as praktika gjyqësore kosovare dhe shqiptare në këtë fushë, nuk e ka fituar rolin e duhur, e cila në numër dhe përmbajtje paraqitet tejte e varfër, për më tepër jo e uniformuar dhe jo standarde.*⁴²

2.4.2. Pyetjet kërkimore në këtë punim janë:

- Cilat janë mekanizmat që garantojnë *de jure* qeverisjen e korporatave në Kosovë, krahasuar kjo edhe me rendet juridike të vendeve të krahasuara, vende të tjera dhe me rendin juridik ndërkombëtar?
- A është i përshtatshëm apo konsiderohet i tejkaluar rregullimi i qeverisjes së korporatave me dispozitat përkatëse të Ligjeve për shoqëritë tregtare të vendeve objekt studimi, duke mos gëzuar një rregullim të drejtpërdrejtë specifik për qeverisjen e korporatave?
- A zbatohen dhe sa ndikojnë në praktikën kosovare dhe shqiptare, direktivat e UE-së, të cilat i referohen qeverisjes së korporatave dhe principeve të OECD-së për qeverisjen e korporatave?
- A janë plotësisht në harmoni, dispozitat e Ligjit për shoqëritë tregtare të

⁴¹ Hipoteza (H.1.)

⁴² Hipoteza (H.2.)

Republikës së Kosovës si dhe Ligjet e vendeve objekt krahasimi, me atë çka përcaktojnë dispozitat e Direktivave respektive të UE-së dhe principeve të OECD-së?

- Cila është përgjegjësia shoqërore e korporatave?
- Çfarë mund të rekomandojmë për të përmirësuar kuadrin normativ ekzistues?

Duke vlerësuar në tërësi rendin e brendshëm juridik – legjislationin aktual dhe, sidomos, praktikën gjyqësore në Kosovë, pranohet se në Republikën e Kosovës, vetëm formalisht respektohen angazhimet ndërkombëtare të pranuar me direktivat e UE-së, të cilat i referohen qeverisjes së korporatave dhe principeve të OECD-së për qeverisjen e korporatave.

2.5. Mundësitë dhe kufizimet

2.5.1. Mundësitë

Kjo temë kryesisht bazohet në literaturën e trajtuar dhe në legjislationin e vendeve të cilat janë objekt krahasimi, me mundësinë e krahasimit edhe në nivelin më të gjerë. Tema bazohet në analizimin, krahasimin dhe tregimin e përparësive dhe të metave ligjore dhe praktike në sferën e qeverisjes së korporatave në legjislationet e zgjedhura.

Vet metoda krahasuese jep mundësi për vënien në pah të aspekteve të qeverisjes së korporatave dhe atë të drejtave të aksionarëve, të drejtat dhe detyrimet e drejtorëve si dhe pretendentëve të tjerë të brendshëm dhe të jashtëm të qeverisjes së korporatave. Gjithashtu, vet natyra e punimit si studim komparativ-krahasues, ku përmes krahasimit

të aspekteve nga njëri legjislacion në tjetrin, jep mundësi që të vihen në pah të metat dhe përparësitë, si të njërit legjislacion, ashtu edhe tjetrit. Kjo njëkohësisht krijon mundësi reale për nxjerrjen e konkluzioneve dhe dhënien e rekomandimeve të vlefshme.

Dhe gjithashtu, aspektet e përzgjedhura për studim (të drejtat e aksionarëve, drejtorëve dhe pretendentëve të tjerë, si të brendshëm, ashtu edhe të jashtëm), duke qenë si aspekte kryesore të qeverisjes korporative, japin mundësi për hartimin e një punimi gjithëpërfshirës. Kjo për arsyet se interesat kontradiktore të aktorëve kryesor dhe domosdoshmëria për koherencë mes të njëjtëve, krijon mundësinë e trajtimit të problemit në mënyrë analitike dhe sintetike.

Dhe në fund, sidomos duke pasur parasysh kohën e shkurtër të paraqitjes së qeverisjes së korporatave në përgjithësi, e posaçërisht në vendet e zgjedhura dhe në Kosovë, në veçanti, mundësia për të kontribuar në vënien e praktikave të mira është më se e mundshme, pasi praktikat jo të mira, për shkak të kohës jo të gjatë të përdorimit të tyre, është më e lehtë që të tejkalohen dhe zëvendësohen me praktika të mira dhe bashkohore. Mundësi të mirë për studimin e kësaj teme, ofron edhe fakti se të tria sistemet juridike të krahasuara, i takojnë sistemit juridik kontinental-europian, kurse sa i përket modelit të qeverisjes së korporatave, që të tria vendet bazohen në modelin gjerman të qeverisjes së korporatave.

2.5.2. Kufizimet

Si edhe në shumë studime tjera edhe në këtë studim, janë paraqitur edhe kufizime të cilat kanë penguar dhe pengojnë arritjen e rezultateve të dëshiruara. Kufizimi kryesor është pamundësia për t'u fokusuar në shtjellimin dhe analizimin,

nëpërmjet metodave sasiore të kërkimit, të sjelljes tradicionale të bizneseve Shqiptare dhe Kosovare, sa kohë që në praktikë edhe pse të regjistruara si korporata, shumica e tyre janë duke vepruar si biznese familjare etj.

Kufizim tjetër, kur kemi të bëjmë me qeverisjen e korporatave në Kroaci, është distanca në largësi, pamundësia për lëvizje të lirë të autorit të punimit, vështirësia për sigurimin e vizave të udhëtimit etj. Një kufizim tjetër në punim, ishte edhe vështirësia objektive për të disponuar materiale nga veprimi praktik i qeverisjes së korporatave shqiptare dhe kosovare. Kjo vjen si rezultat i jo transparencës së bizneseve dhe kufizimit të dhënies së informatave.

Një kufizim tjetër, sidomos për qeverisjen e korporatave kosovare paraqet edhe mungesa e traditës gjyqësor dhe numri jo i shpeshtë i rasteve të trajtuara në gjykata, sa i përket problematikës së trajtuar.

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Tregtare si gjykatë e shkallës së parë me kompetencë lëndore⁴³ për zgjidhjen e çështjeve të cilat trajtohen në këtë punim, e gjithashtu edhe Gjykata e Apelit - Departamenti për Çështje Tregtare, në adresat zyrtare të tyre nuk publikojnë vendimet që merren. Gjykata Supreme e Kosovës, publikon vendimet në faqen zyrtare të saj dhe, gjithashtu, publikon përmbledhjet e vendimeve, por si rezultat i traditës jo të zhvilluar në mesin e korporatave, ofrimi i rasteve për zgjidhje gjyqësore posaçërisht nga lëmia e qeverisjes së korporatave, është shumë i rrallë.

Nga analiza që punimi paraqet sidomos për legjislacionin shqiptar dhe kosovar, do të konstatojmë se, fatkeqësisht, rregullimi ligjor i objektit të trajtuar është jo në

⁴³ Shih nenin 11 par.1 pika 1.1 dhe neni 13 i Ligjit për gjykatat; Ligji Nr. 03/ L-199 22 korrik 2010.

shkallë të duhur. Konsiderojmë se kjo është si rezultat i pamjaftueshmërisë së procesit të përafrimit të legjislacionit të brendshëm me standardet ndërkombëtare në fushën e qeverisjes së korporatave, posaçërisht zbatimit jo në shkallë të duhur të principeve të OECD-së.

Sa i përket kufizimeve, s'do mend se kufizimet paraqiten, sidomos, nga mungesa e përvojave të mirëfillta të qeverisjes së korporatave posaçërisht aspekteve, të cilat janë temë e këtij studimi. Kufizim tjetër paraqet mungesa e praktikës së bollshme, sidomos në Kosovë, e ndoshta edhe në Shqipëri. Derisa praktika juridike, e cila ka të bëjë me qeverisjen e korporatave në Kroaci, është mjaft transparente dhe vendimet e Gjykatave tregtare thuajse të të gjitha niveleve janë të publikuara në web-faqet e gjykatave, një praktikë e tillë në Shqipëri është mjaft e reduktuar, kurse në Kosovë, deri më tani, thuajse nuk ekziston fare. Në fakt, në Kosovë janë të publikuara vetëm vendimet e Gjykatës Supreme të Kosovës, e të cilat sa i përket lëmisë së qeverisjes korporative, janë shumë të pakta në numër. Kjo mungesë e praktikës gjyqësore është si rrjedhojë e zhvillimit të ulët të qeverisjes së korporatave, edhe në aspektin praktik. Gjithashtu, kufizim tjetër, paraqet edhe mungesa e literaturës vendore. Deri sa në Kroaci ka disa tekste dhe punime të publikuara në revista shkencore, në Shqipëri, librat e publikuar të cilët trajtojnë qeverisjen e korporatave nuk kalojnë numrat një shifror, kurse publikimet në revista shkencore, gjithashtu, mundë të maten me numra dyshifror. Kur i referohemi librave dhe publikimeve të shënuar në Kosovë e të cilat i dedikohen qeverisjes së korporatave, mund të themi se deri më tani nuk është botuar asnjë libër, i cili drejtpërsëdrejti i dedikohet qeverisjes së korporatave, kurse publikimi i punimeve nga kjo lëmi nuk kalon disa dhjetëra. Gjithashtu, një pengesë dhe kufizim paraqet edhe

numri i vogël i Korporatave në Kosovë. Kur i referohemi numrit të vogël të korporatave, kuptojmë numrin e volës të shoqërive aksionare (SH.A.) të regjistruara. Në fakt, për nga numri i regjstrimit të korporatave në Kosovë, vrehet numër i madh i korporatave të regjistruara si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (SH.P.K.), e të cilat sipas ligjit në Kosovë konsiderohet korporatë, por në praktikë, ky llojë i organizimit të shoqërive tregtare, në shumicën e rasteve janë të themeluara nga vetëm një person dhe veprimi faktik dhe praktik i këtyre shoqërive tregtare, vështirë se dallohet nga ndërmarrja individuale ose biznesi familjar. Si rrjedhojë e kësaj dhe në mungesë të një kulture korporative, korporatat nuk janë miqësore në kuptimin e dhënies së informacionit dhe bashkëpunimit, madje as për të dhënë kontributin e tyre për çështje studimore. Megjithatë, mendojmë se meqenëse përvojat në qeverisjen e korporatave janë të reja, duhet bërë përpjekje që këtë gjendje ta përdorim si përparësi, pasi korporatat, të cilat doemos edhe kanë nevojë për zgjidhje të drejta teorike, praktike dhe ligjore, sigurisht që i mirëpresin këto zgjidhje, me qëllim të krijimit të sigurisë juridike dhe krijimit të mjedisit të përshtatshëm për të bërë biznes. Pengesat në hulumtimin tonë, janë edhe për faktin se në Kosovë nuk posedojmë praktika të arrira nga kjo lëmi, pasi qeverisja e korporatave në Kosovë, nuk ka një përvojë më të gjatë se 20 vjeçare. Meqenëse, tani Kosova po përgatitet të inkuadrohet në mekanizmat evropiane dhe botërorë, sugjerojmë që ajo të jetë e përgatitur me legjislacionin e nevojshëm dhe bashkëkohor, i cili do të krijojë një mjedis të qëndrueshëm dhe të besueshëm për korporatat vendore dhe ato të jashtme. Konsiderojmë se është koha e duhur për rregullimin dhe përparimin e kësaj fushe juridike, me qëllim që e njëjta të jetë së paku në nivel të vendeve të rajonit, të cilat tani janë anëtarësuar në BE. Këto ambicie, jan

shfrytëzuar edhe si mundësi shtesë, me qëllimin e përfundimit të suksesshëm të këtij studimi.

Për më tepër, në kuadër të modernizimit të legjislacionit të brendshëm, rëndësi prioritare merr analiza e kujdesshme e problematikës që sjell realiteti Shqiptar dhe Kosovar për ngritjen e standardit të qeverisjes korporative, si dhe rekomandimi për themelimin e instrumenteve ligjore bashkëkohorë, në këtë fushë. Pretendojmë që, përmbushjes së këtij qëllimi, me modesti t'i kontribuoj edhe ky punim.

2.6. Përfundimet nga kapitulli i dytë

“Themelet e Teorisë së agjencisë, të njohura në literaturë edhe si “Teoria Principal - Agjent” ose “Vlera e Aksionarit”, bazohen në ndarjen e pronësisë nga kontrolli mbi kompaninë. Sipas kësaj teorie aksionari - principali - i delegon menaxherëve – agjentëve drejtimin e kompanisë. Këta të fundit kanë detyrimin për besnikëri ndaj pronarëve, duke njohur e pranuar supremacinë e interesit të aksionarëve - maksimizimin e vlerës së aksioneve - ndaj çdo interesi tjetër, zgjidhjet potenciale të këtij problemi, sipas gjetjeve kryesore në literaturë, mund të konsiderohen si: domosdoshmëria e monitorimit të sjelljes së agjentëve nga aksionarët, nëpërmjet ngritjes të një Bordi Drejtues profesional, ku drejtorët ngarkohen me përgjegjësi mbikëqyrëse dhe u jepen kompetenca për të punësuar apo pushuar menaxherët, zbatimin e mirë të kontratave dhe përcaktimin e qartë të të drejtave dhe përgjegjësi të principalëve dhe agjentëve, të hartuara për të siguruar sjelljen e agjentëve në interesin më të mirë të aksionarëve.

Teoria e administrimit, konsiston në atë se menaxherët ose drejtorët, në parim kanë një mirëbesim (*fiduciary*) ndaj aksionarëve të korporatës, në të cilën janë të

punësuar. Prandaj kjo konsiston në parimin se duhet t'u besohet menaxherëve-drejtorëve, me arsyetimin se, ata nuk kanë interesa që të keqpërdorin besimin, i cili u është dhënë nga ana e aksionarëve.

Teoria e aktorëve kërkon që menaxherët t'u japin llogari jo vetëm aksionarëve, por edhe pretendentëve të tjerë të përfshirë (*stakeholders*). Ky arsyetim bazohet në argumentin se përveç aksionarëve, “interes” mbi korporatën kanë edhe subjekte të tjerë, për aq kohë sa ata ndikohen nga veprimtaria e saj. Këta aktorë mund të jenë punonjësit e kompanisë, komuniteti, kreditorët, investitorët, klientët ose konsumatorët e saj, e tj.

Sa i përket mundësive, kjo temë kryesisht bazohet në literaturën e trajtuar dhe në legjislacionin e vendeve të cilat janë objekt krahasimi, me mundësi të krahasimeve edhe në nivelin më të gjerë. Tema bazohet në analizimin, krahasimin dhe tregimin e përparësive dhe të metave ligjore dhe praktike në sferën e qeverisjes së korporatave në legjislacionet e zgjedhura. Vet metoda krahasuese jep mundësi për vënien në pah të aspekteve të qeverisjes së korporatave dhe atë të drejtat e aksionarëve, të drejtat dhe detyrat e menaxherëve dhe drejtorëve, si dhe të drejtat e pretendentëve të tjerë, siç janë punëtorët, investitorët, kreditorët, konsumatorët etj.

Sa i përket kufizimeve, s'do mend se kufizimet paraqiten sidomos nga mungesa e përvojave të mirëfillta të qeverisjes së korporatave, posaçërisht aspekteve të cilat janë temë e këtij studimi. Kufizim tjetër paraqet mungesa e praktikës së bollshme, sidomos në Kosovë e ndoshta edhe në Shqipëri, mungesa e literaturës etj.

KAPITULLI III: KONTEKSTI HISTORIK

3.1. Hyrje në historinë e qeverisjes korporatave

Qeverisjen e korporatave e hasim që nga shekulli i XIX dhe, që atëherë e deri në kohën e sotme, shumë studiues kanë analizuar aspekte të veçanta të qeverisjes korporative. Fillimisht, kompanitë ishin të organizuara në baza familjare, gjë e cila determinonte edhe paraqitjen e grupeve të vogla të investitorëve në pronësi, në kontroll të të cilëve edhe ishte kompania. Në shekullin e XX, merr hov paraqitja dhe dalja në skenë e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar, gjë e cila në kompani, determinoi ndarjen e pronësisë nga kontrolli. Si rrjedhojë e dallimeve konceptuale në formimin e kompanive paraqiten dy modele të qeverisjes së korporatave: modeli anglo-amerikan dhe modeli i Evropës kontinentale dhe Japonisë⁴⁴. Modelet e përmendura dallohen nga ajo se modeli anglo-amerikan njihet si sistem menaxherial, që karakterizohet me tregje aktive të kapitalit, i cili është rrjedhojë e shpërndarjes ose disperzivitetit të aksioneve (marrin pjesë shumë aksionar me numër të vogël të aksioneve) dhe, pikërisht, si rrjedhojë e kësaj, ka edhe liri më të madhe të veprimit dhe menaxhimit. Nga ana tjetër, modeli i Evropës kontinentale i njohur si modeli gjerman, dhe modeli Japonez i njohur si modeli kooperues, janë të bazuar në tregje të vogla të aksioneve dhe përqendrim të pronësisë, i cili kryesisht është i koncentruar në familje të mëdha dhe të fuqishme, banka, kompani të sigurimeve dhe në shtet.⁴⁵ Më tej, pasojnë vitet 70-të dhe 80-të, të cilat karakterizohen me marrjen e kontrollit mbi menaxhimin nga ana e aksionarëve,

⁴⁴ Llaci, Sh. (2012). *Qeverisja e Korporatave*, Tiranë, fq.74.

⁴⁵ Op.cit., fq.74.

duke pretenduar në maksimizimin e vlerës së aksionit. Po në këtë periudhë, në modelin tjetër alternativ, paraqitet kodeterminimi. Pas kësaj, në vitet e 90-ta paraqitet aktivizimi i aksionarëve, i cili karakterizohet me rritjen e rëndësisë së investitorëve institucional. Në këtë kohë paraqitet edhe globalizmi, kurse në botë shtrohet debati se cili model i qeverisjes korporative të zgjidhet, duke tejkaluar kështu konsekuencën për ruajtje të pastër të modelit të qeverisjes korporative. Njëkohësisht sistemi anglo-amerikan rrit influencën e tij edhe jashtë kufijve tradicionalë.⁴⁶ Kështu nga literatura ekzistuese, si në planin kombëtar, ashtu edhe në atë ndërkombëtar shihet se, në fillim të shekullit XXI pavarësisht dallimeve në mes të modeleve, që të dyja modelet u përballën me kriza dhe skandale. Thënë më specifikisht, në vendet të cilat aplikonin modelin anglo-amerikan, u paraqiten krizat e njohura, si: Enron dhe Worldcom, kurse në vendet të cilat zbatonin modelin gjerman skandalet e njohura, të cilat lidhen me korporatat, si: Ahold, Parmalat dhe Vivendi, kriza dhe skandale këto të cilat morën përmasat e krizave ndërkombëtare. Si rrjedhojë e kësaj, u paraqitën edhe përpjekjet për perfeksionimin e modeleve të qeverisjes së korporatave, pas paraqitjes së krizës financiare globale dhe falimentimit të bankës Lehman Brothers, në Amerikë në vitin 2008. Pas kësaj, thuajse u paraqit domosdoshmëria, ose më mirë të themi nevoja, për reformimin e mëtejshëm të qeverisjes së korporatave dhe konvergjencën mes dy modeleve, drejtë modelit anglo-amerikan.⁴⁷

Në këtë kuptim fijet e qeverisjes korporative, në teori, lidhen me ndarjen e pronësisë dhe kontrollit në korporatën britaniko-holandeze, *East India Company*, në

⁴⁶ Llaci, Sh. (2012). *Qeverisja e Korporatave*, fq.74.

⁴⁷ Vep.cit., fq.75.

shekullin e XVIII, në të cilën, që atëherë, ishte formuar këshilli i drejtorëve.⁴⁸

Në literaturë mund të gjenden mendime se qeverisja korporative është paraqitur që nga momenti kur korporatat kanë mundësuar krijimin e konfliktit mes menaxherëve dhe investorëve,⁴⁹ dhe do të ekzistojë gjithnjë, deri sa aktivitetet ekonomike të zhvillohen nga korporatat, prandaj për këtë arsye është me rëndësi që debatet lidhur me raportet reciproke të drejtorëve dhe aksionarëve të korporatës, të udhëhiqen në prizmin e qeverisjes korporative.⁵⁰

Fillimi i debateve për qeverisjen korporative, si “sistem përmes së cilit drejtohet dhe kontrollohet korporata”, lidhet me vitet tetëdhjetë të shekullit të kaluar dhe SHBA-të, e pas kësaj, edhe me Anglinë, Japoninë, Australinë, Unionin European dhe më gjerë. Në shumë vende (SHBA, Belgjikë, Luksemburg) formohen grupet punuese hulumtuese në universitete eminente, si dhe institute të posaçme për qeverisjen korporative.⁵¹

Nocioni “qeverisje korporative” nuk është i definuar me definicion unik, i cili do të mundë të aplikohet në të gjitha vendet dhe në të gjitha sistemet juridike. Në literaturën relevante veçohet definicioni i dhënë nga Organizata për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ekonomik (OECD), e cila që në vitin 1999 ka aprovuar Principet e

⁴⁸ Djulić K & Kuzman T.(2015). “*Uvod u Korporativno upravljanje*” Korporativno upravljanje za članove uprave privrednog društva, Beograd, fq. 30. (“Hyrje në qeverisjen korporative” Qeverisja korporative për anëtarët e drejtorisë së shoqërisë tregtare. (Përkthim i autorit)

⁴⁹ Brian R. Cheffins, “*The History of Corporate Governance*”, ECGI Workin Papersin Law, Working Paper 148/12, siguruar nga :<http://ssrn.com/abstrakt=1975404>

⁵⁰ Po aty, 23.

⁵¹ Vasiljević M, “*Razvoj regulative upravljanja kompanijama u uporednom pravu ...*” Pravni život 11/2010, fq.5. (Zhvillimi i rregullativës së qeverisjes me korporata në të drejtën komparative...) “Jeta juridike” (Përkthim i autorit)

qeverisjes korporative, kurse qeverisjen korporative e definon si “mjete interne, përmes të cilave udhëhiqet dhe kontrollohet shoqëria aksionare ... e të cilat përfshijnë tërësinë e raporteve në mes të menaxherëve të shoqërisë, këshillit të saj, aksionarëve të saj dhe bartësve të tjerë të interesave. Qeverisja korporative siguron edhe strukturën përmes së cilës vendosen qëllimet e korporatës dhe përcaktohen mjetet për arritjen e këtyre qëllimeve si dhe përcjelljen e rezultateve. Qeverisja e mirë korporative duhet t’u ofrojë stimulim adekuat udhëheqësve ekzekutiv dhe anëtarëve të këshillit, në mënyrë që të arrihen qëllimet të cilat janë në interes të korporatës dhe aksionarëve dhe të sigurojë mbikëqyrje efikase, në mënyrë që t’i mundësojë korporatës, shfrytëzimin efikas të resurseve”⁵².

3.1.1. Historia e qeverisjes së korporatave në Kosovë

Kosova, në kuadër të ish-Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (RSFJ-së), për më se 50 vite ishte e shkëputur nga ekonomia e tregut dhe bazohej në ekonominë e planifikuar socialiste. Prandaj, si rrjedhojë e kësaj, edhe në këtë vend, jeta ekonomike zhvillohej përmes ndërmarrjeve në fillim shtetërore e më vonë shoqërore, ku nuk bëhej fjalë as për të drejtën tregtare as për të drejtën e shoqërive tregtare, dhe si përfundim logjik, mungesa e këtyre dy të parave determinonte edhe mungesën e nevojës për qeverisjen e korporatave. Megjithatë zhvillimet e kësaj lëmie shoqërore në Kosovë, patën një dallim dhe specifikë nga dy legjislacionet e përmendura (legjislacioni i Shqipërisë dhe Kroacisë). Kjo ishte e determinuar me pozitën e saj, jo plotësisht të lirë, në kuadër të ish RSFJ-së. Nga kjo, me paraqitjen e ligjit për ndërmarrjet të ish-RSFJ-

⁵² Theksuar sipas Korporatës ndërkombëtare financiare, Qeverisja korporative- Manual, fq.9.

së⁵³, kur u lejua mundësia e themelimit të ndërmarrjeve private dhe kur prona private u barazua me pronën shoqërore, në Kosovë në fund të viteve të 80-të dhe në fillim të vitit 1990, u fillua me regjistrimin e shoqërive tregtare në cilësi të korporatave, siç ishin Shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar (SH.P.K.) dhe Shoqëritë aksionare (SH.A.). Me këtë ligj është siguruar baza juridike për qeverisjen e korporatave, si dhe janë dhënë përkufizimet për realizimin dhe mbrojtjen e të drejtave të të gjithë aktorëve në kuadër të qeverisjes së korporatave. Organizimi i këtyre ndërmarrjeve, në strukturë të organizimit ishte i njëjtë, me strukturën e organizimit që kanë korporatat tani, në bazë të Ligjit për shoqëritë tregtare. Por ky zhvillim i qeverisjes së korporatave, pak kohë nga fillimi i aplikimit të Ligjit mbi ndërmarrjet, thuajse u shua në tërësi.⁵⁴

Kështu, në rrethana të tilla, nuk mund të flasim më për qeverisje normale të korporatave, pasi e gjithë jeta ekonomike në Kosovë zhvillohej nën diktatin e legjislacionit të Serbisë. Si rrjedhojë e kësaj, pas vitit 1990 e deri në çlirimin e Kosovës, me 12 qershor 1999⁵⁵ dhe vendosjen e administratës së UNMIK-ut⁵⁶, të gjitha përpjekjet e afaristëve mund të përshkruhen si veprime improvizuese, me qëllim sigurimin e përkohshëm të ekzistencës dhe mbijetesës ekonomike dhe shoqërore.

⁵³ Ligji për ndërmarrjet i SFRJ (77/88), ndryshuar dhe plotësuar me Ligjet e RSFJ nr. 40/89, 46/90 dhe 61/90.

⁵⁴ Kjo ka ndodhur nga fakti se në gjysmën e vitit 1990, Serbia suprimoi Kuvendin e Kosovës dhe nga ajo kohë deri me 12.06.199, Kosova ishte e privuar për të zbatuar ligjet e veta në të gjitha sferat e jetës, e edhe në të drejtën tregtare në përgjithësi dhe të drejtën e korporatave në veçanti.

⁵⁵ Data e largimit të forcave policore, ushtarake dhe administratës serbe, nga Kosova.

⁵⁶ The United Nations Interim Administration Mission in Kosovo (UNMIK) Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë.

Pas luftës në Kosovë, nxirren dy Rregullore të UNMIK-ut⁵⁷, me të cilat filloi regjistrimi i ndërmarrjeve dhe kjo vazhdoi deri me nxjerrjen e ligjit për shoqëritë tregtare, i cili me ndryshimet dhe plotësimet e vitit 2011 është akoma edhe sot në fuqi dhe, i cili si ligj themelor për shoqëritë tregtare, përmban edhe dispozitat të cilat i dedikohen qeverisjes së shoqërive tregtare të kapitalit, siç janë: SH.A. dhe SH.P.K., të cilat sipas këtij ligji trajtohen si korporata⁵⁸. Prandaj ky ligj, së bashku edhe me një sërë ligjesh të tjera përcjellëse, synojnë që të rregullojnë në tërësi fushën e qeverisjes së korporatave në Kosovë.

Tani është në miratim e sipër Ligji për shoqëritë tregtare. Në fakt, Projektligji për Shoqëritë Tregtare, është miratuar në mbledhjen e 137 të - Qeverisë së Republikës së Kosovës me vendim Nr.01/137 me datë 14.03.2017. Ligji i ri për Shoqëritë Tregtare, sipas përmbajtjes së propozuar, përpos tjersh ka për qëllim edhe përafrimin dhe harmonizimin e pjesërishëm të tijë me Direktiva të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit.⁵⁹

⁵⁷ Rregullorja nr.2000/8 Mbi dispozitën e regjistrimit të biznesit në Kosovë, UNMIK / REG / 200/8, 29 shkurt 2000 dhe Rregullore nr.2001/6 Për shoqëritë tregtare, REG/UNMIK, 8 shkurt 2001.

⁵⁸ Ligji për shoqëritë tregtare i Kosovës, nr.02/L-123, miratuar me 27.09.2007, shpallur me 27.05.2008 dhe Ligji nr.2011/04-L-006, për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për shoqëritë tregtare nr.02-L-123 për shoqëritë tregtare, miratuar me 23.06.2011, shpallur me 08.07.2011. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-123 për Shoqëritë Tregtare, është miratuar në mbledhjen e 137 të - Qeverisë së Republikës së Kosovës me vendim Nr.01/137 me datë 14.03.2017, i cili ende nuk është aprovuar nga Kuvendi i Kosovës.

⁵⁹ Për më hollësisht, shih neni 1 par.2 pika 2.1-2.7, të Projektligjit të përmendur.

3.1.2. Historia e qeverisjes korporative në Shqipëri

Në dy dhjetëvjeçarët e fundit Shqipëria si shtet dhe shoqëri, ka kaluar një tranzicion relativisht të gjatë, pas shkëputjes nga sistemi komunist 50 vjeçar, drejt një regjimi demokratik e të ekonomisë së lirë të tregut. Kalimi në fillim të viteve nëntëdhjetë të shekullit të kaluar, nga planifikimi i centralizuar në ekonominë e tregut të lirë solli ndryshime strukturore rrënjësore në Shqipëri, përfshirë këtu politika të reja makroekonomike dhe reforma strukturore, të tilla si: liberalizimi i çmimeve dhe tregtisë, privatizime në shkallë të gjerë, reformash fiskale, hapje të vendit ndaj kapitalit të huaj etj.⁶⁰ Edhe në Shqipëri, trajtimi i problemit të qeverisjes së korporatave, u aktualizua që në fillimin e organizimit të ekonomisë së tregut, gjë e cila përkoi me daljen në skenë, në kuadër të ekonomisë botërore, të aktivizimit të aksionarëve e pasuar me rritjen e rëndësisë së investitorëve institucional.⁶¹

I gjithë ky ndryshim, padyshim që lindi nevojën edhe për rregullimin ligjor-juridik të lëmisë së të drejtës tregtare dhe të drejtës së kompanive në përgjithësi, si edhe të lëmisë së qeverisjes së korporave, në veçanti.

3.1.3. Historia e qeverisjes së korporatave në Kroaci

Kroacia si republikë e ish-RSFJ -së, gjithashtu për 50 vite ishte e shkëputur nga ekonomia e tregut dhe bazohej në ekonominë e planifikuar socialiste, ku jeta ekonomike

⁶⁰ Pajaj R & Rezart Ferzaj, Kuadri ligjor dhe praktika e qeverisjes së korporatave në sektorin bankar Shqiptar-/Pajaj Roden, Ferzaj Rezart-Tiranë: Banka e Shqipërisë, 2013, fq.11;www.bankofalbania.org, (e parë më 18.07.2015)

⁶¹ Llaci Sh, (2012). *Qeverisja e Korporatave*, Tiranë, fq.74.

zhvillohej përmes ndërmarrjeve në fillim shtetërore e më vonë shoqërore. Në një pozitë të tillë, natyrisht që nuk bëhej fjalë as për të drejtën tregtare, as për të drejtën e shoqërive tregtare dhe, si rrjedhojë e kësaj, as për qeverisje të korporatave. Për këtë arsye, qeverisja e korporatave u paraqit në vitin 1988, me nxjerrjen e ligjit mbi ndërmarrjet të ish-RSFJ-së⁶², kur u lejua mundësia e themelimit të ndërmarrjeve private dhe kur prona private u barazua me pronën shoqërore. Në këtë periudhë kohore, fillon edhe themelimi i ndërmarrjeve private në cilësi të korporatave, siç ishin: shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar⁶³ (SH.P.K.) dhe shoqërit aksionare⁶⁴ (SH.A.). Organizimi i këtyre ndërmarrjeve kishte të njëjtën strukturë që kanë sot korporatat, dhe si i tillë ka funksionuar deri në pavarësinë e Kroacisë, e cila pas pavarësimit, me një ligj ka adoptuar shumicën e ligjeve të ish-RSFJ-së, të cilat nuk ishin në kundërshtim me sovranitetin e saj dhe as nuk ishin diskriminuese. Disa vite pas adoptimit të ligjit të përmendur, Kroacia nxori ligjin për shoqëritë tregtare, i cili pas disa ndryshimeve dhe plotësimeve, është edhe sot në fuqi.⁶⁵ Edhe Kroacia, sikurse edhe shtetet e përzgjedhura, të cilat janë objekt i këtij studimi, startoi me trajtimin e problemit të qeverisjes së korporatave, që në fillimin e organizimit të ekonomisë së tregut. Edhe në rastin e Kroacisë, ky fillim përkoi me daljen në skenë, në kuadër të ekonomisë botërore,

⁶² Ligji i përmendur në pjesën: Historia e qeverisjes së korporatave në Kosovë në këtë punim, 3.1.1.

⁶³ Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar SH.P.K., në kroatisht; *Društvo sa ogranicenom odgovornosću* D.O.O.

⁶⁴ Shoqëria aksionare sh.a., në kroatisht; *Akcionarsko Društvo* A.D.

⁶⁵ Zakon o trgovačkim društvima, Republike Hrvatske, br.081-99-693/1, Zagreb, 23 Studenoga 1993 sa svim izmenama i dopunama do 2009 god., (Ligji për shoqëritë tregtare i Republikës së Kroacisë, nr.081-99-693/1 23, Zagreb, nëntor 1993 me ndryshimet dhe plotësimet deri në vitin 2000) *Përkthimi i autorit.*

të aktivizimit të aksionarëve, e pasuar me rritjen e rëndësisë së investitorëve institucional.

3.2. Përfundimet nga kapitulli i tretë.-

Qeverisjen e korporatave e hasim që nga shekulli i XVIII, dhe që nga atëherë e deri në kohën e sotme, shumë studiues kanë analizuar aspekte të veçanta të qeverisjes korporative.

Si rrjedhojë e dallimeve konceptuale në formimin e korporatave paraqiten dy modele të qeverisjes së korporatave: modeli anglo-amerikan dhe modeli i Evropës kontinentale dhe Japonisë⁶⁶. Modelet e përmendura dallohen ngase modeli anglo-amerikan njihet si sistem menaxherial, i cili karakterizohet nga tregje aktive të kapitalit, çka është rrjedhojë e shpërndarjes ose disperzivitetit të aksioneve (marrin pjesë shumë aksionar me numër të vogël aksionesh), dhe pikërisht, si rrjedhojë e kësaj, ka edhe liri më të madhe të veprimit dhe menaxhimit. Në anën tjetër, modeli i Evropës kontinentale i njohur si modeli Gjerman, dhe modeli Japonez i njohur si modeli kooperues, janë të bazuar në tregje të vogla të aksioneve dhe përqendrim të pronësisë, i cili kryesisht është i koncentruar në familje të mëdha dhe të fuqishme, banka, kompani të sigurimeve dhe në shtet. Pas kësaj, thuajse u paraqit domosdoshmëria, pra, nevoja për reformimin e mëtejshëm të qeverisjes së korporatave dhe konvergjencën në mes të dy modeleve, me orientim drejtë modelit anglo-amerikan.

Për këtë arsye mund të përfundojmë se, në Kosovë, qeverisja e korporatave u

⁶⁶ Llaci Sh, (2012). *Qeverisja e Korporatave*, Tiranë, fq.74.

paraqit në vitin 1988, me nxjerrjen e ligjit mbi ndërmarrjet e ish-RSFJ-së. Pas luftës në Kosovë nxirren dy Rregullore të UNMIK-ut⁶⁷, me të cilat filloi regjistrimi i ndërmarrjeve dhe kjo vazhdoi deri me nxjerrjen e ligjit për shoqëritë tregtare, me ndryshimet dhe plotësimet e mëtejme të tijë.

Edhe në Shqipëri, trajtimin e problemit të qeverisjes së korporatave, u aktualizua që në fillimin e organizimit të ekonomisë së tregut, në fillimin e viteve të 90-të të shekullit të kaluar.

Gjithashtu, edhe në Kroaci, qeverisja e korporatave u paraqit në vitin 1988, me nxjerrjen e ligjit mbi ndërmarrjet e ish-RSFJ-së, kur u lejua mundësia e themelimit të ndërmarrjeve private dhe kur prona private u barazua me pronën shoqërore.

⁶⁷ Rregullorja nr.2000/8 Mbi dispozitën e regjistrimit të biznesit në Kosovë, UNMIK / REG / 200/8, 29 shkurt 2000 dhe Rregullore nr.2001/6 Për shoqëritë tregtare, REG/UNMIK, 8 shkurt 2001.

KAPITULLI IV: KUVENDI I SHOQËRISË - ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

4.1. Kuvendi i shoqërisë - Asambleja e përgjithshme e aksionarëve në Kosovë

4.1.1. Të drejtat qeverisëse-politike

Nga vlrësimi i doktrinës juridike ku trajtohen të drejtat e aksionarëve, rezulton se të drejtat e aksionarëve ndahen në dy grupe kryesore. Kjo ndarje i referohet të drejtave qeverisëse dhe të drejtave pasurore. Duke pasur për bazë strukturën e këtij punimi, ne kemi trajtuar vetëm të drejtat politike ose qeverisëse të aksionarëve. I kemi trajtuar posaçërisht këto të drejta, pasi realizimi i tyre më tepër i përket aspekteve të qeverisjes korporative.

4.1.2. E drejta për emërimin dhe shkarkimin e drejtorëve menaxhues

Nga të drejtat qeverisëse me rëndësi për qeverisjen korporative është e drejta e aksionarëve ose pronarëve për emërimin e drejtorëve. Kjo e drejtë njihet si njëra ndër të drejtat më të rëndësishme politike ose qeverisëse të aksionareve. Realizimin e kësaj të drejte, aksionarët e realizojnë përmes Kuvendit të shoqërisë - Asamblesë së përgjithshme të shoqërisë dhe konform rregullave të përcaktuara me ligj dhe statutit të korporatës, akte këto me te cilat është rregulluar mënyra dhe procedura e votimit për emërimin dhe shkarkimin e drejtorëve.⁶⁸ Nga rëndësia që ka kjo e drejtë e aksionarëve për qeverisjen e korporatave, pronarët e shoqërisë duhet të përcaktojnë në statut ose në marrëveshjen e shoqërisë, personin ose të gjithë personat të cilët i kanë zgjedhur për të

⁶⁸ Për më tepër lidhur me të drejtat e aksionerëve lidhur me monitorimin, votimin pro dhe kundër drejtorëve etj., shih; Llaci, Sh., op.cit., fq.79. Gjithashtu, shih nenin 13.8.1.5 të Statutit të KOST sh.a.

shërbyer si drejtorë menaxhues të shoqërisë.⁶⁹ Në rastet kur aksionarët emërojnë më shumë se një person për të ushtruar detyrën e drejtorit menaxhues, në raste të tilla, me marrëveshjen e shoqërisë mund të përcaktohen tituj, detyra dhe autorizime të ndryshme për secilin prej tyre. Një drejtor menaxhues në këtë pozitë mund të caktohet, largohet ose zëvendësohet vetëm në bazë të votës së pronarëve-aksionarëve. Për emërimin e një personi në pozitën e drejtorit menaxhues, rregullat *“kërkojnë votën pohuese të së paku dy të tretave (2/3) të aksioneve të lëshuara dhe të paguara, të përfaqësuara në Mbledhjet e Përgjithshme përkatëse”*.⁷⁰

Drejtorët menaxhues mund të zgjidhen nga radha e pronarëve-aksionarëve, por mund të jetë edhe jashtë radhës së pronarëve të korporatës. Kushti themelor për emërim në detyrën e drejtorit menaxhues, është se këtë detyrë mundë ta ushtrojë vetëm personi fizik⁷¹. Gjithashtu është rregull imperativ se, një person juridik nuk mundet të ushtrojë detyrën e drejtorit e as detyrën e bordit të drejtorëve të një shoqërie tregtare. Sa i përket mandatit të drejtorit menaxhues është përcaktuar se, drejtori i zgjedhur menaxhues vazhdon të mbetet në këtë detyrë derisa të shkarkohet ose zëvendësohet me votën e pronarëve, ose derisa të japë dorëheqjen.⁷²

Gjithashtu, drejtori menaxhues shkarkohet me votën e pronarëve, përveç se nëse është përcaktuar ndryshe në marrëveshjen e shoqërisë. Është shumë me rëndësi se, në rastin e vendosjes për shkarkimin e një drejtori menaxhues, pronarët nuk kanë nevojë të

⁶⁹ Shih nenin 15 të Statuti të Postës dhe Telekomit të Kosovës SH.A.nr.01-5810/09, dt.20.07.11, <http://www.postakosoves.com/repository/docs/Statuti.pdf>,

⁷⁰ Sih për këtë nenin 13.8.3 të Statutit të KOST sh.a., neni 23; c;iv të Statutit të përmënuar të ProCredit Bank sh.a. në Kosovë;; neni 9 par.1 pika 4 të Statutit të Byros Kosovare të Sigurimit sh.a., e tj.

⁷¹ Neni 109.1, , i Ligjit për Shoqëritë Tregtare të Kosovës.

⁷² Po Aty. Neni 109.

deklarojnë arsyen për këtë shkarkim.⁷³ Si rrjedhojë e kësaj, edhe personi i shkarkuar nuk ka të drejtë të kërkojë nga pronarët e korporatës, arsyen për shkarkimin e tij.⁷⁴ Një qëndrim i tillë doktrinar dhe ligjor, pa ndonjë dallim, është hasur edhe në doktrinat juridike dhe legjislacionet e krahasuara, ku është përcaktuar se; “aksionarët, nuk kanë obligim që të tregojnë arsyen e shkarkimit të drejtorëve”. Kështu, përmes realizimit të të drejtës për zgjedhjen e drejtorëve menxhues, aksionarët ushtrojnë të drejtën e tyre në qeverisjen e korporatës, pronarë të së cilës janë.

4.1.3. Mënyra e zgjedhjes dhe mandatimit të drejtorëve menaxhues

Të gjithë anëtarët e bordit të drejtorëve të shoqërisë, zgjidhen apo rizgjidhen nga aksionarët në çdo mbledhje të tyre vjetore me një mandat, i cili skadon në përmbylljen e mbledhjes së ardhshme të aksionarëve. Përpos mundësisë së rregullt të zgjedhjes së drejtorëve në mbledhjet vjetore të aksionarëve, është paraparë mundësia që, ndonjëri ose të gjithë anëtarët e bordit të drejtorëve, të mund të zgjidhen nga aksionarët edhe në një mbledhje të jashtëzakonshme të caktuar për këtë qëllim. Ky rregull është parimor dhe si i tillë zbatohet çdoherë në këtë mënyrë, përveç, nëse përjashtimisht është përcaktuar ndryshe me statut ose me një vendim të miratuar nga aksionarët. Në mënyrë që veprimtaria e bordit të drejtorëve të vazhdojë pa pengesë, ligji dhe praktika juridike, kan

⁷³ Shih vendimin e Kompanisë Rajonale të Ujrave-KRU “Bifurkacioni”sh.a. Ferizaj, vendimi nr. 2210, dt. 01.12.2015. Edhe pse në vendimin e përmendur janë dhënë arsyet e shkarkimit, në një paragraf të veçantë është dhënë shpjegimi se bazuar në “nenin 21, pika 21.1... Kryeshefit ekzekutiv... mundë ti ndërpritet kontrata e punës pa deklarimin e arsyes”.

⁷⁴ Neni 109.3, i Ligjit për Shoqëritë Tregtare të Kosovës..

përcaktuar rregullin sipas së cilit, pavarësisht nga skadimi i mandatit të drejtorit, aksionarët kanë të drejtë të kërkojnë që një drejtor të vazhdojë ushtrimin e detyrave të tij, deri atëherë kur të zgjidhet pasardhësi i tij. Në praktikën juridike si dhe bazuar në legjislacionin e zbatueshëm, nuk është e kufizuar mundësia e rizgjedhjes së drejtorëve,. Nga kjo arsye, rezulton që drejtori mund të rizgjidhet për një numër të pa kufizuar mandatesh, natyrisht, nëse për këtë vazhdim aksionarët i japin besimin.

Lidhur me kufizimet për zgjedhejn e një personi për të ushtruar detyrën e drejtorit, ekziston vetëm një kufizim. Kufizimi i referohet faktit që: “asnjë zyrtar, menaxher ose punonjës i kompanisë, nuk mund të shërbejë ose të propozohet për drejtor të kompanisë”⁷⁵. Një kufizim i tillë, buron nga arsyet për pavarësi të drejtorëve dhe ka për qëllim që të shmangë konfliktin e interesit dhe të sigurojë pavarësinë, paanshmërinë dhe kompetencat e drejtoreve, në ushtrimin e detyrave për interesin e korporatës.. Gjithashtu, kufizimi i përmendur, njëkohësisht paqitet edhe si kusht i domosdoshëm për të siguruar një qeverisje të mirë korporative dhe, njëkohësisht, edhe kusht për mbrojtjen objektive, të drejtë, të ligjshme dhe më të mirë, të interesave të aksionarëve.

4.1.4. Votimi Kumulativ për zgjedhjen e drejtorëve

Në të gjitha rastet kur organizohen zgjedhjet për drejtorët e shoqërisë aksionare, secili aksionar ka të drejtën e votës në bazë të numrit të aksioneve në pronësi të tij dhe këto vota i dedikon për të gjithë personat që janë kandiduar për drejtor. Sistemi i tillë i votimit njihet si sistem direkt i votimi, dhe ky sistem bazohet në zbatimin e parimit; një aksion një votë. Në këtë formë të votimit, sipas së cilit çdo aksion jep një votë, ndërkohë që dihet se një aksionar (ose grup i aksionarëve) të cilët zotrojnë ose

⁷⁵ Shih nenin 171, të Ligjit për Shoqëritë Tregtare të Kosovës.

posedojnë më shumë se 50% të aksioneve, ai aksionar (ose grup i aksionarëve) do të ketë mundësi që pa konkurrencë të zgjedhë të gjithë anëtarët e Bordit drejtues. Kjo, arrihet në at mënyrë që shumicën e votave të tij, ta jap për zgjedhjen e kandidatëve të vet për secilin vend në Bord. Nga kjo arsye, me të drejtë është konstatuar se, është e vërtetë që teknika e votimit direkt nuk jep mundësi që aksionarët e vegjël të jenë proporcionalisht të përfaqësuar në Bordin e drejtorëve.

Për shkak të kësaj, në interes të qeverisjes së mirë korporative, aplikohet skema e votimit kumulativ, e cila sot është pranuar në shumë ligje, si në vendet e zhvilluara, ashtu edhe në vendet në tranzicion. Një metodë-teknikë e tillë e votimit është e zbatueshme edhe në Kosovë, nga se e njëjta është paraparë edhe me ligjin për shoqritë tregtare të Kosovës. Votimi kumulativ, si mundësi e mbrojtjes së të drejtave të aksionarëve të vegjël, posaçërisht është i rëndësishëm për investitorët institucional, të cilët, gjithnjë e më tepër, nga pozicioni drejtues pasiv kalojnë në atë aktiv. Një teknikë e tillë e votimit, është krijesë e të drejtës anglosaksone që tangon sistemet e së drejtës kontinentale, posaçërisht, shoqëritë me numër të madh të aksionarëve.⁷⁶

Në të kundërtën, aksionari ka mundësi që t'i mbledhë votat në fjalë dhe t'i japë një kandidati aq vota sa ka edhe drejtorë që do të zgjidhen, shumëzuar me aksionet në fjalë, ose të shpërndajë votat e tilla të mbledhura në mënyrë kumulative, në çfarëdo proporcioni, ndërmjet numrit të kandidatëve⁷⁷. Me formën kumulative të votimit, aksionarëve të vegjël iu është dhënë mundësia që me votat e tyre kumulative të dhëna

⁷⁶ Mirko V., (2006). *Modeli i trendovi upravljanja akcionarskim društvom u uporednom pravu i praksi*“, Privreda i pravo, Beograd, , str. 39.

⁷⁷ Shih neni 172, i Ligjit për Shoqëritë Tregtare të Kosovës.

vetëm një drejtori, të kenë mundësi të zgjedhin drejtorin për të cilin mendojnë se iu përshtatet atyre dhe i cili më së miri do të mbronte interesat e tyre.⁷⁸

Votimi kumulativ




Tabela 1. Sistemi kumulativ i votimit.⁷⁹

Në rastin konkret të treguar në tabelë, mbrojtja e interesave të aksionarëve minoritar bëhet si në vijim:

“Aksionari i madh A1 posedon 60% të aksioneve të korporatës së caktuar, përkatësisht 600 aksione. Aksionarët minoritar - të vegjël B1 dhe B2 posedojnë nga

⁷⁸ Me këtë mënyrë të votimit, psh. Një aksionar i cili ka 10 vota, nese duhet të zgjidhen 10 drejtor, ai ka mundësi ta votojë secilin nga ata, duke ushtruar ndikimin e tij për secilin drejtor me nga 10 vota, ose të gjitha të drejtat e tij 10x10 vota, në mënyrë kumulative, t’i deponojë në llogari të vetëm njërit nga drejtorët, çka do të thotë se në këtë rast, nga aksionari në fjalë, njëri nga drejtorët do të merrte 100 vota, deri sa të tjerët nuk do të merrnin mbështetjen e tij me asnjë votë. Shih për këtë, Llaci, Sh., op.cit., fq.139.

⁷⁹ shkarkuar nga <http://www.vps.ns.ac.rs/SB/2014/4.11.pdf>), përkthimi nga autori i punimit.

15% të aksioneve, përkatësisht 150 aksione, ndërsa aksionari B3 posedon 10% të aksioneve, përkatësisht 100 aksione. Aksionari i madh A1 posedon gjithsej 3000 vota, aksionarët B1 dhe B2 nga 750 vota, ndërsa aksionari B3 posedon 500 vota. Aksionari A1, për shkak të mundësisë që të jetë i mbivotuar, ka vendosur që votat e tij t'i shpërndajë në të gjithë kandidatët në mënyrë të barabartë (nga 600), në mënyrë që të jetë i sigurt se shumica e kandidatëve të propozuar do të zgjidhen. Të gjithë aksionarët e vegjël kanë arritur marrëveshjen që të votojnë për aksionarët B1 dhe B2, të cilët janë kandiduar për bordin e drejtorëve. Numri i përgjithshëm i votave, të cilin e kanë poseduar tre aksionarët e vegjël-minorant (2000) i është shpërndarë dy kandidatëve, në mënyrë që ata kanë fituar nga 1000 vota. Dhe në fund shihet se të dy kandidatët e aksionarëve të vegjël-minorant janë zgjedhur pasi kanë pasur ma shumë vota, sesa kandidatët e aksionarit të madh A1 (1000 kundër 600). Për këtë, dy nga pesë drejtorët, janë përfaqësues të aksionarëve të vegjël, gjë e cila i përgjigjet shumë më tepër raportit real të forcave dhe numrit në mes të aksionarëve të mëdhenj dhe atyre të vegjël”.⁸⁰

Me këtë formë të votimit nga ana e aksionarve, në juridiksionin dhe praktikën juridike të Kosovës, ka tendencë që kërkesa për mbrojtjen e aksionarëve të vegjël-

⁸⁰ Demokracija i participacija akcionara; Pregledni rad; **Vuk Radulović***, doktorant Pravnog fakulteta, Univerziteta u Novom Sadu; Škola biznisa; Broj 2/2014; UDC 347.72.031; DOI 10.5937/skolbiz2-7099; (Demokracia dhe participimi i aksionarve; Punim i zgjedhur; Vuk Radulović, Doktorant në Fakultetin juridik, Universiteti në Novi Sad; Shkolla e biznesit; Nr2/2014; UDC 347.72.031; DOI 10.5937/skolbiz2-7099, shkarkuar nga <http://www.vps.ns.ac.rs/SB/2014/4.11.pdf>, shikuar për herë të fundit me 05.06.2016, përkthyer nga autori i punimit.

minorent, të përmbushet në tërësi. Një kërkesë e tillë, buron edhe nga parimet e OECD-së sipas të cilave janë paraparë detyrimet për krijimin e kushteve ligjore dhe praktike për mbrojtjen e të drejtave të aksionarëve të vegjël-minorent. Kjo zgjidhje është analoge me, principet e OECD-së për qeverisjen e korporatave. Sipas kësaj zgjidhje, e drejta e aksionarëve për të marrë pjesë në kuvendin e shoqërisë është e drejtë themelore dhe e patjetërsueshme e aksionarëve. Principet e përmendura kanë përcaktuar domosdoshmërinë për garantimin dhe sigurimin e kësaj të drejte, sidomos kur është fjala për aksionarët e vegjël-minorent, me qëllim që të njëjtëve t'u mundësohet të marrin pjesë aktivisht në kuvendin e aksionarëve dhe të realizojnë të drejtat dhe interesat e tyre qeverisëse në korporatë. Gjithashtu, edhe ndërmarrjet shtetërore mund të krijojnë mekanizma të caktuara në mënyrë të njëjtë, ashtu si është paraparë me parimet e OECD-së për korporatat, aksionet e të cilave janë të kuotuar në bursë. Sigurimi i arritjes së të drejtës së përmendur, ka mundësi të rregullohet, duke kërkuar “shumicë të kualifikuar për vendime të caktuara të aksionarëve dhe kur konsiderohet e dobishme sipas rrethanave, duhet të vijë në shprehje edhe mundësia e aplikimit të rregullave të posaçme të zgjedhjes përmes votimit kumulativ”⁸¹.

4.1.5. Parimi i Përgjegjësisë së aksionarëve

Në parim, shoqëria aksionare është përgjegjëse për të gjitha borxhet dhe detyrimet e tjera dhe ajo përgjigjet para personave të tretë, me tërë asetet dhe pasurinë e

⁸¹ Për me tepër, shih, OECD smjernice za korporativno upravljanje u državnim preduzećima, fq. 31. Botuar nga; Organizacija za ekonomsku suradnju i razvoj-Revicon d.o.o. Sarajevo. Shkarkuar nga: <http://www.oecd.org/daf/ca/41814777.pdf>, Shikuar për herë të fundit, me datë: 11.10.2015.

saj. Nga vet natyra e korporatave si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, asnjë person, shoqëri tregtare ose shoqëri tjetër nuk është përgjegjëse për detyrimet e shoqërisë aksionare vetëm për shkak se është aksionar në këtë shoqëri.⁸²

Përkundër faktit se ligji ka përcaktuar që aksionarët të mos përgjigjen për detyrimet e shoqërisë, çka do të thotë se parimisht ata përgjigjen vetëm deri në masën e mjeteve të deponuara në shoqëri, janë të njohura edhe rastet kur përjashtimisht aksionarët përgjigjen për detyrimet e shoqërisë⁸³. Nga kjo arsye, në juridiksionin dhe doktrinën juridike të Kosovës, vlen parimi i përgjegjësisë së aksionarëve për dëmin e shkaktuar personave të tretë, nëse aksionarët këtë dëm e kanë shkaktuar, duke keqpërdorur formën e regjistrimit të shoqërisë⁸⁴.

Përpos kësaj forme të përgjegjësisë, në juridiksionin e Kosovës, specifikisht është theksuar mungesa e mbrojtjes “*Ultra Vires*” për aksionarët. Me këtë përcaktim ligjor, doktrinar dhe praktik, në Kosovë janë siguruar predispozita për të plotësuar edhe një kriter për qeverisjen e mirë korporative. Kjo për faktin se, “*shoqërisë aksionare nuk i lejohet që ta mohojë ose t’i shmanget përgjegjësisë së saj për një veprim të saj, në bazë*

⁸² Neni 128, i Ligjit për Shoqëritë Tregtare të Kosovës. Gjithashtu, shih edhe neni 8.2 i Statutit të shoqërisë aksionare “operator sistemi, transmissiioni dhe tregu” KOSTT sh. a., i datës 23.10.2009; <http://www.kostt.com/kosttcms/images/stories/file/publikime/PO-KO002%2Statuti%20i%20KOSTT.pdf>, shikuar për herë të fundit me 05.06.2016.

⁸³ Nëse këto qëndrime të legjislacionit të Kosovës krahasohen me dispozitat ligjore nga neni 125 dhe 126 i Ligjit për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare të Shqipërisë, shohim se në këtë aspekt, këto juriskiksione kanë ngjashmëri dhe kanë zgjidhje gati identike.

⁸⁴ Për më tepër, shih Krasniqi, A. (2014), *E drejta Biznesore*, Botimi i parë, Kolegji European, Dukagjini, fq.190. Me fjalë tjera aksionarët do të përgjigjen për dëmin që u kanë shkaktuar personave të tretë, nëse vërtetohet se dëmtimi i personave të tretë është bërë duke e shfrytëzuar formën e regjistrimit të shoqërisë, duke besuar se ata (aksoonarët) gëzojnë mbrojtje ligjore, duke u përgjegjur vetëm me kapitalin e deponuar në shoqëri.

*të argumentit se ky veprim nuk ishte në kuadër të qëllimit afarist të shoqërisë të përcaktuar në statut”.*⁸⁵ Prandaj, bazuar në doktrinën e përmendur, korporata do të përgjigjet ndaj personave të tret edhe për veprimet e ndërmarrura të cilat në statut nuk janë të përshkruara si veprime për të cilat është formuar korporata

4.2. Kuvendi i shoqërisë - Asambleja e përgjithshme e aksionarëve në Shqipëri

4.2.1. Të drejtat qeverisëse-politike

Në Shqipëri, të drejtat e aksionarëve janë të pacaktuara me Ligjin për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare. Në përgjithësi, në teori dhe praktikë është i pranuar parimi, sipas të cilit: “Të gjitha të drejtat politike e financiare dhe detyrimet e aksionarëve e kanë burimin në pronësinë e tyre mbi aksionet”.⁸⁶ Nga vlerësimi i juridiksionit shqiptar, si edhe në juridiksionet e krahasuara, vërtetohet se të drejtat e aksionarëve ndahen në të drejtat qeverisëse dhe të drejtat pasurore.

Duke pasur parasysh, kufizimin në vëllim, i cili duhet respektuar në këtë punim, ne në këtë rast do të flasim vetëm për të drejtat më të rëndësishme qeverisëse, të cilat janë të lidhura më për së afërmi me qeverisjen e korporatave, e të cilat burojnë nga raporti primar agjent në qeverisjen korporative, duke anashkaluar në tërësi të drejtat materiale-financiare të aksionarëve.

Të drejtat më të rëndësishme të aksionarëve në kuadër të të drejtave qeverisëse në Shqipëri, janë: *E drejta për bashkëveprim në kuvendin e shoqërisë duke përfshirë edhe të drejtën për të marrë pjesë në shqyrtimet-seancat e asamblesë së përgjithshme; E*

⁸⁵ Shih për këtë neni 136, i Ligjit për Shoqëritë Tregtare të Kosovës.

⁸⁶ Maltezi, A., Op.cit., fq.126

drejta për të qenë i informuar; E drejta për të votuar; E drejta për t'i kundërshtuar vendimet e kuvendit të përgjithshëm e tj.

E drejta për të votuar në Kuvendin Themelues, është njëra ndër të drejtat fillestare të aksionarëve. Kjo e drejtë e aksionarëve realizohet në mënyrë të barabartë tek të gjithë aksionarët, duke u bazuar në parimin se në kuvendin themelues, secili aksion jep të drejtën në një votë. Gjithashtu, në kushte të njëjta aksionarët kanë status të njëjtë në shoqëri, pasi në kuadër të marrëdhënieve juridike në mes të shoqërisë dhe aksionarëve, vlen parimi i pozitës së barabartë të aksionarëve.

Para së gjithash, për realizimin e interesave të tyre aksionarët duhet të sigurojnë kushte dhe mekanizma për të qenë të informuar me rrjedhat e punës dhe aktivitetin e korporatës, kusht ky elementar për qeverisjen e mirë korporative.

Vlen të theksohet fakti se, nga rezultatet e gjetjeve hulumtuese në teren, është konstatuar se aksionarët në korporatat e regjistruara në Shqipëri, kanë mundësi solide për tu informuar dhe janë mjaft të informuar për aktivitetet e shoqërisë, gjë e cila u mundëson atyre përcjelljen e të gjitha aktiviteteve të shoqërisë. Informimi për aktivitetet e korporatës është faktor vendimtar për sigurimin e kushteve që aksionarët të mundën me kohë të përgatiten për ngritjen e iniciativave dhe kundërshtimin e vendimeve për të cilat kanë interes, kusht i domosdoshëm për qeverisjen e mirë të korporatave. Nga gjetjet në këtë drejtim, ka rezultuar se 78% e aksionarëve janë deklaruar se kanë mundësi për informim, derisa 22% e tyre kanë dhënë përgjigje negative.




Tabela nr.2.⁸⁷

Nga të drejtat më të rëndësishme politike-qeverisëse dhe të cilat janë me rëndësi për qeverisjen e korporatave në Shqipëri, e të cilat në teori dhe praktikë njihen si të drejtat me theks të veçantë dhe me rëndësi për qeverisjen korporative, dallojmë:

4.2.2. E drejta për emërimin dhe shkarkimin e drejtorëve menaxhues

Kjo e drejtë e aksionarëve realizohet përmes pjesëmarrjes së aksionarëve në punët e asamblesë së përgjithshme dhe në kuadër të kompetencave të asamblesë së përgjithshme të shoqërisë aksionare. Nga doktrina juridike, legjislacioni dhe praktika, janë të njohura të drejtat politike të aksionarëve dhe në këtë kapitull, ne i jemi referuar të drejtës së aksionarëve për emërimin dhe shkarkimin e drejtorëve, si një nga të drejtat

⁸⁷ Vëzhgimi mbi gjendjen e Corporate Governance në Shqipëri është realizuar nga Shoqata Shqiptaro-Amerikane e Tregtisë dhe Zhvillimit (the Albanian American Trade and Development Association of Albania, AATDA-AL) në kuadër të projektit “Përmirësimi i Qeverisjes së Shoqërive Aksionere në Shqipëri”, financuar nga CIPE, Center for International Private Enterprise (Washington DC): http://www.aatda.org/files/2/ATET_STATISTIKORE_DHE_GJETJET_PERFUNDIMTAR.pdf, shikuar për herë të fundit, me 05.06.2016.

e cila ka ndikim të drejtpërdrejtë në sferën e qeverisjes së korporatave, e cila prek sferën e aktorëve kryesorë të brendshëm të qeverisjes së korporatave.⁸⁸

Në Shqipëri, ashtu si edhe në legjislacionet e krahasuara, është përcaktuar se asambleja e përgjithshme, përpos të tjerash është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë, për “emërimin e shkarkimin e administratorëve ... përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur ... përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve”.⁸⁹ Nga një qëndrim i tillë shifet se, roli i aksionarëve në emërimin, shkarkimin dhe përcjelljen e punës së drejtorëve dhe menaxherëve është gjithëpërfshirës. Një zgjidhje e tillë, vë në dukje fuqinë e aksionarëve në qeverisjen e korporatave, gjë e cila buron nga e drejta e pronësisë, të cilën aksionarët e kanë mbi aksionet e shoqërisë.

Të drejtat e aksionarve në sferën e qeverisjes së korporatave, nuk do të mundë të realizoheshin, nëse aksionarët nuk do të kishin njohuri të mjaftueshme për vet llojin, përmbajtjen dhe kapacitetin e të drejtave të tyre. Nga një vërtetim i bërë në teren, rezulton se aksionarët e shoqërive aksionare të regjistruara në Shqipëri, janë të njohur me të drejtat e tyre të cilat burojnë e drejta e pronësisë mbi aksionet e korporatës. Vlenë të përmendet në këtë rast, vërtetimi i bërë nga Shoqata Shqiptaro-Amerikane e Tregtisë dhe Zhvillimit (the Albanian American Trade and Development Association of Albania, AATDA-AL), si dhe rezultatet e dala nga ky vërtetim, e nga i cili rezulton se

⁸⁸ Shih për këtë, nenin 12.1, pika 16 e Statutit të Bankës Kombëtare Tregtare (BKT), miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e aksionarëve, datë 31 Mars 2010 dhe e ndryshuar nga Asambletë e Përgjithshme të Aksionarëve në datat 31 Mars 2011, 28 Mars 2012, 27 Mars 2013, 17 Tetor 2014 dhe 26 Mars 2015; marrë nga: <http://www.bkt.com.al/Statuti-.aspx>; shikuar për herë të fundit me 18.10.2015, ora 23.30h.

⁸⁹ Shih nenin 81 dhe 135, të Ligjit për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare të Shqipërisë.

aksionarët në shoqëritë aksionare të Shqipërisë, kanë njohuri të mira për të drejtat e tyre.



Tabela nr.3⁹⁰

Në praktikë konsiderohet se pjesëmarrja dhe interesimi i aksionarëve për aktivitetin e shoqërisë është mjaft i ndjeshëm.

Por përkundër kësaj, raporti i përmendur me të drejtë konstaton se: *“njohja e të drejtave të aksionarëve në shoqëritë financiare, kufizohet sidoqoftë më tepër në njohjen e të drejtave të përshkruara në legjislacionin shqiptar, sesa në praktikat më të mira botërore”*.⁹¹

4.2.3. Mënyra e zgjedhjes dhe mandatimit të drejtorëve menaxhues

Në krahasim me legjislacionin e mëparshëm, nën ndikimin e parimeve të OECD për qeverisjen e korporatave, shihet se legjislacioni i ri i Shqipërisë, ka zgjeruar kompetencat e aksionarëve në fushën e emërimit dhe shkarkimit të anëtarëve të

⁹⁰http://www.aatda.org/files/2/ATET_STATISTIKORE_DHE_GJETJET_PERFUNDIMTAR_.pdf, shikuar për herë të fundit, me 05.06.2016.

⁹¹ Raporti i përmendur, fq.3.

organeve administruese të korporatës.⁹²

Nga dispozitat e Ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare në Shqipëri, qartazi vërehet se me dispozitat e reja ligjore lejohen dy forma të organizimit të organeve për administrimin e shoqërisë. Nga fryma dhe përmbajtja e Ligjit është i njohur fakti se në Shqipëri ashtu si edhe në Kroaci (por jo edhe në Kosovë), lejohen dy lloje të organizimit të administrimit të korporatave. Si rezultat e këtyre mundësive alternative për organizimin e qeverisjes së korporatave, në Shqipëri, është i njohur organizimi i administrimit të korporatave me një nivel të qeverisjes dhe organizimi i administrimit të korporatave me dy nivele të qeverisjes. Kjo praktikë e qeverisjes së korporatave, haset edhe te shumica e shteteve të zhvilluara dhe atyre në tranzicion e të cilat aplikojnë modelin kontinental-gjerman të qeverisjes së korporatave, sistem të cilit i përket edhe qeverisja korporative në Shqipëri.

Ajo që e karakterizon organizimin e administrimit të korporatave me një nivel të qeverisjes, është fakti se, sipas kësaj forme të organizimit, fillimisht aksionarët në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme të aksionarëve zgjedhin këshillin e administrimit, dhe më pastaj ky këshill i zgjedhë drejtorët ekzekutiv. Në një sistem të tillë të organizimit, këshilli administrativ përpos administrimit me punët e korporatës, bënë edhe mbikëqyrjen e zbatimit të punëve ekzekutive nga ana e drejtorëve ekzekutiv-administratorëve. Kjo mënyrë e organizimit karakterizohet me faktin se, në këtë formë të organizimit nuk ekziston një këshill i posaçëm (këshill mbikqyrës), i cili do të merrej vetëm me mbikëqyrjen e pënës dhe veprimtarisë së drejtorëve ekzekutiv-administratorëve të korporatës. Është me rëndësi të përmendet fakti se këshilli i

⁹² Maltezi, A., op. cit. fq.142

administrimit zgjidhet nga aksionarët, kurse kuorumi për marrjen e këtij vendimi përkatësisht për zgjedhjen e këshillit të administrimit është, që të marrin pjesë-t jen prezent, 30% i aksioneve të kapitalit të regjistruar t korporats.

Një risi tjetër paraqet fakti se me legjislacionin e ri në Republikën e Shqipërisë, e drejta për të zgjedhur një anëtar në këshillin e administrimit, iu takon edhe pakicës së aksionarëve të cilët zotërojnë 5% të aksioneve të shoqërisë ose vlerë më të vogël, nëse kjo vlerë më e vogël parashihet me statut.⁹³ Me këtë zgjidhje ligjore, në të drejtën shqiptare, është bërë edhe një hap drejt mbrojtjes së interesave dhe të drejtave të aksionarëve t vegjl-në minorancë, kusht ky i paraparë me parimet e OECD-së lidhur me qeverisjen e korporatave. Duke pas parasyesh faktin se në juridiksionin e Shqipërisë nuk janë përcaktuar rregulla për votimin kumulativ për drejtorët, kjo garanc ligjore, edhe mbetet mundësia e vetme pr mbrojtjen e interesave të aksionarëve të vegjël, për emrimin e anëtarëve të këshillit të administrimit. Edhe në rastin e sistemit të administrimit te korporatave me dy nivele të qeverisjes, ku aksionarët në vend të zgjedhjes së këshillit të administrimit zgjedhin këshillin mbikëqyrës, mënyra e zgjedhjes së anëtarëve të këshillit mbikëqyrës nga asambleja dhe një pakicë aksionesh është e njëjtë me procedurën e parashikuar në sistemin me një nivel të qeverisjes. Duhet theksuar se, ekziston dallim lidhur me zgjedhjen e administratorëve, nga ajo që ishte e përcaktuar me legjislacionin e vjetër, i cili njihte vetëm organizimin e organeve të administrimit me dy nivele, ku administratorët zgjidheshin nga këshilli mbikëqyrës. Pra, sipas legjislacionit të vjetër, administratorët ekskluzivisht i zgjidhte këshilli mbikëqyrës, si organ i zgjedhur drejtpërdrejtë nga asambleja e përgjithshme. Për dallim

⁹³ Për më gjerësisht, shih Maltezi, A., op cit.fq.142.

nga ligji i vjetër, tani ligji i ri për Tregtarët dhe shoqëritë Tregtare, iu lejon aksionarëve që vullnetarisht të përcaktohen për zgjedhjen e sistemit të administrimit të korporatave. Si rrjedhojë e kësaj, aksionarët vullnetarisht përcaktohen nëse do ta organizojnë administrimin e korporatës me një nivel apo me dy nivele të qeverisjes. Kështu, në rastet kur aksionarët, përmes asamblesë së përgjithshme, përcaktohen për sistemin e organizimit të administrimit të korporatës me një nivel, në rast të tillë administratorët e shoqërisë zgjidhen nga asambleja e përgjithshme e aksionarëve.⁹⁴

Për efekt krahasimi, përsërisim faktin se forma e organizimit me një nivel të administrimit në korporatë, në Kosovë është e vetmja formë e organizimit të qeverisjes së korporatave, pasi në juridiksionin e Kosovës, nuk është i njohur sistemi i administrimit të korporatave me dy nivele.

4.2.4. Mungesa e votimit komulativ për zgjedhjen e drejtorëve

Ashtu si që kemi theksuar më lartë, votimit kumulativ për emërimin e drejtorëve, nuk është paraparë si formë e votimit për kryerjen e emrimeve të përmendura nga ana e aksionarve. Si rrjedhojë e kësaj, edhe në statutet dhe në aktet tjera të korporatave në Shqipëri, është paraparë vetëm mënyra e thjeshtë e votimit të aksionarëve, pra secili aksionar votat e veta i shpërndanë te të gjithë drejtorët që duhet të zgjidhen. Edhe për kundër faktit se legjislacioni shqiptar parasheh vetëm këtë mënyrë të votimit për emrimin e drejtorëve, në teorinë dhe doktrinën juridike shqiptare, hasen zëra të cilët vlerësojnë modelin e votimit kumulativ për drejtor, si mundësi pozitive për të fuqizuar mundësinë vendimmarrëse të aksionarëve, në emërimin e drejtorëve, nga ana e

⁹⁴ Po aty.

aksionarëve minorant.⁹⁵ Konsiderojmë se këto tendenca jan të bazuara, sidomos nga arsteja se, një mënyrë e tillë e votimit (votimi kumulativ me rastin e emrimit të drejtorve), është edhe kërkesë e cila del nga principet e OECD-së për qeverisjen e korporatave. Kjo arsyetohet me faktin se, votimi direkt nuk jep mundësi që të vijnë në shprehje votat e aksionarëve të vegjël, nga arsyeja se në votimin e drejtpërdrejtë çdoherë ekziston mundësia që aksionarët e vegjël të mbivotohen nga aksionarët e mëdhenj, gjë e cila është e siguruar në votimin kumulativ.

Rezultatin e një votimi direkt-të drejtpërdrejtë, me rastin e emërimit të drejtorëve nga ana e aksionarëve në asamblenë e përgjithshme dhe efektet e tij, jan pasqyruar në mënyrë tabelare, si më poshtë:




Tabela 4. Sistemi direkt i votimit.⁹⁶

⁹⁵ Shih për këtë, Llaci, Sh., vep.cit., fq.139.

⁹⁶ Shkarkuar nga; <http://www.vps.ns.ac.rs/SB/2014/4.11.pdf>, shikuar për herë të fundit me 05.06.2016, përkthyer nga autori i punimit.

Rezultati i zgjedhjes në rastin konkret shpjegohet, si në vijim: “Duke marrë shembullin konkret, në shoqërinë aksionare “X” sh.a., ka gjithsej 11 aksionar. Aksionari A1 personalisht posedon 520 aksione, ose 52% nga aksionet e tërësishme, aksionarët e tjerë (nëntë nga ta) posedojnë secili nga 50 aksione, kurse aksionari B1 posedon 30 aksione, përkatësisht 10 aksionarët e vegjël-minorant në tërësi posedojnë 480 aksione, ose 48%. Në shoqëri, në rastin konkret zgjidhen 4 drejtor. Numri i përgjithshëm i votave që posedon aksionari i madh është 2080 vota, kurse numri më i madh i votave që mund ta jap një kandidati është 520, pasi i shpërndan në mënyrë lineare. Të gjithë aksionarët e vegjël i posedojnë 1920 vota. Të gjithë aksionarët e vegjël kanë votuar për aksionarin B4, i cili posedon gjithsej 50 aksione. Të gjithë kanë votuar për të, por ai ka mundur të fitojë gjithsej, vetëm 480 vota. Aksionari i madh A1, ka votuar për kandidatin B2. Edhe përkundër disproporcionit të madh në mes të numrit të aksionarëve të mëdhenj dhe të vegjël, për anëtarë të këshillit të drejtorëve është zgjedhur kandidati të cilin e ka propozuar aksionari i madh, pasi ai ka fituar 520 vota ose 52% të votave. Kjo vlen edhe për kandidatët e tjerë. Kështu, në tërësi, aksionari i madh i ka të zgjedhur që të katër kandidatët e tij, përkundër asnjë kandidati të zgjedhur nga ana e aksionarëve të vegjël-minoritar.⁹⁷

Njëra nga mënyrat e kontrollit të aksionarëve dhe ushtrimi i ndikimit të tyre në administrimin e korporatës është edhe mundësia e aksionarëve që, përmes Asamblesë së

⁹⁷ Demokracia i participacija akcionara; Pregledni rad; **Vuk Radulović***, doktorant Pravnog fakulteta, Univerziteta u Novom Sadu; Škola biznisa; Broj 2/2014; UDC 347.72.031; DOI 10.5937/skolbiz2-7099; <http://www.vps.ns.ac.rs/SB/2014/4.11.pdf>, shikuar për herë të fundit me 05.06.2016, përkthyer nga autori i punimit.

përgjithshme të mund të shkarkojnë administratorët në çdo kohë, me shumicë të zakonshme. Madje për ta siguruar këtë ndikim të aksionarëve, ligji ka përcaktuar se: ”statuti apo marrëveshje të tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi”⁹⁸.

Si në sistemet e tjera të krahasuara, edhe në Shqipëri, aksionarët e mbajnë të drejtën e kontrollit mbi administratorët, duke përcjellë punën e tyre dhe duke pasur çdoherë të drejtën e pakontestueshme të ndërrimit ose shkarkimit të administratorëve. Madje, duke pasur parasysh faktin se kontrata e lidhur mes korporatës dhe një administratori nuk konsiderohet kontratë e cila buron nga marrëdhënia e punës, ata (aksionarët), si edhe në sistemet tjera të krahasuara, mund ta shkëputin këtë kontratë në çdo kohë, pa pasur nevojë të japin arsyetim për shkëputjen e saj⁹⁹.

4.2.5. Përgjegjësia e aksionarëve në rast të abuzimit me detyrën dhe formën e shoqërisë

Me qëllim mbrojtjen e kreditorëve, investitorëve, punëtorëve, konsumatorëve dhe pretendentëve të tjerë, duke mos përjashtuar as autoritetet publike, në juridiksionin shqiptar janë të njohura rastet e përgjegjësisë së aksionarit apo përfaqësuesit të aksionarit, i cili me veprimet apo mos veprimet e tij, abuzon me detyrën dhe formën e shoqërisë. Për më tepër, kjo përgjegjësi vjen në shprehje në rast se personat e përmendur, me veprime të tilla i sigurojnë vetes apo të tretëve një përfitim ekonomik të padrejtë, apo i shkakton një të treti pakësimin e pasurisë me dashje. Në këtë rast, ashtu

⁹⁸Neni 95 par.6 i Ligjit për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare të Shqipërisë,

⁹⁹ Ky qëndrim ligjor, ishte karakteristikë edhe në legjislacionin e Kosovës dhe të Kroacisë.

si edhe në të drejtat e krahasuara, personat e tillë janë përgjegjës personalisht ndaj të tretëve, duke përfshi edhe autoritetet publike dhe për shlyerjen e detyrimeve të shoqërisë dhe janë të detyruar që të përgjigjen me tërë pasurinë e tyre.¹⁰⁰

Kjo përgjegjësi e aksionarëve del në pah, posaçërisht, atëherë kur personi i përmendur-aksionari, ka abuzuar me formën e përgjegjësisë së kufizuar që ofron shoqëria tregtare. Në këtë rast, aksionari duke keqpërdorur formën e shoqërisë tregtare (përgjegjësinë e kufizuar të aksionareve), hynë qëllimisht në transaksione, të cilat dukshëm tejkalojnë fuqinë paguese të shoqërisë. Për t'u aplikuar kjo formë e përgjegjësisë, duhet të ketë qenë dëmtimi i palëve të treta, qëllimi i vetëm dhe direkt i këtij veprimi nga ana e aksionarit dhe duke u bazuar me keqbesim në faktin se, shoqëria do të përgjigjet vetëm deri në mjetet e investuara, përkatësisht deri në lartësinë e kapitalit të investuar. Në mënyrë të njëjtë (pra, me përgjegjësi të plotë), personat e përmendur (aksionarët) do të përgjigjen edhe në rast se kanë trajtuar pasuritë e shoqërisë tregtare si të ishin pasuri të tyre personale. Kjo për faktin se shoqëria aksionare, ka të ndarë pronësinë nga personaliteti i aksionarit, prandaj aksionari për ta respektuar këtë parim, asnjëherë pasurinë e shoqërisë nuk duhet ta trajtojë si pasuri personale të tij. Aksionarët, përgjegjësi të tillë mbajnë edhe në rastet kur ata kanë ditur ose do të kishte qenë dashur të dinë se shoqëria gjendej në rrethana të paaftësisë paguese, duke mos poseduar kapital të mjaftueshëm për të përmbushur detyrimet ndaj palëve të treta, kurse, edhe përkundër kësaj njohurie, ata (aksionarët) kanë lejuar që shoqëria të hyjë në detyrime ndaj personave të tretë. Kjo përgjegjësi arsyetohet me faktin se në rrethana të tilla, personat e përmendur kanë autorizimet dhe detyrimin për të mos lejuar shoqërinë

¹⁰⁰ Një qëndrim të tillë, e gjejmë të përkrahur edhe nga Malltezi, A., op. cit. fq.226-227.

për të ushtruar veprimtarinë tregtare. Nëse shkeljet e sipërpërmendura kryhen së bashku nga më shumë se një prej personave të përmendur, këta persona përgjigjen në mënyrë solidare ndaj të tretëve, përfshirë edhe përgjegjësin e tyre ndaj autoriteteve publike. Gjithashtu është me rëndësi të theksohet fakti se personat e përmendur, “nuk mbajnë përgjegjësi personale ndaj palëve të treta, të cilat, në momentin e marrjes përsipër të detyrimit nga shoqëria, kishin dijeni për shkeljet në fjalë, ose në bazë të rrethanave të qarta, nuk mund të mos kishin dijeni për to”¹⁰¹. Një qëndrim i tillë është i bazuar dhe i drejtë, sepse ligji ofron mbrojtjen e personave të tretë, vetëm nëse ata kanë hyrë në transaksione, të cilat dëmtojnë interesat e tyre (personave të tretë), dhe duke besuar në aftësinë paguese të shoqërisë, kurse nuk mbron ata që paraprakisht kishin pasur dijeni ose kishin pasur mundësi të kishin dijeni, për paaftësinë paguese të shoqërisë.

4.3. Kuvendi i aksionarëve - Asambleja e përgjithshme e korporatve në Kroaci

4.3.1. Të drejtat qeverisëse - politike

Aksionarët si pronar të shoqërisë, mbi bazën e kapitalit të deponuar-investuar në korporatë, kanë të drejta të patjetërsueshme për qeverisjen e korporatës. Të drejtat e tilla të aksionarve, rrjedhin nga kushtetuta dhe ligji, të njohura si e drejta për qeverisjen e pronës në përputhje me interesin më të mirë për pronarët dhe e drejta për të disponuar me pronën e tyre të investuar, të drejtën e shfrytëzimit (duke përvetësuar frytet të cilat rrjedhin nga prona) si dhe të drejtën e tjetërsimit. Për këtë arsye, të drejtat e aksionarëve ndahen në dy grupe të mëdha, të njohura si: të drejtat për qeverisje ose të drejtat politike dhe të drejtat pasurore ose të drejtat financiare.¹⁰²

¹⁰¹ Neni 16 i Ligjit për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare të Shqipërisë.

¹⁰² Barbić J, (2005). *Pravo Društava, Knjiga druga, Društva kapitala, Treće, izmenjeno i dopunjeno*

Në kuadër të të drejtave për qeverisje dallojmë: *Të drejtën e aksionarit për të marrë pjesë dhe për të bashkëvepruar në kuvendin e shoqërisë.* Mundësia për realizimin e kësaj të drejtë të aksionarit, është që të marrë pjesë në mënyrë direkte ose indirekte (përmes përfaqësuesit të tij) në kuvendin e shoqërisë. Përpos kësaj, si e drejtë tjetër nga ky grup i të drejtave është edhe e drejta për të marrë pjesë në seancat e asamblesë së përgjithshme. Për t'u mundësuar realizimi i plotë dhe efektiv i së drejtës për të marrë pjesë në kuvendin e shoqërisë, aksionari duhet ta shfrytëzojë në tërësi: *Të drejtën për të qenë i informuar.* Realizimi i plotë i kësaj të drejte nënkupton faktin që aksionari të jetë i informuar paraprakisht, me të gjitha propozimet dhe pikat e rendit të ditës, të cilat trajtohen në kuvend. Kjo me qëllim që të mund të jetë i përgatitur dhe efektivisht të japi kontributin e tij në mbledhjet e kuvendit. Nga kjo rrjedhë edhe e drejta e aksionarit për realizimin e plotë të të drejtës për të votuar efektivisht. Sigurimi i kushteve për realizimin e kësaj të drejte, është kusht themelor nga i cili varet realizimi i interesit të aksionarit për qeverisje korporative, në korporatën, aksionar i së cilës është.

E drejtë tjetër me rëndësi nga ky grup i të drejtave është edhe: *E drejta e aksionarit për t'u informuar me vendimet të cilat janë marrë në kuvendin e asamblesë së përgjithshme ose të trupave të tjera administruese.* E drejta për t'u informuar me vendimet e aprovuara në korporatë, ka rëndësi pasi kjo është e lidhur me mundësinë e realizimit të së drejtës për t'i kundërshtuar këto vendime në procedurë dhe brenda afatit të caktuar ligjor, nëse aksionari ka interes për ta bërë një kundërshtim të tillë. Mundësia e informimit të drejtë dhe me kohë, aksionarit duhet t'i bëhet për të gjitha vendimet, me

izdanj, organizator Zagreb,. (E drejta e shoqërive, Libri i dytë, Shoqëritë e kapitalit, Botimi i tretë i ndërruar dhe plotësuar, Organizator Zagreb 2005), fq.59/60.

qëllim që atij t'i krijohen mundësitë për t'i kundërshtuar të gjitha ato vendime, me të cilat nuk do të pajtohej.

Nga kjo edhe e konsiderojmë të drejtë konstatimin e autorit Barbic J., sipas të cilit, të drejtat më të rëndësishme nga të drejtat në qeverisje janë: “e drejta për bashkëveprim në kuvendin e shoqërisë duke përfshirë edhe të drejtën për të marrë pjesë në shqyrtimet-seancat e asamblesë së përgjithshme, të drejtën për të qenë i informuar, të drejtën për të votuar dhe të drejtën që t'i kundërshtojë vendimet e kuvendit të përgjithshëm”¹⁰³.

Për arsye se përkufizimi i temës, të cilën po trajtojmë, jemë të detyruar që më tepër të përqendrohemi te të drejtat, të cilat në mënyrë më të drejtëpërdrejtë janë të lidhura me qeverisjen e korporatave. Të drejta të tilla janë: e drejta për të votuar në Kuvendin Themelues, duke u bazuar kryesisht në të drejtën e aksionarëve për votim, në përgjithësi, dhe të drejtat e tyre në zgjedhjen dhe emërimin e drejtorëve, në veçanti.

Në kuadër të marrëdhënieve juridike në mes të shoqërisë dhe aksionarëve, vlen parimi i pozitës së barabartë të aksionarëve, sipas së cilit: në kushte të njëjta aksionarët kanë status të njëjtë në shoqëri¹⁰⁴. Nga të drejtat e sipërpërmendura në qeverisje, të drejtat me theks të veçantë dhe me rëndësi për qeverisjen korporative, dallojmë: a). Të drejtën e aksionarëve për pjesëmarrje në emërimin dhe shkarkimin e drejtorëve menaxhues dhe b). Të drejtën e aksionarëve për votim, në rastin e emërimit të Drejtorëve.

¹⁰³ Për më tepër shih, Barbic. vep. cit.fq,358-418

¹⁰⁴ Per me teper shih neni 208 par.1 dhe neni 211, i Ligjit për Shoqëritë Tregëtare i Kroacisë.

4.3.2. E drejta për emërimin dhe shkarkimin e drejtorëve menaxhues

Përmes pjesëmarrjes së aksionarëve në asamblenë e përgjithshme realizohet e drejta e aksionarëve, për emërimin e drejtorëve, të cilët udhëheqin punët ekzekutive në korporatë.¹⁰⁵ Në kuadër të kompetencave të Asamblesë së përgjithshme, aksionarët, përmes asamblesë së përgjithshme vendosin për të gjitha çështjet të cilat janë të përcaktuara me ligj dhe statut. Nga kjo, aksionarët në veçanti, vendosin për: emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të Këshillit mbikëqyrës përkatësisht Këshillit drejtues, organe këto të cilat emërohen nga aksionarët me detyra të rëndësishme për qeverisjen korporative. Aksionarët, ashtu siç kanë të drejtë për të vendosur për emërimin e drejtorëve, gjithashtu kanë të drejtë të vendosin edhe për shkarkimin e tyre, përkatësisht anëtarëve të administratës dhe anëtarëve të Këshillit mbikëqyrës, përkatësisht anëtarëve të Këshillit drejtues. Asambleja e përgjithshme e shoqërisë, si organ qeverisës, në parim nuk merret me administrimin, pra, me punët ekzekutive të shoqërisë. Në çështjet e menaxhimit të punëve të shoqërisë, Asambleja e përgjithshme mund të vendosë vetëm përjashtimisht dhe vetëm në rastet kur një gjë e tillë kërkohet nga administrata apo drejtorët ekzekutivë të shoqërisë.¹⁰⁶

Autoriteti administrativ dhe ekzekutiv, të cilin në shoqëri e bartin drejtorët dhe menaxherët, është autoritet i bartur nga vet aksionarët, si pronar të korporatës. Pra edhe ky autoritet i deleguar, burimin e ka nga e drejta pronësore e aksionarëve mbi korporatën. Prandaj, pikërisht përmes shprehjes së vullnetit të aksionarëve gjatë emërimit të drejtorëve, ata (aksionarët) shprehin të drejtën e tyre për të vendosur për

¹⁰⁵ Shih neni 275, i Ligjit për Shoqëritë Tregëtare i Kroacisë.

¹⁰⁶ Neni 275 Ligji për shoqëritë tregtare i Kroacisë.

administrimin e punëve të shoqërisë. Nga kjo që u tha më sipër, në mënyrë të pakontestueshme, argumentohet fakti se, aksionarët përmes këtij procesi, delegojnë vullnetin e tyre tek drejtorët, të cilët pranojnë detyrimin që në emër dhe për interesin e aksionarëve, të bëjnë administrimin e shoqërisë.

Këtu qëndron edhe esenca e qeverisjes së korporatave, konkretisht ndërveprimi nga raporti primar-agjent, ku në cilësinë e primarit janë aksionarët, kurse në pozitën e agentit janë drejtorët. Nga ky raport ndërveprimi, nxjerrim përfundimin se qëllimi kryesor i qeverisjes së korporatave është bashkërendimi i interesave qeverisëse në korporatë. Ky bashkërendim i interesave arrihet duke ndikuar në atë mënyrë që drejtorët-ekzekutivët të administrojnë me shoqërinë, duke pas në mendje të parë arritjen e qëllimit kryesor të korporatës, pra shtimin e kapitalit dhe arritjen e fitimeve sa më të mëdha për aksionarët.

Për realizimin e qëllimit të korporatës, drejtorët kanë detyrime besueshmërie, përmes respektimit të të cilave, aksionarët sigurohen se interesat e tyre gjithsesi do të realizohen para interesave personale të menaxherëve dhe drejtorëve. Përpos kësaj, aksionarët e posaçërisht drejtorët, marrin për sipër detyrimin që, në qeverisjen korporative, njëkohësisht, të respektojnë edhe interesat e aktorëve të tjerë në korporatë.

Nga ky raport mes aksionarëve dhe drejtorëve të korporatës, kuptohet se edhe pse aksionarët nuk bëjnë administrimin e punëve të shoqërisë në mënyrë direkte, ndikimin e tyre në administrim e korporatës, është më se evident dhe i njëjti përpos tjerash, shprehet dhe arrihet përmes të drejtës për të emëruar dhe shkarkuar anëtarët e Këshillit drejtues, përkatësisht, Këshillit mbikëqyrës. Kjo e drejtë është njëra ndër të drejtat e patjetërsueshme për aksionarët-pronarët.

E drejta për emërimin e anëtarëve të Këshillit drejtues dhe mbikëqyrës, nuk do të ishte efektive sikur aksionarët, njëkohësisht, të mos kishin edhe të drejtën për shkarkimin e anëtarëve të këshillave të përmendura. Aksionarët, edhe këtë të drejtë e realizojnë përmes bashkëpjesëmarrjes në qeverisje, përcjelljes së seancave të asamblesë së përgjithshme dhe të drejtës së votimit.

Kështu, aksionarët përmes Asamblesë së përgjithshme, vendosin për dhënien e shkarkimeve për anëtarët e këshillit drejtues në sistemin e qeverisjes së korporatave me një nivel, si dhe shkarkimin e anëtarëve të këshillit mbikëqyrës në sistemin e qeverisjes së korporatave me dy nivele. Për aprovimin e shkarkimit të ndonjë anëtari të këshillit drejtues, aksionarët votojnë veç e veç, nëse kështu vendosë Asambleja e Përgjithshme ose në qoftë se për këtë kërkojnë aksionarët, aksionet e të cilëve përbëjnë të paktën një të dhjetën e kapitalit themeltar të kompanisë¹⁰⁷.

Pikërisht, duke ushtruar të drejtën për shkarkimin e drejtorëve, aksionarët ushtrojnë të drejtën e tyre në përcjelljen e zbatimit të politikave qeverisëse, të cilat ata i vendosin në mbledhjet e asamblesë së përgjithshme. Ashtu si edhe në dy juridiksionet e krahasuara, edhe në juridiksionin kroat, nëse aksionarët vendosin për shkarkimin e një drejtori, ata nuk kanë nevojë që vendimin e tillë ta arsyetojnë.

Me këto veprime, pretendohet që të realizohet interesi i aksionarëve për mbarëvajtjen e punës së korporatës. Prandaj duhet kuptuar se aksionarët me këto veprime dhe vendime, në mënyrë indirekte ndikojnë dhe në mbrojtjen dhe përmirësimin e interesave edhe të aktorëve të tjerë në qeverisjen e korporatave.

Kjo është edhe arsyeja e përpjekjeve të vazhdueshme për të bërë një administrim

¹⁰⁷ Neni 276 i Ligjit për Shoqëritë Tregëtare i Kroacisë.

të mirë të korporatës nga njerëz kompetentë dhe të përgatitur. Administrimi i mirë i korporatës është interes fillimisht i aksionarëve, por administrimi i mirë, sigurisht që është edhe në interes të aktorëve të tjerë të qeverisjes korporative. Nga vlerësimi i rregullores ligjore në Kroaci, konsiderojmë se, ligji kroat për shoqëritë tregtare, siguron kushtet optimale për garantimin e qeverisjes së mirë korporative.

4.3.3. Mënyra e zgjedhjes dhe mandatimit të drejtorëve menaxhues

E drejta për votim në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me shoqërinë, paraqet “autorizimin e aksionarit për të marrë pjesë në shprehjen e vullnetit të shoqërisë, duke marrë vendime në asamblenë e përgjithshme të saj”.¹⁰⁸

Kështu, aksionarët shprehin vullnetin e tyre në emërimin e anëtarëve të bordit të drejtorëve, vullnet i cili gjithashtu buron nga fuqia e së drejtës së tyre në aksionet të cilat posedojnë në shoqëri.

Për emërimin e anëtarëve të Këshillit drejtues të shoqërisë, me ligj është përcaktuar, se: “aksionarët, për anëtarë të këshillit drejtues, mundë të emërojnë secilin person fizik, i cili ka zotësinë e plotë afariste”. Me këtë përcaktim ligjor, ligjvënësi kroat ka pasur për qëllim që të bëjë liberalizimin dhe krijimin e mundësive që aksionarët, të kenë mundësi më të mëdha për emërim të personave, nëse për ta dakordohen dhe mendojnë se kjo do të ishte në interesin e shoqërisë-korporatës dhe qeverisjes korporative. Megjithatë, me qëllim të krijimit të një filtri për emërimin e këtyre personave, është lejuar mundësia që me statut, të mund të caktohen kushte të posaçme për emërimin e anëtarit të këshillit drejtues. Në raste të tilla, ligjvënësi kroat ka

¹⁰⁸Barbić, J., op. cit. fq. 370.

përcaktuar kushtet e enumeracionit negativ, kushte këto ndaluese, të cilat bëjnë që një person të mos mundë të emërohet në cilësinë e anëtarit të Këshillit drejtues ose mbikëqyrës.

Kushtet e tilla ndaluese për emërimin e personit në cilësinë e anëtarit në Këshillin drejtues ose mbikëqyrës, janë, si: “personi nuk duhet të jetë i dënuar për kryerjen e veprës penale keqpërdorimi i likuidimit, keqpërdorimin e procedurës së likuidimit, shprehja e preferencave ndaj kreditorëve ose shkeljes së detyrimit për udhëheqjen e librave tregtare...”.¹⁰⁹ Kjo ndalesë është vendosur së pari për mbrojtjen e interesave të aksionarëve, por njëkohësisht edhe për mbrojtjen e interesit të përgjithshëm¹¹⁰. Ky përcaktim ligjor, tregon përkushtimin e ligjvënësit që të mbrojë shoqëritë tregtare dhe njëkohësisht të sigurojë mbrojtjen e interesave të gjithë aktorëve të tjerë të qeverisjes së korporatave.¹¹¹

Gjithashtu, ligjvënësi kroat ka paraparë afate të caktuara kohore për ndalimin e emërimit të personave me të kaluar kriminale. Krahas përcaktimit të afateve kohore brenda të cilave ndalesat janë efektive, ligjvënësi ka përcaktuar edhe afatin e skadimit të kufizimeve të përmendura për emërim.¹¹²

Përkundër kësaj që e trajtua më lartë, aksionarët kanë mundësi që me rregulloren e brendshme të korporatës të parashohin edhe kushte të tjera për të cilat kanë bindjen se

¹⁰⁹ Më hollësisht shih. Neni 423 lidhur me nenin 239 par.2 të i Ligjit për Shoqëritë Tregëtare i Kroacisë.

¹¹⁰ Qëllimi i saj është që personat me të kaluar kriminale, dhe atë për vepra penale kundër ekonomisë, të mos emërohen anëtarë të administratës së shoqërive tregtare.

¹¹¹ Mbrojtja e përmendur është e arsyeshme nga fakti se, personat të cilët kanë kryer vepra penale të natyrave dhe llojeve të përmendura, ekziston frika e arsyeshme se do të mund të shprehin gadishmërinë që të përsërisin veprat e njëjta ose të ngjajshme. Në rast të tillë, sigurisht që me këto lloj veprimesh, do të cenonin interesin e ligjshëm të aktorve kryesor të qeverisjes së korporatave.

¹¹² Barbiq, J, vep. cit. fq.436.

do të ishin në favor të qeverisjes së mirë korporative. Këto ndalesa janë paraparë vetëm si mundësi për aksionarët e në asnjë mënyrë nuk mund të kuptohen si detyrim.

Qëndrimi i ligjvënësit kroat bazohet në arsyen se pozitat menaxheriale, nuk konsiderohen si vend pune, të cilat rregullohen sipas dispozitave të ligjit të punës. Nga kjo arsye, pozitat menaxheriale konsiderohen si marrëdhënie kontraktuale të lidhura me vullnetin e lirshëm mes aksionarëve dhe personit ose personave, të cilët konkurrojnë për pozita të tilla. Madje, aksionarët nuk janë shumë të lidhur me kontratën e tillë nga fakti se, ata mund të ndërpresin kontratat me drejtorët menaxhues pa pasur nevojë të japin arsyetim për ndërprerjen e kontratës në fjalë.

4.3.4. Votimi Kumulativ për zgjedhjen e drejtorëve

Edhe në Kroaci, aplikohet skema e votimit kumulativ për emërimin e drejtorëve, si modalitet i mbrojtjes së të drejtave të aksionarëve të vegjël. Ashtu siç shpjeguar më lartë, kjo ishte praktikë e pranuar në juridiksionin e Kosovës, e cila si praktikë e tillë, tani është pranuar në shumë ligje, si në vendet e zhvilluara, ashtu edhe në vendet në tranzicion, kurse si e tillë nuk është paraparë në legjislacionin shqiptar.

4.3.5. Përgjegjësia e aksionarëve

Në parim, anëtarët e SH.P.K-së dhe aksionarët e SH.A-së, përpos me kapitalin e deponuar në shoqëri, nuk përgjigjen me asgjë tjetër për detyrimet e shoqërisë. Kjo është edhe cilësia, e cila i karakterizon korporatat dhe një ndër elementet që i dallon korporatat nga shoqëritë e personave¹¹³. Megjithatë edhe në juridiksionin kroat, anëtari ose aksionari i shoqërisë nuk do të lirohet nga përgjegjësia për detyrimet e shoqërisë,

¹¹³ Ligji për shoqëritë Tregtare Kroacisë, neni 10, par.2.

nëse këto detyrime i kanë marrë duke keqpërdorur rrethanën, me qëllim që ata “si anëtar të korporatës të mos përgjigjen për këto detyrime”.

Nga kjo arsye, anëtari i korporatës ose aksionari, gjithsesi do të përgjigjen në çdo rast, kur kanë përdorur shoqërinë për arritjen e qëllimeve të cilat nuk janë të lejuara me ligj. Në rast të tillë, aksionarët nuk lirohen nga përgjegjësia, madje ata do të përgjigjen me tërë pasurinë që posedojnë, e jo vetëm me deponimet, përkatësisht kapitalin e tyre, të cilin e kanë investuar në korporatë. Aksionarët, në raste të tilla do jenë përgjegjës, posaçërisht nëse e shfrytëzojnë shoqërinë për t'i dëmtuar kreditorët, nëse në mënyrë të kundërligjshme qeverisin me pasurinë e shoqërisë si të ishte pasuri e tyre, ose nëse për interesin e tyre ose të të tjerëve e kanë zvogëluar pasurinë e shoqërisë edhe pse e kanë ditur ose ka qenë dashur ta dinë se ajo (shoqëria) nuk do të mundet t'i përmbushë detyrimet e saj.¹¹⁴

Me këtë përcaktim ligjor, në të drejtën kroate në parim është i pranuar qëndrimi sipas të cilit, themeluesit-aksionarët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë, por kjo përgjegjësi e kufizuar nuk lejohet që të keqpërdoret, e në rast të keqpërdorimit të saj, pronarët do të përgjigjen me tërë pasurinë e tyre, ashtu siç u theksua më sipër.

4.4. Përfundimet nga kapitulli i katërt

Në të tria juridiksionet e krahasuara, ka ngjashmëri sa i përket përgjegjësive dhe të drejtave të aksionarëve. Të drejtat politike të aksionarëve, kryesisht bazohen në të drejtën e aksionarëve, për: emërimin dhe shkarkimin e drejtorëve menaxhues, zgjedhjen dhe mandatimin e drejtorëve, si dhe mundësinë për votimin kumulativ për drejtorët.

¹¹⁴ Ligji për shoqëritë Tregtare Kroacisë, neni 10, par.3 dhe 4.

Për dallim prej juridiksionit të Shqipërisë, ku aksionarët nuk gëzojnë të drejtën e votimit kumulativ për emërimin e drejtorëve, në juridiksionin kroat, ashtu si edhe në atë kosovarë, kjo e drejtë është e njohur dhe iu jep mundësi aksionarëve të vegjël që të bashkojnë votat dhe të zgjedhin drejtorët e preferuar, karshi forcës së kapitalit me të cilin disponojnë përkatësisht kapitalit të cilin e kanë investuar në korporatë.

Në parim, shoqëria aksionare është përgjegjëse për të gjitha borxhet dhe detyrimet e tjera dhe ajo përgjigjet para personave të tretë, me tërë asetet dhe pasurinë e saj. Përfundimisht, në rast të keqpërdorimit të këtij parimi, pronarët-aksionarët do të përgjigjen me tërë pasurinë e tyre.

KAPITULLI V: BORDI I DREJTORËVE - KËSHILLI DREJTUES DHE KËSHILLI MBIKQYRËS

5.1. Bordi i Drejtorëve dhe roli i tij në qeverisjen e korporatave në Kosovë

Në teorinë dhe doktrinën e qeverisjes korporative njihen dy mënyra ose dy modele të administrimit të korporatave. Në njërën anë është administrimi i korporatave me dy nivele (*two-tier board*), i cili më parë ishte karakteristikë vetëm e modelit evropian të qeverisjes së korporatave. Në anën tjetër është administrimi i korporatave me një nivel të qeverisjes-bordi unitar (*unitary board*), i cili më parë ishte karakteristikë vetëm e modelit anglo-sakson të qeverisjes së korporatave. Në administrimin e korporatave me dy nivele të qeverisjes, hasim dy nivele të ndara; “...një Bord menaxhimi dhe një Bord tjetër mbikëqyrës”¹¹⁵. Ndërsa në administrimin e korporatave me një nivel të qeverisjes, Këshilli drejtues “përfshinë brenda vetes drejtorët ekzekutiv dhe joekzekutiv, kurse gjat punës së tijë merr vendime si një grup i vetëm”¹¹⁶. Në kohën e fundit, nën ndikimin e principeve të OECD-së për qeverisjen e korporatave, në shumë vende, qofshin ato të zhvilluara ose vende në tranzicion, aplikohet një qëndrim sipas së cilit, korporatat vullnetarisht mundë të përcaktohen për modelin e administrimit të korporatës. Si rezultat i këtij liberalizimi, pronarëve të korporatave u është dhënë mundësia që vullnetarisht të përcaktohen se a dëshirojnë që të bëjnë administrimin e korporatës me një nivel apo me dy nivele të qeverisjes.

¹¹⁵ Shih për këtë Llaci, Sh., op. cit.fq.144.

¹¹⁶ Po aty.

Në shpjegimet në vijim, ka rëndësi fakti se legjislacioni dhe praktika juridike në Republikën e Kroacisë dhe Republikën e Shqipërisë, pronarëve të korporatave u ka lënë mundësinë që vullnetarisht të përcaktohen për modelin e administrimit të korporatës. Derisa në këto dy vende ashtu si edhe në shumicën e vendeve Europiane aplikohet një qëndrim i tillë, Ligji për shoqëritë tregtare të Republikës së Kosovës, ka përcaktuar vetë formën e administrimit të korporatave me një nivel, pa alternativë tjetër. Nga kjo arsye, në korporatat të cilat janë të regjistruara në Kosovë, e kemi administrimin e korporatave me një nivel të qeverisjes, gjë e cila tregon se një përcaktim i tillë, i ndikimit të legjislacionit tonë nga teoritë dhe doktrina anglosaksone.

Nga kjo arsye edhe në trajtimin e kësaj teme në pjesën e cila i dedikohet qeverisjes së korporatave në Kosovë dhe Kroaci, ne i kemi referuar shoqërive aksionare dhe shoqërive me përgjegjësi të kufizuar, kurse në rastin e Shqipërisë, u kemi referuar vetëm shoqërive aksionare.

Kjo për arsye se, sipas legjislacionit të Shqipërisë, korporatë konsiderohet vetëm shoqëria aksionare, kurse, sipas legjislacionit të Kosovës dhe të Kroacisë, korporata konsiderohen edhe shoqëritë aksionare edhe shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar.¹¹⁷

Bazuar në atë që u tha më sipër, ne kemi trajtuar formën e organizimit të administrimit të korporatave në Kosovë, si formë e administrimi me një nivel, e cila është edhe forma e vetme e administrimit të korporatave e rregulluar me dispozitat

¹¹⁷ Shih neni 2, pika 2.1 e LSHTK “Kompani” do të thotë një shoqëri aksionare ose shoqëri me përgjegjësi të kufizuar që është themeluar në Kosovë”. Kurse neni 1, par 8 “8. Në tërë tekstin e ligjit bazik fjala “Kompani” zëvendësohet me fjalën “Korporatë”.

ligjore nga neni 166 dhe 167, të LSHTK. Nga një përcaktim i tillë ligjor, në korporatat kosovare nuk organizohet Këshilli mbikëqyrës si organ i mbikëqyrjes së administrimit. Ashtu si kemi theksuar më sipër në këtë kapitull, te organizimi i administratës me një nivel të administrimit, si organ i administrimit të korporatës paraqitet vetëm Bordi i drejtorëve. Si rrjedhojë e përcaktimit të përmendur, “korporatat duhet të kenë një bord të drejtorëve, i cili menaxhon gjithë veprimtarinë tregtare të shoqërisë”¹¹⁸.

Për dallim nga dy juridiksionet e krahasuara, për emërtimin e organeve administruese të korporatës në Kosovë, hasim në përdorimin e një terminologjie, e cila ka burimin nga e drejta anglosaksone. Kështu, deri sa organi për administrimin e korporatës me një nivel të organizimit, në Kroaci njihet si: Këshilli drejtues -**“Upravni odbor”**, kurse në Shqipëri ky organ njihet si Këshilli i administrimit, në Kosovë i njëjti organ qeverisës i korporatave, emërtohet me emrin: Bordi i drejtorëve¹¹⁹.

Bordi i drejtorëve ka mundësi që vet të menaxhojë me veprimtarinë e korporatës. Në të kundërtën, Bordi i drejtorëve ka mundësi të zgjedhë drejtorët ekzekutiv të cilët menaxhojnë veprimtarinë e korporatës, kurse në rast të zgjedhjes së drejtorëve menaxhues, do ta bëjnë menaxhimin sipas udhëzimeve të Bordit të drejtorëve¹²⁰.

Në këtë formë të organizimit, Bordi i drejtorëve paraqitet si organ ekzekutiv në

¹¹⁸Për më tepër shih, neni 166 i LSHTK.

¹¹⁹ Shih për këtë, Baraliu, M. (2010), *E drejta biznesore*, Prishtinë, fq.136.

¹²⁰ Për një zgjidhje të tillë, shih Statuti i Bankës Pro Credit SH.A., Kosovë, (i ndryshuar dhe i rishikuar), Aprovuar nga Mbledhja e Përgjithshme e Aksionarëve e Pro Credit sh.a. Kosovë, me datën 25 nëntor 2014, neni 30 pika 1, fq.15, shkaruar nga; <http://www.procreditbank-kos.com/>, shikuar për herë të fundit me datë 16.10.2015, ora 22:40h.

raport me themeluesit, të cilët në fakt merren me udhëheqjen e politikave të korporatës ose marrjen e vendimeve të karakterit të përgjithshëm në korporatë. Pasi që në organizmin e qeverisjes së korporatave në Kosovë nuk ekziston një organ mbikëqyrës, atëherë Bordi i drejtorëve, njëkohësisht paraqitet në rolin e organit mbikëqyrës, në raport me drejtorët menaxhues, të cilët ekskluzivisht merren me udhëheqjen dhe ekzekutimin e punëve të shoqërisë¹²¹. Nga kjo zgjidhje ligjore, e cila është zbatuar në juridiksionin e Kosovës, kuptohet se Bordit të drejtorëve njëkohësisht i janë dhënë kompetenca mbikëqyrëse dhe ekzekutive.

5.1.1.Emërimi dhe shkarkimi i drejtorëve menaxhues

Lidhur me emërimin dhe shkarkimin e drejtorëve, si dhe kushteve ligjore për emërimin e tyre, është debatuar në pjesën, e cila i referohet të drejtave të aksionarëve për emërimin e drejtorëve¹²². Nga kjo arsye, po ajo që është thënë në kaptinën e përmendur të këtij punimi lidhur me emrimin dhe shkarimimin e drejtorëve, vlen edhe në këtë pjesë të punimit, prandaj edhe nuk e shohim të arsyeshme që materjen e njëjtë ta përsërisim edhe në këtë kaptinë.

Një ndër kërkesat për qeverisje të mirë korporative, është: Pavarësia e drejtorëve. Është me rëndësi fakti se, me rastin e emërimit të anëtarëve të Bordit të drejtorëve në Kosovë, rëndësi duhet t'i kushtohet pavarësisë së anëtarëve të këtij organi administrues të korporatës. Me qëllim të arritjes dhe ruajtjes së pavarësisë së drejtorëve, ligjvënësi kosovar ka përcaktuar se: një shoqëri që ka njëqind (100) apo më shumë

¹²¹ Për më tepër, lidhur me kompetencat e Bordit të drejtorëve, shih; Statuti i Bankës Pro Credit SH.A., Kosovë, neni 31, fq.17.

¹²² Për më tepër shih pjesën 4.1.2, dhe 4.1.3 të këtij punimi.

aksionarë, anëtarët e familjes së punonjësve të shoqërisë nuk mund të përbëjnë shumicën e bordit të drejtorëve të shoqërisë. Ligji për shoqëritë tregtare, për nevoja të rastit konkret nuk kishte përcaktuar nocionin “*anëtarë i familjes*”, gjë që konsiderojmë se është fjala për anëtarin e familjes së ngushtë.

Megjithatë në ndryshimet dhe plotësimet e ligjit ky term është përkufizuar në: “*familjen e ngushtë si burri, gruaja, fëmija, prindi ose trashëgimtari ligjor.*”¹²³ Konsiderojmë se, për të qenë më konkret, ky kufizim do të duhej të përcaktonte rrethin e personave, përkatësisht të përcaktojë shkallën e gjinisë së gjakut, deri ku shtrihet nocioni “*anëtarë i familjes*”.¹²⁴

Për të siguruar pavarësinë e bordit të drejtorëve, ligji më tutje ka përcaktuar se në zgjedhjen e drejtorëve të një shoqërie që ka dyqindpesëdhjetë (250) ose më shumë aksionarë, bordi i drejtorëve të shoqërisë duhet të propozojë së paku dy kandidatë që do të jenë drejtorë të pavarur. Gjithashtu është përkufizuar në mënyrë mjaft të detajuar edhe kualifikimi se kush konsiderohet i përshtatshëm për të qenë “*drejtor i pavarur*”. Pavarësisë së drejtorëve i është kushtuar vëmendje e duhur, prandaj për këtë arsye, “...personi, i cili në cilëndo kohë gjatë dy vjetëve para zgjedhjeve përkatëse ka qenë punonjës i kompanisë, ka pasur një anëtar të familjes që ka qenë punonjës i kompanisë ose ky person ose ndonjë anëtar i familjes së tij, kanë bërë ose kanë marrë nga shoqëria pagesa, kanë qenë në pronësi të aksioneve ose interesave të tjera pronësore, ose kanë

¹²³ Shif neni 4 par.3 i Ligjit Nr. 04/L-006 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.02/L-123 për shoqëritë tregtare.

¹²⁴ Një zgjidhje identike e hasim edhe në nenin 41, par.1, pika f. e Statuti i Bankës Pro Credit SH.A., Kosovë, fq.21

pasur interesa të tjera të ndërlidhura, në shkallë dhe lartësi të përcaktuar me ligj, nuk konsiderohet se e ka pavarësinë e duhur për t'u zgjedhur drejtor".¹²⁵

5.1.2. Autorizimi për formimin e Bordit menaxhues në SH.P.K. dhe SH.A

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqëria aksionare, qeveriset nga Kuvendi i aksionarëve dhe nga drejtori apo drejtorët menaxhues. Kështu, shoqëria mund të krijojë dhe mbajë një Bord të drejtorëve, nëse kjo është e rregulluar me marrëveshjen e shoqërisë dhe statut. "Nëse shoqëria formon Bordin e drejtorëve, atëherë autorizimet e bordit, numrin e anëtarëve, mënyrën e zgjedhjes, kohëzgjatjen e qëndrimit në detyrë si dhe mënyrën e votimit në Bord, pronarët e rregullojnë me marrëveshjen dhe statutin e shoqërisë"¹²⁶. Numri i anëtarëve në bordin e drejtorëve të shoqërisë duhet të përcaktohet në statutin e shoqërisë¹²⁷. Me dispozitat e Ligjit për shoqëritë tregtare, është përcaktuar se; "për një shoqëri me më pak se dhjetë aksionarë, bordi duhet të ketë një (1) ose më shumë anëtarë; për një shoqëri me dhjetë (10) ose më shumë aksionarë bordi duhet të ketë jo më pak se 3 (tre) anëtarë, kurse për një shoqëri me pesëqind (500) ose më shumë aksionarë bordi duhet të ketë jo më pak se shtatë (7) anëtarë".¹²⁸

Nga të dhënat e theksuara më lartë, rezulton se në juridiksionin dhe praktikën

¹²⁵ Neni 175 i Ligjit për shoqëritë tregtare të Kosovës.

¹²⁶ Krasniqi, A., po aty.

¹²⁷ Sipas neit 30 par.2 të Statutit të Pro Credit Bnak sh.a. Kosovë"... Bordi i drejtorëve ka numër tek të anëtarëve votues dhe do të përbëhet nga së paku 5 anëtarë. Shumica e këtyre anëtarëve duhet të jenë të pavarur, jo- drejtorë ekzekutiv dhe të paktën njëri nga ata duhet të jetë banorë në Kosovë..." Shih për këtë, neni 167 i LSHTK-së, sipas të cilit Drejtori nuk është e detyrueshme që të jetë banor i Kosovës, përveç nëse është caktuar ndryshe me statutin e shoqërisë.

¹²⁸ Neni 170, i Ligjit për shoqëritë tregtare i Kosovës.

juridike në Kosovë, është caktuar vetëm minimumi i numrit të anëtarëve të bordit, kurse maksimumi i anëtarëve të bordit ka mbetur të përcaktohet varësisht nga dëshira dhe interesi i pronarëve-aksionarëve të korporatës. Vrehet një dallim kur flitet për numrin e anëtarëve të bordit drejtues në ndërmarrjet publike, nga ajo që ka përcaktuar Ligji për shoqërit tregtare dhe që vlenë për korporatat, si u theksua më lartë. Kjo, pasi që nga praktika dhe legjislacioni në fuqi i cili rregullon menaxhimin e ndërmarrjeve publike në Kosovë, është përcaktuar se numri i anëtarëve të Bordit drejtues për një Ndërmarrje Publike Qendrore¹²⁹ është shtatë anëtarë, kurse për një Ndërmarrje Publike Lokale¹³⁰ katër anëtarë, pa marrë parasysh numrin e aksionarëve të cilët e themelojnë ndërmarrjen publike.¹³¹

Bordi i drejtorëve ushëhiqet nga kryesuesi i bordit, të cilin e zgjedhë vet bordi i drejtorëve, përveç rasteve kur është përcaktuar ndryshe me statut ose rregullore të shoqërisë. Bordi i drejtorëve mund ta zgjedhë kryesuesin e tij me shumicë votash të të gjithë drejtorëve, dhe gjithashtu, Bordi i drejtorëve edhe mund të shkarkojë dhe zëvendësojë kryesuesin në çdo kohë me shumicë votash. Kryesuesi i Bordit të drejtorëve, kryeson të gjitha mbledhjet e bordit dhe ato të aksionarëve dhe është përgjegjës për mbajtjen e të gjitha procesverbaleve nga të gjitha mbledhjet e Bordit.¹³²

¹²⁹ NP Qendrore (Ndërmarrje Publike Qendrore).

¹³⁰ NP Lokale (Ndërmarrje Publike Lokale).

¹³¹ Shih nenin 15 dhe 16 të Ligjit nr. 03/L-087 për ndërmarrjet publike, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Prishtinë: Viti III / Nr. 31 / 15 Qershor 2008, si dhe ndryshimet dhe plotësimet e tij Ligji nr. 04/L-111 Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 13 / 30 MAJ 2012, Prishtinë dhe Ligji Nr. 05/L - 009 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 10 / 07 maj 2015, Prishtinë.

¹³² Një zgjidhje të ngjashme e gjejmë edhe në nenin 35 të shih; Statuti i Bankës Pro Credit SH.A., Kosovë, fq.10.

Nëse kryesuesi ende nuk është zgjedhur ose nuk është i pranishëm në mbledhjen e Bordit ose të aksionarëve, atëherë një drejtor i zgjedhur me shumicë votash, shërben si kryesues i mbledhjes në fjalë.¹³³

Nga doktrina juridike në Kosovë, shifet se mbisundon mendimi se shoqëria aksionare e hapur ka për detyrim që të ketë Bordin e drejtorëve, kurse ajo e tipit të mbyllur, nuk është e detyruar që ta ketë një organ të tillë, por megjithatë sipas preferencave të aksionarëve edhe ajo mund ta emërojë një bord të tillë, edhe pse nuk është e detyruar që ta bëjë këtë emërim.

Pajtohem me mendimin e autorit Armand Krasniqi, sipas të cilit “Shoqëria aksionare e hapur ka Bordin e drejtorëve”, ndërsa “Shoqëria aksionare e mbyllur mund ta ketë Bordin e drejtorëve”¹³⁴.

5.1.3. Autorizimi i drejtorit menaxhues për të vepruar në emër të shoqërisë

Drejtori menaxhues është i autorizuar që ta përfaqësojë shoqërinë gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj tregtare, duke përfshirë edhe autorizimin për udhëheqjen e veprimtarisë së zakonshme të shoqërisë. Me rastin e përfaqësimit të shoqërisë, drejtori menaxhues ka autorizim për nënshkrimin e marrëveshjeve ose dokumenteve tjera të nevojshme, kurse ky nënshkrim çdoherë duhet të ndërlidhet në masë të arsyeshme me ushtrimin e veprimtarisë së zakonshme tregtare të shoqërisë. Një veprim i drejtorit menaxhues, i cili nuk është në vazhden e ushtrimit të veprimtarisë së rregullt tregtare të shoqërisë, është i detyrueshëm për shoqërinë vetëm nëse ky veprim është autorizuar shprehimisht nga marrëveshja e shoqërisë, ose me një autorizim të posaçëm të miratuar

¹³³ Nen 177, i Ligjit për shoqëritë tregtare i Kosovës.

¹³⁴ Krasniqi, A., op.cit. fq.222.

me votën e pronarëve. Nga ajo që u cek më lartë, vlen qëndrimi se, në rastet kur drejtori menaxhues i korporatës ose cilido person tjetër, me keqbesim vepron në emër të shoqërisë pa autorizimin e nevojshëm, ai do të jetë personalisht përgjegjës për të gjitha dëmet që i janë shkaktuar shoqërisë e, gjithashtu, edhe personit ose organizatës tjetër, e cila është dëmtuar nga këto veprime. Një përgjegjësi e tillë e drejtorit menaxhues, është përcaktuar me qëllim të mbrojtjes së shoqërisë, aksionarëve dhe pretendentëve të tjerë, nga veprimet e kundërligjshme të drejtorit menaxhues. Qëndrimi i theksuar më lart, buron nga vet Ligji për shoqëritë tregtare, sipas të cilit: “Përveç nëse është përcaktuar ndryshe në marrëveshjen e shoqërisë, secili drejtor menaxhues i shoqërisë e cila ka dy ose më shumë drejtorë menaxhues, do të ketë autorizimin dhe të drejta të njëjta për menaxhimin e shoqërisë”.¹³⁵

5.1.4. Autoriteti dhe Kompetencat e Bordit të Drejtorëve

Si u theksua më lartë, bordi i drejtorëve është organi që merret me të gjitha punët e administrimit të shoqërisë. Si rezultat i kësajë, në kompetencë të tij janë të gjitha çështjet e shoqërisë, me përjashtim të atyre, të cilat u janë rezervuar aksionarëve me ligj ose me statutin e shoqërisë. Duke marrë parasysh rezervimet e lartpërmendura, çështjet të cilat janë nën fushëveprimin e bordit të drejtorëve, kryesisht kan të bëjnë, me: miratimi i planeve gjithëpërfshirëse të shoqërisë, konvokimin e mbledhjeve vjetore dhe të jashtëzakonshme të aksionarëve, punësimin e zyrtarëve ose menaxherëve të lartë të kompanisë, miratimin e kushteve të marrëveshjeve ndërmjet menaxhmentit të lartë dhe kompanisë etj.

¹³⁵ Neni 110 I LSHTK.

Përpos autorizimeve të përmendura, Bordi i drejtorëve, gjithashtu; bënë vendosjen e shpërblimit dhe kushtet tjera të marrëveshjes me auditorin e shoqërisë, përcaktimin e shumave dhe caktimin e datave të pagesës dhe procedurat për pagesën e dividendëve, miratimin e raportit vjetor të shoqërisë, raportin e bilancit vjetor dhe vlerësimeve vjetore të fitimeve dhe të humbjeve, të cilat pastaj do të dorëzohen tek aksionarët për miratim, si dhe vendosjen për të gjitha çështjet e tjera, të cilat kanë të bëjnë me kompetencën ekskluzive të bordit të drejtorëve të përcaktuar me statutin e shoqërisë. Bordi i drejtorëve, gjithashtu, posedon edhe me kompetenca tjera ekskluzive të cilat kanë të bëjnë me auditimin, në mënyrë që të sigurojë kushte që raporti i auditorit do t'u dërgohet të gjithë aksionarëve dhe të jetë në dispozicion për çdo drejtor dhe zyrtarë. Ky raport do të nënshkruhet nga Kryesuesi i Bordit dhe, së paku, nga një drejtor dhe do t'u shpërndahet të gjithë drejtorëve, zyrtarëve dhe aksionarëve. Për shkak të rëndësisë së çështjeve që janë në kompetencë të Bordit drejtues të korporatës, këto çështjet nuk mund të barten e, gjithashtu, për to nuk mund të vendoset nga personat tjerë ose organet e tjera të shoqërisë. Shmangie nga ky qëndrim mund të bëhet vetëm përjashtimisht dhe “në bazë të një vendimit të aksionarëve të marrë në mbledhjen e aksionarëve apo, nëse urdhërohet ndryshe nga aksionarët”.¹³⁶

5.1.5. Dorëheqja dhe shkarkimi i Drejtorëve

Sipas juridiksionit të Kosovës, drejtori mund të jap dorëheqje në çdo kohë, përmes dërgimit të një njoftimi me shkrim, bordit të drejtorëve ose kryesuesit të tij. Kurse për mënyrën e shkarkimit të drejtorëve kemi bërë fjalë në kapitullin e katërt, kur

¹³⁶ Për më tepër lidhur me kompetencat e bordit të drejtorëve, shih: neni 169 i LSHTK.

janë trajtuar të drejtat e aksionarëve dhe realizimi i tyre në asamblenë e përgjithshme.¹³⁷

5.1.6. Mbledhjet e bordit të drejtorëve, kuorumi dhe votimi

Bordi i drejtorëve, me qëllim të kryerjes së susesëshme të punëve nga fushveprimtaria e tijë, mbanë mbledhje të rregullta dhe të jashtëzakonshme. Kështu, Bordi i drejtorëve mban një mbledhje të rregullt, që njihet si mbledhje vjetore, e cila mbahet një herë në vit, e e cila mbahet menjëherë pas mbajtjes së çdo mbledhje vjetore të aksionarëve. Mbledhjet e tjera të rregullta mbahen në kohën dhe vendin që cakton bordi në mbledhjen vjetore ose në një mbledhje tjetër të bordit, për të cilën janë njoftuar të gjithë drejtorët. Njoftimi për mbajtjen e mbledhjeve të rregullta të bordit, nuk ka nevojë të dërgohet anëtarëve të bordit, përveç nëse një veprim të tillë, për ndonjë arsye specifike e kërkon vet bordi i drejtorëve. Si u tha më lartë, përpos mbledhjeve të rregullta, bordi mban edhe mbledhjet e jashtëzakonshme, të cilat mund të organizohen në çdo kohë nga kryesuesi i bordit ose nga ndonjëri drejtor. Njoftimi për mbledhjet e jashtëzakonshme të bordit, bëhet përmes dërgimit të kërkesës me shkrim nga cilido drejtor, që i drejtohet kryesuesit të bordit. Personi që thërret mbledhjen e jashtëzakonshme duhet të lajmërojë për vendin dhe kohën e mbledhjes.

Pjesëmarrja e një drejtori në cilëndo mbledhje përbën në vete heqjen dorë nga çdo njoftim i kërkuar për atë mbledhje. Kjo për faktin se, drejtori i cili merr pjesë në mbledhje dhe nuk e konteston mënyrën e organizimit të mbledhjes, konsiderohet se është mjaftueshëm i informuar lidhur me çështjet të cilat trajtohen në mbledhje. Prezumimi i sipërtheksuar është prezumim i rrëzueshëm dhi si i tillë nuk konsiderohet,

¹³⁷ Shih kapitulli IV, i këtijë punimi; pjesa 4.1.1, 4.2.1 dhe 4.3.1.

në rastin kur një drejtor merr pjesë në mbledhje të bordit, dhe në këtë mbledhje merr pjesë me të vetmin qëllim për ta kundërshtuar diskutimin e pikave të mbledhjes dhe faktin se mbledhja nuk është thirrur ose mbajtur me rregull dhe këtë kundërshtim të tij e deklaron në fillim të mbledhjes.¹³⁸

Kur flitet për kuorumin e anëtarëve të bordit, vlen parimi se shumica e numrit të përgjithshëm të drejtorëve të caktuar me statutin e shoqërisë apo me rregullore, përbën kuorumin për transaksionet e veprimtarisë tregtare, përveç nëse me statut apo rregullore është përcaktuar numër më i madh për kuorum. Prandaj, “aktiviteti i shumicës së drejtorëve, të cilët janë të pranishëm në mbledhje në të cilën ekziston kuorumi do të konsiderohet aktivitet i bordit, përveç nëse me statutin ose rregulloren kërkohet një numër më i madh i drejtorëve”.¹³⁹

5.1.7. Veprimet e Bordit drejtues, pa mbajtjen e mbledhjes

Në parim, të gjitha aktivitetet të cilat mund të ndërmerren në mbledhjet e bordit, mund të ndërmerren edhe pa mbajtjen e mbledhjes. Përfshirë nga kjo rregull, bëjnë vetëm rastet kurë me statut ose rregullore të shoqërisë kërkohet që, një aktivitet i Bordit të ndërmerret ekskluzivisht në mbledhje të tij, Në këtë mënyrë mundë të veprohet nëse nga të gjithë drejtorët me të drejtë vote për një çështje të caktuar, është dhënë dhe është nënshkruar pëlqimi me shkrim. Mënyra e tillë e vendosjes, ka për qëllim ekonomizimin dhe efikasitetin e punës së bordit, ku është dhënë mundësia që Bordin të marrë vendime pa formalitete të theksuara. Gjithashtu, me këtë veprim është siguruar edhe

¹³⁸ Neni 178, , i Ligjit për shoqëritë tregtare i Kosovës.

¹³⁹ Po Aty, Neni 179.

transparenca dhe njoftimi i të gjithë anëtarëve të bordit, lidhur me veprimet të cilat ndërmerren. Kjo për faktin se anëtarët e bordit, në rast të tilla janë të informuar me vendimet të cilat merren dhe kanë mundësi ta shprehin mendimin e vet në vendosje. Kjo arrihet, në mënyrë që pëlqimet e dhëna nga anëtarët e bordit bëhen me miratimin me shkrim, si dhe të kenë nënshkrimin e një ose më shumë drejtorëve. Për t'u konsideruar të pranueshme pëlqimet, të gjitha duhet të vendosen në procesverbalin nga mbledhja e Bordit të drejtorëve të shoqërisë. Pëlqimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga të gjithë drejtorët, përveç nëse në pëlqim është caktuar një datë tjetër e hyrjes në fuqi.

Komisionet e Bordit.- Statuti ose rregulloret mund të përcaktojnë, ose drejtorët mund të miratojnë një vendim që themelon një ose më shumë komisione, (komisioni për auditim ose për shqyrtimin e kompensimeve) që do të shqyrtojë, hulumtojë, rekomandojë ose të marrë masa të tjera jo obligative e që janë në kuadër të kompetencës së bordit. Anëtarë të komisioneve mund të jenë edhe anëtarët e Bordit të drejtorëve dhe punëtorët e shoqërisë, si dhe persona jashtë kompanisë. Përveç nëse statuti, rregulloret ose vendimi i bordit kërkojnë një numër më të madh, shumica e anëtarëve të komisionit e përbëjnë kuorumin dhe shumica e kuorumit është e nevojshme për çdo rekomandim ose veprim tjetër të komisionit. Të gjitha vendimet dhe veprimet e tjera të komisionit i nënshtrohen rishikimit, ndryshimit dhe miratimit me jo më pak se 2/3 e anëtarëve të Bordit.

Me qëllimin e sigurimit të transparencës dhe sigurisë së punës së Bordit të drejtorëve, procesverbali i secilës mbledhje të bordit ose e cilitdo komision, duhet të mbahet gjatë mbledhjes. Procesverbali formal me shkrim duhet të përgatitet jo më shumë se dhjetë ditë pas mbledhjes. Procesverbali përfshin kohën dhe vendin e

mbledhjes, personat e pranishëm dhe agjendën e mbledhjes, çështjet e hedhura në votim, detajet e diskutimeve dhe arsyet e dhëna për çfarëdo vote negative ose abstenimi. Gjithashtu, procesverbali përmban rezultatet e secilit votim, duke përfshirë emrin e secilit person që ka qenë i pranishëm dhe ka pasur të drejtë vote dhe një indikacion të asaj se si ky person ka votuar. Përpos asaj që u theksua më lartë, procesverbali përmban edhe të gjitha vendimet e miratuara në mbledhje. Procesverbali formal me shkrim, nënshkruhet nga drejtori që e ka kryesuar mbledhjen dhe nga personi që ka shërbyer si sekretar në mbledhje.¹⁴⁰

5.1.8. Zyrtarët

Për kryerjen me sukses të punëve të nevojshme për administrimin e shoqërisë, bordi i drejtorëve të korporatës mundë të punësojë zyrtarë dhe menaxherë të lartë të korporatës, të cilët punojnë nën drejtimin e bordit të drejtorëve dhe u raportojnë atyre për punën e tyre. Zyrtarët e korporatës i kanë kompetencat dhe autorizimet e përcaktuara në rregullore, kurse bordi mund t'u delegojë atyre kompetenca dhe autorizime të tjera për ushtrimin e veprimtarisë së korporatës. Bordi i drejtorëve, tek zyrtarët e përmendur mundë t'i delegoj të gjitha çështjet, me përjashtim të atyre të cilat janë shprehimisht të rezervuara për bordin e drejtorëve ose për aksionarët. Nëse korporata ka vetëm një zyrtar, ai i ka të gjitha autorizimet e përmendura më lartë, si dhe detyrimet e sekretarit të kompanisë. Bordi i drejtorëve e punëson dhe emëron zyrtarin kryesor, të cilit mund t'ia jap titullin “*zyrtar kryesor ekzekutiv*”, “*kryetar*”, “*drejtore menaxhues*” ose titull tjetër të ngjashëm. Në shumë korporata, zyrtari i përmendur është

¹⁴⁰ Nenet 180, 181 dhe 182 të Ligjit për shoqëritë tregtare të Kosovës.

i emëruar, si “Kryeshef ekzekutiv” i korporatës¹⁴¹. Kompetencat dhe autorizimet kryesore të kryeshefit ekzekutiv, janë të përcaktuara me ligj dhe me rregulloret e shoqërisë. Përveç detyrave të përcaktuara në këtë mënyrë, ky person është i autorizuar që të veprojë në përgjithësi (pa ndonjë dokument autorizimi) në emrin e kompanisë, t’i përfaqësojë interesat e kompanisë në përmbylljen e transaksioneve në emrin e kompanisë, si dhe të japë udhëzime për zyrtarët e tjerë të kompanisë. Me qëllim të sigurimit të transparencës në qeverisjen e korporatës caktohet një zyrtar, i cili posaqërisht është përgjegjës për regjistrimin e të dhënave dhe veprimeve në mbledhjet e aksionarëve dhe bordit të drejtorëve. Regjistrimi i këtyre të dhënave, bëhet në një libër, i cili mbahet për këtë qëllim, dhe duhet të jetë në dispozicion të aksionarëve dhe anëtarëve të bordit të drejtorëve. Personi në fjalë njihet si “sekretar i kompanisë”.

Të gjithë zyrtarët janë të detyruar që punët e korporatës, me të cilat janë të ngarkuar, t’i kryejnë në përputhje me statutin, rregulloret si dhe çfarëdo vendimi të bordit të drejtorëve të shoqërisë. Zyrtarët e përmendur munden që të shmangen nga kryerja e punëve të përmendura, vetëm nëse do të ishin në kundërshtim të qartë me këtë ligj, statutin ose rregulloret e shoqërisë.¹⁴²

5.1.9. Detyrimi për mbajtjen e librave dhe arkivës dhe sigurimi i qasjes

Drejtorët menaxhues të shoqërisë janë të detyruar që të përgatisin dhe mbajnë librat dhe arkivën e shoqërisë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi. Gjithashtu, ata

¹⁴¹ Shih Statuti i Kompanisë Rajonale të Mbeturinave -KRM “Pastërtia”sh.a. me seli në Ferizaj, i datës 31.10.2014, neni 14 par.2, nënparg.2.1, pika 5, <http://pastertia.com/konkurset/Statuti.pdf>, shikuar për herë të fundit me 25.02.2016.

¹⁴² Neni 183 i Ligjit për shoqëritë tregtare i Kosovës.

janë të detyruar që të përgatisin një listë të llogarisë vjetore, si dhe raportin për menaxhimin e shoqërisë dhe këto t’ua prezantojnë pronarëve në fund të çdo viti financiar të shoqërisë. Detyrim tjetër i vazhdueshëm i drejtorëve menaxhues është detyrimi që gjatë orarit të punës, t’u ofrojnë të gjithë pronarëve të shoqërisë qasje në arkivën, librat dhe raportet e shoqërisë, me qëllim të shqyrtimit ose kopjimit të këtyre dokumenteve¹⁴³.

Respektimi i rregullave të përshkruara si më sipër, është i domosdoshëm me qëllimin e sigurimit të qasjes së aksionarëve në librat dhe dokumentacionin afarist të shoqërisë, kusht ky i kërkuar me ligj dhe parimet e OECD-së dhe me qëllim të qeverisjes së mirë korporative¹⁴⁴.

5.1.10. Parimi i kujdesi dhe vlerësimit afarist

Njëri ndër detyrimet fiduciare të anëtarëve të Bordit drejtues, është edhe parimi i kujdesit dhe vlerësimit afarist, të cilit duhet t’i përmbahen drejtorët dhe drejtorët menaxhues në raport me korporatën. Si rezultat i detyrimit për respektimin e këtij parimi, drejtorët janë të detyruar që çdo veprim të cilin e ndërmarrin lidhur me shoqërinë, veprimi i tillë gjithësesi duhet të jetë në interesin më të mirë të shoqërisë. Parimi i vlerësimit afarist, është parim me të cilin supozohet se janë të “veshur” të gjithë drejtorët dhe një supozim i tillë vlen gjithnjë, deri sa mos të vërtetohet e kundërta¹⁴⁵.

¹⁴³ Neni 111, i Ligjit për shoqëritë tregtare i Kosovës.

¹⁴⁴ Për të drejtën e aksionarëve për qasje në informacionet dhe veprimtarinë e shoqërisë, shih Qeverisja e korporatave; Manual, Korporata Financiare Ndërkombëtare-IFC, Tiranë, 2009 fq.151.

¹⁴⁵ Për më tepër, shih Shoqëritë Tregtare, Për EMSG-Economic Management for Stability and Growth, sponzoruar nga USAID, Tetor 2008, përgaditur nga Dr.Jur.Korab R. Sejdiu, Moduli 8:Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar, fq.16.

Nga ajo që u theksua më lart, drejtori menaxhues i shoqërisë është i detyruar që gjithmonë të veprojë në mirëbesim, duke besuar me arsye se është duke vepruar në interesin më të mirë të shoqërisë, dhe me kujdesin dhe vëmendjen e domosdoshme për përgjegjësitë e tij. Personi-drejtori menaxhues i cili vepron në harmoni me parimin në fjalë dhe i cili bën një vlerësim afarist me mirëbesim dhe në mënyrë që është në pajtim me detyrat e tij, nuk do të jetë personalisht përgjegjës për dëmet që mund të lindin si pasojë e vlerësimit të tij¹⁴⁶. Ky përjashtim nga përgjegjësia direkte e drejtorit menaxhues, vlenë në të gjitha rastet, përveç nëse konstatohet se drejtori menagjus e ka shkelur detyrimin për lojalitet ose ka pasur interes personal në rastin përkatës, sikurse është përcaktuar në ligjin për shoqëritë tregtare.¹⁴⁷

Nga arsyet e sipërtheksuara, secili drejtor dhe punonjës është i detyruar që të veprojë me mirëbesim, dhe t'i përmbushë e t'i zbatojë detyrat dhe detyrimet e përcaktuara në ligj, akte të brendëshme të korporatës dhe me kontratën e punës. Drejtorët, gjithashtu, janë të obliguar që të sigurojnë që vendimet e tyre që ndërlidhen me korporatën, të bëhen duke qenë të bindur se janë duke vepruar në masë të arsyeshme në interesin më të mirë të shoqërisë dhe duke u kushtuar vëmendje të duhur përgjegjësi të tyre. Gjithashtu, vendimet e drejtorëve duhet të ndërmerren edhe duke u kushtuar kujdes të veçantë çështjeve që duhet të vendosen sipas informatave që në masë të arsyeshme janë në disponim të drejtorëve. Personat-drejtorët, të cilët veprojnë

¹⁴⁶ Lidhur me parimin e kujdesit dhe vlerësimit afarist, shih Prirucnik za pripremu pravosudnog ispita, Ministrastvo Pravde, Kosovo, Trece izdanje, Pristina 2009, Dr.Jur.Korab Sejriu dhe Mr.Sc.Vjosa Osmani, Privredno Pravo, str.644.

¹⁴⁷ Neni 112 i Ligjit për shoqëritë tregtare i Kosovës ka përcaktuar detyrimin për lojalitet, kurse neni 113 ka përcaktuar të gjitha situatat, sipas të cilave vlerësohet lojaliteti i drejtorëve.

sipas parimeve të shpjguara më lartë dhe që vendimin afarist e kanë marrë me mirëbesim, nuk mund të mbahen personalisht përgjegjës nga kompania e as nga aksionarët, për dëmet që rrjedhin si pasojë e atij vendimi.¹⁴⁸

5.1.11. Detyrimi për lajmërimin e interesave personale dhe financiare dhe detyrimi për lojalitet

5.1.11.1. Detyrimi për lajmërimin e interesave personale dhe financiare.

Secili zyrtar ose drejtor është i detyruar të lajmërojë para Bordit të drejtorëve ose para një komisioni vendimmarrës, lidhur me çfarëdo interesi personal ose financiar që ai ka, e që lidhet me afarizmin e korporatës¹⁴⁹. Për respektimin e këtij parimi, secili zyrtar ose drejtor duhet t'i shmanget konflikteve aktuale dhe potenciale mes interesave personale dhe atyre të kompanisë¹⁵⁰. Ky lajmërim duhet të bëhet zakonisht nga një zyrtar ose drejtor në kohën kur ai punësohet, zgjidhet ose emërohet në atë post. Nëse ky lajmërim bëhet më vonë, lajmërimi duhet bërë menjëherë në kohën, kur zyrtari ose drejtori vjen në dijeni të interesit financiar ose personal¹⁵¹. Po ashtu, lajmërimi përkatës bëhet në kohën kur një vendim ose transaksion përkatës është në diskutim nga drejtorët, zyrtarët ose aksionarët.

5.1.11.2. Detyrimi për lojalitet - Nëse një zyrtar ose drejtor nuk e bën lajmërimin e interesave personale dhe financiare siç u theksua më lart, ai mund të largohet ose

¹⁴⁸ Neni 186 i Ligjit për shoqëritë tregtare i Kosovës.

¹⁴⁹ Po aty, Neni 184 par.1.

¹⁵⁰ Neni 27 parag 2, i Ligjit për ndryshimin dhe plotesimin e Ligjit për shoqëritë tregtare i Kosovës.

¹⁵¹ Galgano F, (2009). *E drejta tregtare-sipërmarrësi-shoqëritë*, Botim kompakt, LUARASI, University press, Tiranë, fq.696-698.

pushohet nga puna në korporatë dhe në të dyja rastet, është përgjegjës për dëmet që i shkaktohen korporatës, si rezultat i moslajmërimit të interesit personal dhe financiar. Kjo për faktin se, dështimi për ta bërë lajmërimin, njëkohësisht cenon detyrimin e drejtorit për lojalitet ndaj korporatës. Drejtori ose zyrtari, janë nën detyrimin e vazhdueshëm që gjatë tërë kohës të veprojnë në mënyrë të drejtë dhe besnike ndaj kompanisë në lidhje me të gjitha çështjet dhe interesat materiale të kompanisë. Përkundër përcaktimit të përmendur, drejtori ose zyrtari, të cilët lidhin një kontratë ose transaksion me shoqërinë, nuk konsiderohet se e kanë shkelur detyrën për lajmërimin e interesave të tyre, nëse të gjitha faktet materiale në lidhje me interesat e tyre janë lajmëruar apo dihen nga organi vendimmarrës, i cili e miraton vendimin¹⁵². Si rezultat i kësaj, drejtori menaxhues i shoqërisë, i cili ka interes personal në një çështje që ka të bëjë me shoqërinë, është rreptësisht i detyruar që menjëherë ta zbulojë këtë interes para pronarëve dhe në lidhje me atë çështje, të veprojë në mënyrë të drejtë dhe lojale ndaj shoqërisë.

Ky detyrim nuk kufizohet vetëm në, detyrimin për mos shfrytëzimin e pronës së shoqërisë për nevoja ose përfitime personale, mosshfrytëzimin e të dhënave konfidenciale të shoqërisë me qëllim të përfitimit personal, mosshfrytëzimin e mundësive afariste të shoqërisë për interesa të veta¹⁵³. Në fakt për të përmbushur detyrimin për lojalitet, drejtori duhet që në të gjitha këto situata, të veprojë vetëm në interesin e shoqërisë në të gjitha veprimet dhe transaksionet për të cilat ai ka interes

¹⁵² Për më tepër lidhur me lirimin e drejtorit menaxhues, shih neni 184 i Ligjit për shoqëritë tregtare i Kosovës, dhe neni 27 i Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shoqëritë tregtare i Kosovës.

¹⁵³ Korab Sejriu dhe Vjosa Osmani, vep. cit. fq.644.

personal. Drejtori menaxhues konsiderohet se ka interes personal në një veprimtari ose transaksion nëse: ai ose ndonjë anëtar i familjes së tij është palë ose përfiton në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nga veprimtaria ose transaksioni i caktuar. Gjithashtu, do të konsiderohet se ekziston interesi personal i drejtorit, edhe nëse ai ka marrëdhënie financiare ose familjare me një palë që ka interes në veprimtarinë, vendimin ose transaksionin në fjalë; ose është nën kontrollin ose ndikimin e një pale që ka interes në veprimtarinë, vendimin ose transaksionin në fjalë, dhe që mund të pritët se do të ndikojë në dëm të shoqërisë.¹⁵⁴

Drejtori menaxhues, që lidhë ose dëshiron të lidhë kontratë ose të bëjë një transaksion me shoqërinë, nuk konsiderohet se ka bërë shkeljen e detyrimit të mësipërm, dhe nuk mund të jetë personalisht përgjegjës për dëmet që mund të lindin si pasojë e konfliktit të interesave të tij, nëse të gjitha faktet materiale lidhur me interesin e tij, zbulohen dhe bëhen të njohura për të gjithë pronarët e shoqërisë apo drejtorët e shoqërisë. Gjithashtu nuk do të konsiderohet shkelje e detyrimit për lojalitet, nëse kontrata ose transaksioni është miratuar me mirëbesim nga të gjithë pronarët në mbledhjen ose mbledhjet që mbahen nga pronarët apo drejtorët për shqyrtimin dhe votimin e kontratës ose transaksionit.¹⁵⁵

5.1.12. Detyrimi për moskonkurrencë

Drejtori menaxhues i shoqërisë, është i detyruar që t'i përmbahet detyrimit të tij për moskonkurrencë ndaj korporatës ku vepron. Nga kjo arsye, drejtori nuk mund të angazhohet në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, e as të marrë pjesë ose të ketë

¹⁵⁴ Për detyrimin për lojalitet, po kështu shih edhe Korab Sejdiu, 2008, vep. cit. fq.17.

¹⁵⁵ Neni 113, i Ligjit për shoqëritë tregtare i Kosovës.

interes në një veprimtari që është në konkurrencë me shoqërinë.

Ndalesa e mësipërme përfshin, por nuk kufizohet, në përfshirjen e drejtorit menaxhues si punonjës, konsulent, kontraktor, ortak i përgjithshëm, menaxher, drejtor, pronar kontrollues ose aksionar në një shoqëri tregtare që angazhohet në veprimtari e cila është në konkurrencë me veprimtarinë e shoqërisë¹⁵⁶. Zyrtarët dhe drejtorët nuk mund të jenë të përfshirë në konkurrencë tregtare kundër shoqërisë. Kjo konkurrencë përfshinë, por nuk kufizohet vetëm në punësimin, të qenit ortak i përgjithshëm, menaxher, drejtor ose anëtar kontrollues ose aksionar në ndonjë shoqëri tjetër tregtare që ushtron aktivitete tregtare konkurruese.¹⁵⁷

5.1.13. Kryerja e detyrave fiduciare nga drejtorët menaxhues personalisht ose si rrjedhojë e një vendimi gjyqësor

Nëse drejtorët menaxhues nuk respektojnë dhe nuk kryejnë të gjitha detyrat e përmendura fiduciare, vullnetarisht dhe personalisht, atëherë aksionarët kanë mundësi dhe të drejtë që realizimin e të drejtave të tyre ta kërkojnë përmes vendimit gjyqësor. Për ta realizuar një të drejtë të tillë, secili pronar (aksionar) i shoqërisë ka të drejtë që në emrin dhe për interesat e tij, të paraqesë padi në gjykatë. Një pronarë-aksionar ose disa nga ata, gjithashtu kanë të drejtë që në emër të shoqërisë dhe për interesat e tyre, të paraqesin padi në gjykatë kundër një drejtori menaxhues, me qëllimin të mbrojtjes dhe

¹⁵⁶ Neni 114, i Ligjit për shoqëritë tregtare i Kosovës. Gjithashtu, edhe Korab Sejsiu dhe Vjosa Osmani, vep. cit. fq.645.

¹⁵⁷ Neni 187, i Ligjit për shoqëritë tregtare i Kosovës.

realizimit të të drejtave që pronari ose shoqëria kanë kundër drejtorit menaxhues për shkak të shkeljes së detyrës së tij ndaj shoqërisë. Në rastet kur pronari-aksionari kërkon ekzekutimin e të drejtës së shoqërisë kundër një drejtori menaxhues, të gjitha dëmet që i atribuohen drejtorit menaxhues duhet të jenë dëme të shkaktuara ndaj pasurisë së shoqërisë.

Në raste të tilla, kur konstatohet se ankesa ose padia është e bazuar, gjykata nxjerr vendim në favor të pronarit dhe kundër drejtorit menaxhues, me ç'rast drejtori menaxhues duhet të paguajë edhe shpenzimet e arsyeshme të pronarit. “Këto shpenzime të arsyeshme duhet të përfshijnë kompensimet ligjore, të cilat bëhen nga pronari lidhur me përgatitjen, dorëzimin dhe udhëheqjen e ankesës”.¹⁵⁸

5.1.14. E drejta e drejtorëve ekzekutiv për kompensim

Shoqëria mund t’iu paguajë pagën drejtorëve dhe t’iu kompensojë shpenzimet e arsyeshme që ata i bëjnë gjatë ushtrimit të detyrës së tyre si drejtor të shoqërisë. Vendimi për këtë pagë ose kompensim si dhe miratimi i shumës dhe kushteve kryesore mund të merret vetëm nga aksionarët apo nga një komision i jashtëm, të cilit aksionarët ia delegojnë këtë përgjegjësi. Kjo duhet të bëhet për çdo vazhdim ose ndryshim të kushteve të drejtorëve. Nëse ky vendim ose ndryshim i kushteve për pagesën e drejtorëve është deleguar, si bie fjala në komisionin për kompensime, atëherë vendimi duhet të prezantohet para mbledhjes së ardhshme të aksionarëve.¹⁵⁹

¹⁵⁸ Neni 115 i Ligjit për shoqëritë tregtare i Kosovës.

¹⁵⁹ Neni 168 i Ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare i Shqipërisë.

5.2. Këshilli i Administrimit - Këshilli Mbikëqyrës dhe administratorët, dhe roli i tyre në qeverisjen e korporatave në Shqipëri

Si kemi theksuar më lartë, edhe në Shqipëri, ashtu si edhe në shumë juridiksione të tjera, shoqëritë aksionare kanë mundësi të zgjedhin dhe të vendosin se, a do të përcaktohen për sistemin me një nivel të qeverisjes së korporatës apo me dy nivele. Në rastin e parë organ qeverisës i korporatës do të ishte Këshilli i Administrimit, i cili do të përbëhej nga anëtarë administratorë dhe jo administratorë, kurse në rastin e dytë me korporatën do të qeveriste Këshill Mbikëqyrës dhe Administratorët. Në funksion të qartësisë, dhe për të qenë në përputhje me teorinë dhe praktikën më të mirë botërore; kodi i drejtimit të brendshëm të shoqërive aksionare jo të regjistruara në bursë, “e përdor termin e përgjithshëm “këshill” me kuptimin: Këshilli i Administrimit (në shoqëritë me sistemin e drejtimit me një nivel) dhe Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratorët (në shoqëritë me sistemin e drejtimit me dy nivele)”¹⁶⁰.

Nga ajo që është trajtuar në këtë kuptim, rezulton se edhe Ligji për tregtarët dhe shoqëritë tregtare i Republikës së Shqipërisë, ka lënë mundësinë e administrimit të korporatave, sipas sistemit me dy nivele ose sistemit me një nivel. Sipas legjislacionit të Shqipërisë, kjo formë e vendosjes ose përcaktimit, është e lejuar, vetëm për shoqërinë aksionare (SH.A.). Nga kjo arsye, mund të përfundojmë se themeluesit e shoqërisë aksionare kanë mundësi që vullnetarisht të përcaktohen se, a dëshirojnë që të organizojnë administrimin e shoqërisë sipas sistemit me një nivel të qeverisjes apo sipas sistemit me dy nivele të qeverisjes. Sa i përket organizimit të administrimit në

¹⁶⁰ Kodi i drejtimit të brendshëm të shoqërive aksionare jo të regjistruara në bursë; http://www.ecgi.org/codes/documents/cg_code_unlisted_companies_albania_14apr2008_al.pdf, shikuar për here të fundit, me 10.08.2015, ora 14,45h.

shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar (SH.P.K.), detyrimisht, vlen parimi i organizimit të administratës me dy nivele. Deri sa i referohemi çështjes në fjalë, vlen të theksohet fakti se sipas legjislacionit të Kroacisë dhe Kosovës, korporata konsiderohen shoqëritë aksionare dhe shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar. Një gjë e tillë dallon në legjislacionin e Shqipërisë, pasi sipas legjislacionit të Shqipërisë, korporatë konsiderohet vetëm shoqëria aksionare, prandaj ky punim nuk i referohet qeverisjes së shoqërive me përgjegjësi të kufizuar në Shqipëri, nga se sipas ligjit shqiptar, të njëjtat nuk konsiderohen korporata. Nga kjo arsye, në trajtimin e kësaj teme në pjesën e cila i dedikohet qeverisjes së korporatave në Shqipëri, ne i jemi referuar vetëm shoqërive aksionare, me ofertë private dhe publike. Bazuar në atë që u tha më sipër, ne kemi trajtuar dy format e organizimit të administrimit të korporatave në Shqipëri, duke radhitur, si formë të parë (administrimin me dy nivele), e cila është rregulluar me dispozitat ligjore nga neni 154-165 të LTSHTSH, dhe si formë të dytë të organizimit (administrimin me një nivel), e cila është rregulluar me dispozitat ligjore nga neni 166 dhe 167 të LSHTKR. Nga vlerësimi i doktrinës dhe legjislacioni shqiptar, konsiderojmë se organe qeverisëse në korporatat shqiptare janë; Këshilli i administrimit, si organ i vetëm administrimi, i cili ushtron njëkohësisht, funksionin e administrimit dhe mbikëqyrjes, të veprimtarisë së shoqërisë (sistemi me një nivel), përkatësisht Këshilli mbikëqyrës dhe një apo më shumë administratorë, ku funksionet e administrimit dhe të mbikëqyrjes shpërndahen ndërmjet këtyre dy organeve (sistemi me dy nivele). Varësisht nga ajo se si është përcaktuar me statutin e korporatës, administratorët mund të caktohen e shkarkohen nga Asambleja e përgjithshme apo nga Këshilli mbikëqyrës.¹⁶¹

¹⁶¹ Për më tepër, shih Malltezi, A., vep. cit. fq. 185-186.

5.2.1. Administrimi i korporatës me një nivel të qeverisjes

Në rastin e organizimit të administratës me një nivel të qeverisjes, në korporatë nuk organizohet Këshilli mbikëqyrës. Në këtë formë të organizimit, si organe të shoqërisë përpos Asamblesë së përgjithshme, janë edhe Këshilli i administrimit dhe administratorët. Në këtë formë të organizimit, **Këshilli i administrimit** paraqitet si organ ekzekutiv në raport me themeluesit, por njëkohësisht ky organ paraqitet në rolin e organit mbikëqyrës në raport me **administratorët**, të cilët merren ekskluzivisht me udhëheqjen dhe ekzekutimin e punëve të shoqërisë.

5.2.1.1. Këshilli i administrimit - të drejtat dhe detyrimet, numri, emërimi dhe përbërja.

Këshilli i administrimit si organ i administrimit të korporatës me një nivel, ka të drejta dhe përgjegjësi, në lëmin e administrimit të korporatës. Nga kjo, këshilli i administrimit, kryesisht jep direktiva për administratorët për zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë, pasi që në këtë formë të organizimit të korporatës, administratorët ekzekutojnë direktivat e këshillit të administrimit. Përpos kësaj, këshilli kontrollon dhe mbikëqyrë zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë nga administratorët¹⁶². Përpos punëve të përmendura, këshilli, me kërkesën e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve (APA) përgatitë marrjen e masave të cilat janë në kompetencë të APA-së dhe i rekomandon asaj marrjen e vendimeve të nevojshme. Gjithashtu, këshilli i administrimit, thërret mbledhjen e asamblesë sa herë vlerësohet e nevojshme për interesat e shoqërisë. Këshilli është përgjegjës për përkujdesjen që shoqëria të respektojë ligjin dhe standardet e kontabilitetit, të shqyrtojë e të kontrollojë librat

¹⁶² Për më tepër, shih Malltezi, A., vep.cit., fq.205.

kontabël, dokumentet dhe aktivet e shoqërisë; të sigurojë se pasqyrat financiare vjetore, raportet e ecurisë së veprimtarisë, si dhe detyrimet e tjera të raportimit e publikimit, të detyrueshme në bazë të ligjit apo statutit, të kryhen me saktësi nga ana e administratorëve. Këto dokumente duhet të miratohen e të nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e këshillit të administrimit për t'iu paraqitur asamblesë së përgjithshme, së bashku me një raport të këshillit të administrimit për miratim dhe një përshkrim për mbikëqyrjen e menaxhimit gjatë të gjithë vitit financiar. Gjithashtu, këshilli duhet të sigurojë se, auditimi i librave dhe i regjistrimeve kontabël të kryhet të paktën një herë në vit nga një ekspert kontabël i autorizuar, i pavarur, e raporti i auditimit, drejtuar asamblesë së përgjithshme, t'u vihet në dispozicion të gjithë anëtarëve të këshillit e administratorëve. Këshilli i administrimit, ka kompetencë që të emërojë dhe të shkarkojë administratorët, të ndajë kompetencat ndërmjet tyre, të përcaktojë shpërblimin e administratorëve, të miratojë marrjen përsipër të detyrimeve me vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, si dhe të kryejë veprimet e tjera, të përcaktuara në ligj dhe në statut. Në rastet e parashikuara me ligj, këshilli i administrimit duhet të thërrasë menjëherë asamblenë e përgjithshme, edhe në rastet tjera të parapara me ligj¹⁶³, për të shqyrtuar nëse shoqëria duhet të priset ose për marrjen e masave të tjera të nevojshme e të përshtatshme¹⁶⁴.

Këshilli i administrimit përbëhet nga të paktën tre apo një numër më i madh, por jo më shumë se 21 anëtarë. Anëtarët e këshillit të administrimit janë individë-persona fizik, shumica e të cilëve duhet të jenë të pavarur dhe të ndryshëm nga administratorët e

¹⁶³ Shih nenin 136 par.3-5 të, i Ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare i Shqipërisë..

¹⁶⁴Po Aty, Neni 154.

shoqërisë. Anëtarët e këshillit të administrimit zgjidhen nga asambleja e përgjithshme, duke zbatuar afatin-mandatin e emërimit të përcaktuar në statut, i cili afat, nuk mund të jetë më i gjatë se 3 vjet dhe të njëjtit mund edhe të rizgjidhen. Statuti mund të parashikojë që aksionarët, të cilët zotërojnë së bashku një numër aksionesh, që përfaqësojnë të paktën 5% ose një vlerë më të vogël të kapitalit të regjistruar, të kenë të drejtën të emërojnë një anëtar të këshillit të administrimit me një vendim të posaçëm. Me këtë përcaktim ligjor, ligjvënësi shqiptar ka siguruar kushte për mundësinë e përfaqësimit të aksionarëve minoren-të vegjël, në këshillin e administrimit. Në këtë punim është shpjeguar fakti se juridiksionet e tjera, mundësinë e aksionarëve minoren për emërimin e drejtorëve e kanë rregulluar me të drejtën e “*votimit kumulativ*” për drejtor, gjë e cila nuk është paraparë në juridiksionin shqiptar. Anëtarët e zgjedhur në këtë mënyrë nuk mund ta rrisin numrin e anëtarëve të këshillit të administrimit mbi numrin maksimal prej 21 anëtarësh. Anëtarë të pavarur të këshillit të administrimit vlerësohen personat, të cilët nuk kanë konflikt interesash, sipas përcaktimeve të caktuara me ligji dhe kriteret për vlerësimin e kësaj pavarësie janë të përafërta me juridiksionet e krahasuara.¹⁶⁵

5.2.1.2. *Zgjedhshmëria e kufizuar.* - Anëtarët e Këshillit të administrimit mund të zgjidhen nga radhët e aksionarëve dhe punëmarrësve të shoqërisë tregtare, si edhe nga radhët e individëve të tjerë, jashtë shoqërisë. Një individ nuk mund të zgjidhet si anëtar i Këshillit të administrimit, nëse ai, njëkohësisht, është anëtar i Këshillit të administrimit ose i Këshillit mbikëqyrës në 2 shoqëri të tjera, të regjistruara në Republikën e

¹⁶⁵ Neni 155, i Ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare i Shqipërisë.

Shqipërisë. Çdo emërim, i bërë në kundërshtim me ndalesat e mësipërme, është absolutisht i pavlefshëm. Individët, që kandidojnë për t'u emëruar si anëtarë të këshillit të administrimit detyrohen të informojnë menjëherë shoqërinë për çdo konflikt interesi e anëtarësie në këshillat e shoqërive të tjera.¹⁶⁶

5.2.1.3. *Shkarkimi.* - Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë, në çdo kohë, një anëtar të këshillit të administrimit, me shumicë të thjeshtë votash. Kjo e drejtë dhe mundësi e asamblesë së përgjithëshme, nuk mund të përjashtohet nga statuti apo me marrëveshje. Paditë që lidhen me shpërblimin e anëtarit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi. Është me rëndësi të theksohet fakti se, nëtari i këshillit të administrimit, i cili është zgjedhur nga aksionarët minoritar, të cilët së bashku zotërojnë një numër të aksioneve, që përfaqësojnë të paktën 5% të kapitalit¹⁶⁷, mund të shkarkohet vetëm me vendim të aksionarëve të pakicës, që e ka zgjedhur. Në rastin kur kushtet e parashikuara në statut për këtë emërim të veçantë nuk janë më në fuqi, asambleja e përgjithshme mund ta shkarkojë anëtarin në fjalë me shumicë të thjeshtë votash. Këshilli i administrimit, me shumicë të thjeshtë votash, mund t'i kërkojë gjykatës përkatëse të shkarkojë një anëtar, nëse ai ka shkelur detyrimin e tij për besnikëri ndaj shoqërisë.¹⁶⁸

5.2.1.4. *Administratorët.* - Këshilli i administrimit emëron një ose më shumë persona

¹⁶⁶ Neni 156, i Ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare i Shqipërisë.

¹⁶⁷ Për mundësinë e zgjedhjes së anëtarit të këshillit nga aksionarët minoritarë, të cilët zotërojnë aksione prej 5% ose një vlerë më të vogël, shih neni 155 par.5 të Ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare i Shqipërisë.

¹⁶⁸ Po Aty, Neni 157.

fizikë si administratorë të shoqërisë, për një afat të përcaktuar në statut, i cili nuk mund të jetë më i gjatë se tri vjet, dhe pas kalimit të këtij afati mund edhe të rizgjidhet. Anëtarët e këshillit të administrimit mund ta kryejnë detyrën e administratorit për sa kohë shumica e anëtarëve të këshillit të administrimit janë anëtarë të pavarur, që nuk kryejnë këtë detyrë. Emërimi prodhon pasoja, vetëm pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe të drejtat e të tretëve mbrohen në mënyrën e përcaktuar me ligj.¹⁶⁹

Administratorët kanë të drejtë dhe detyrohen që të kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë. Me këtë kuptohet se ata duhet të përfaqësojnë shoqërinë tregtare, të kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë, të përgatisin dhe të nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë, të cilët ia paraqesin këshillit të administrimit për miratim, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve për t'u paraqitur më pas për miratim nga asambleja e përgjithshme. Administratorët, gjithashtu, përkujdesen që të krijojnë një sistem monitorimi e njoftimi preventiv për rrethanat që kërcënojnë ekzistencën e shoqërisë. Dhe në fund, administratorët përkujdesen që të kryejnë regjistrimet e publikimet e detyrueshme të të dhënave të shoqërisë, t'i japin informacione kryetarit të këshillit të administrimit¹⁷⁰. Këshilli i administrimit mund t'i shkarkojë administratorët në çdo kohë. Paditë, që lidhen me shpërblimin e anëtarit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore

¹⁶⁹ Për mënyrën e mbrojtjes së të drejtave të të tretëve, shih neni 12 i LTSHTSH.

¹⁷⁰ Për detyrimin e posaçëm që administratorët të njoftojnë kryetarin e këshillit të administrimit, shih neni 136 par 3-5 të, i Ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare i Shqipërisë.

me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.¹⁷¹

5.2.1.5. Përfaqësimi. - Kufizimet e tagrave të përfaqësimit të administratorëve mund t'u barten palëve të treta, në përputhje me dispozitat e Ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare. Administratorët, të cilët kanë të drejtë ta përfaqësojnë shoqërinë tregtare në mënyrë të përbashkët, mund të autorizojnë disa prej tyre për kryerjen e disa veprimeve të caktuara apo për kryerjen e disa kategorive të caktuara veprimesh. Njoftimet e drejtuara secilit prej administratorëve, janë të vlefshme dhe detyruese për shoqërinë. Tagrat e përfaqësimit të administratorëve dhe çdo ndryshim i tyre, regjistrohen pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit¹⁷².

5.2.1.6. Shpërblimi. - Anëtarët e këshillit të administrimit mund të përfitojnë pagë bazë e shpërblime shtesë, përfshirë këtu pjesë nga fitimi i shoqërisë apo të drejta opsioni mbi aksionet e shoqërisë. Paga e administratorëve mund të shtohet edhe me shpërblime shtesë. Skema e këtyre shpërblimeve përgatitet nga Këshilli i administrimit dhe miratohet nga Asambleja e përgjithshme. Në përputhje me skemën e përmendur dhe me gjendjen financiare të shoqërisë, shpërblimet individuale përcaktohen nga Këshilli i administrimit dhe duhet të pasqyrojnë, në mënyrë të përshtatshme, ndarjen e detyrave ndërmjet anëtarëve, që mbajnë detyrën e administratorëve dhe anëtarëve të pavarur, që nuk janë administratorë. Nëse shoqëria është në vështirësi financiare, asambleja e përgjithshme mund të vendosë reduktimin, në masën e përshtatshme, të shpërblimeve të përmendura. Skema e shpërblimeve e përmendur si dhe shpërblimet individuale, që u jepen administratorëve e anëtarëve të pavarur, që nuk janë administratorë, së bashku me

¹⁷¹Po Aty, Neni 158.

¹⁷² Neni 159, i Ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare i Shqipërisë.

një raport për efektin vjetor të këtyre skemave mbi pasurinë e shoqërisë, publikohet së bashku me pasqyrat financiare vjetore.¹⁷³

5.2.1.7. Rregulloret, kryetari dhe komitetet e posaçme. - Statuti ose këshilli i administrimit mund të përcaktojë rregullore për procedurën e funksionimit të mbledhjeve të këshillit, si dhe të marrjes së vendimeve. Vendimet e këshillit të administrimit, për këto rregullore, merren në mënyrë unanime. Këshilli i administrimit duhet ta zgjedhë kryetarin dhe nënkryetarin e tij në përputhje me dispozitat e statutit, kurse një administrator nuk mund të zgjidhet kryetar i këshillit të administrimit. Zhvillimi i mbledhjeve të këshillit të administrimit regjistrohet në një procesverbal, i cili nënshkruhet nga kryetari. Procesverbali përmban vendin dhe datën e takimit, emrat e pjesëmarrësve, rendin e ditës, një përshkrim për çështjet e diskutuara si dhe vendimet e aprovuara. Parregullsitë për mbajtjen e procesverbalit nuk kanë si pasojë pavlefshmërinë e vendimeve të aprovuara. Këshilli i administrimit mund të krijojë komitete të posaçme, të përbëra nga anëtarët e vet, për të përgatitur mbledhjet apo vendimet ose për të mbikëqyrur vënien në zbatim të vendimeve të këshillit, sidomos ato të lidhura me veprimtarinë e administratorëve, shpërblimin e tyre dhe auditimin e librave e të regjistrimeve kontabël. Secili komitet duhet të përbëhet në shumicën e vet nga anëtarë të pavarur, që nuk janë administratorë.¹⁷⁴

5.2.1.8. Marrja e vendimeve. - Vendimet e këshillit të administrimit vlerësohen të vlefshme, nëse në procesin e vendimmarrjeve janë të pranishëm më shumë se një e dyta

¹⁷³Neni 160, i Ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare i Shqipërisë.

¹⁷⁴Po Aty, Neni 161.

e anëtarëve. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në statut, vendimet merren me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm dhe kur për një çështje ka barazim votash, vota e kryetarit mbizotëron. Vendimet e këshillit të administrimit mund të merren sipas përcaktimeve të statutit apo të rregulloreve të këshillit, duke shprehur votën me shkresë, me telefon apo me mjete të tjera të komunikimit elektronik, me përjashtim të rasteve kur një anëtar i këshillit ka kundërshtime për këtë mënyrë vendimmarrjeje. Përjashtimet nga e drejta e votës zbatohen edhe për anëtarët e këshillit të administrimit.¹⁷⁵

5.2.1.9. Detyrimi i besnikërisë dhe përgjegjësia. - Detyrimi i aksionarëve, që me veprimet e tyre të mbrojnë interesat e shoqërisë, vlen edhe për administratorët, anëtarët e këshillit të administrimit apo të këshillit mbikëqyrës. Këta persona kanë për detyrim që të informojnë me kohë aksionarët, dhe përgjigjen për të gjitha abuzimet me detyrën dhe pronën e shoqërisë. Ata kanë për obligim që të përmbahen nga veprimet konkurrencte ndaj shoqërisë, si dhe të mbrojnë apo ruajnë sekretin tregtar të shoqërisë.¹⁷⁶ Për të vepruar duke qëndruar besnik ndaj shoqërisë, administratorët duhet të kryejnë të gjitha detyrat e tyre të përcaktuara në ligj ose në statut, në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë. Kështu, administratorët me rastin e çdo veprimi duhet që të vlerësojnë në mënyrë të përshtatshme çështjet, për të cilat merret vendim, duke parandaluar dhe mënjeluar rastet e konfliktit të interesit, të pranishëm apo të mundshëm

¹⁷⁵ Neni 162, i Ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare i Shqipërisë.

¹⁷⁶ Më hollsisht për detyrimin e administratorëve, anëtarëve të këshillit të administrimit apo këshillit mbikëqyrës, shih nenet 14-18, e Ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare i Shqipërisë.

dhe detyrat e tyre t'i ushtrojnë me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

Administratorët dhe anëtarët e këshillit të administrimit përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, gjatë kryerjes së detyrave të tyre, me përjashtim të rasteve kur veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim, në bazë të hetimit e vlerësimit të mjaftueshëm të informacioneve dhe lidhet, në mënyrë të arsyeshme, me qëllimet e shoqërisë tregtare. Administratorët apo anëtarët e këshillit të administrimit, që veprojnë në kundërshtim me detyrat dhe shkelin standardet e kujdesit, janë të detyruar t'i shpërblejnë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga shkeljet, si dhe t'i kalojnë çdo fitim personal që, ata apo personat e lidhur me ta, kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratorët apo anëtarët e këshillit të administrimit kanë barrën e provës, për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt, sipas standardeve të kërkuara.

5.2.1.10. Detyrimi për t'u përgjigjur në kërkesat për mbikëqyrje të veçantë.

- Aksionarët, të cilët përfaqësojnë të paktën 5% të kapitalit bazë ose një përqindje më të vogël, të parashikuar në statut, apo kreditorët e shoqërisë, pretendimet e të cilëve ndaj saj janë të paktën sa 5% i kapitalit të regjistruar, mund t'i kërkojnë këshillit të administrimit të kryejë mbikëqyrje të veçantë¹⁷⁷ për çështje të posaçme, sidomos kur merret në shqyrtim ligjshmëria e veprimeve të administratorëve. Nëse këshilli i administrimit nuk e përmbush kërkesën e përmendur brenda 30 ditëve, aksionarët dhe

¹⁷⁷ Neni 165, i Ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare i Shqipërisë.

kreditorët në fjalë mund të nisin procedurën për hetim të posaçëm¹⁷⁸.

5.2.2. Administrimi i korporatës me dy nivele të qeverisjes

Nëse themeluesit e korporatës (shoqërisë aksionare-SH.A.) përcaktohen për administrimin e korporatës me dy nivele, atëherë korporata do të ketë edhe strukturën organizative të sajë, të shprehur në dy nivele. Në një rast të tillë, struktura organizative e korporatës do të përbëhet nga Këshilli mbikëqyrës dhe nga administratorët. Në këtë rast, këshilli mbikëqyrës do të jetë organ në cilësi të organit mbikëqyrës, i cili do të merret me mbikëqyrjen ose vënien në zbatim të këtyre politikave dhe përputhjen e tyre me ligjin dhe statutin.¹⁷⁹ Administratorët, sipas këtij organizimi merren me kryerjen e punëve ekzekutive të korporatës, duke drejtuar shoqërinë dhe duke marrë vendime për mënyrën e vënies në zbatim të politikave tregtare.

5.2.2.1. Administratorët dhe Këshilli mbikëqyrës - Kompetencat. - Në sistemin e administrimit me dy nivele, administratorët drejtojnë shoqërinë dhe marrin vendime për mënyrën e vënies në zbatim të politikave tregtare, ndërsa këshilli mbikëqyrës, në cilësinë e organit mbikëqyrës, përcjellë vënien në zbatim të këtyre politikave dhe përputhjen e tyre me ligjin dhe statutin. Në përputhje me rregullin e përgjithshëm për ndarjen e kompetencave dhe të funksioneve të përmendura, rregullat lidhur me të drejtat dhe detyrimet, numrin, emërimin dhe përbërjen, zgjedhshmërinë e kufizuar, shkarkimin, administratorët, përfaqësimin, shpërblimin, rregulloret, kryetarin dhe komitetet e

¹⁷⁸ Lidhur me procedurën për hetim të posaçëm për parregullsitë për veprimet e themelimit të shoqërisë dhe të ushtrimit të veprimtarisë tregtare, më hollsisht shih nenin 150, i Ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare i Shqipërisë.

¹⁷⁹ Neni 166 par.1, i Ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare i Shqipërisë.

posaçme, marrjen e vendimeve, detyrimin për besnikëri dhe përgjegjësinë, përgjegjësinë solidare dhe kërkesën për mbrojtje të veçantë, të cilat zbatohen në organizimin e administrimit me një nivel, është përcaktuar në dispozita ligjore në nenet 154-165 të Ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare të Shqipërisë¹⁸⁰, e të cilat zbatohen drejtpërsëdrejti edhe për marrëdhëniet ndërmjet administratorëve dhe anëtarëve të këshillit mbikëqyrës, ku funksionet e këtij këshilli u korrespondojnë funksioneve mbikëqyrëse të këshillit të administrimit.¹⁸¹

5.2.2.2. Përbërja, detyrimet dhe të drejtat e këshillit mbikëqyrës dhe administratorëve.

- Këshilli mbikëqyrës është përgjegjës për të gjitha funksionet mbikëqyrëse të shoqërisë. Administratorët mund të emërohen dhe shkarkohen, nga asambleja e përgjithshme apo nga këshilli mbikëqyrës i shoqërisë. Veprimet e administratorëve u nënshtrohen miratimit nga këshilli mbikëqyrës, vetëm nëse kjo parashikohet shprehimisht në statut. Nuk mund të zgjidhen anëtarë të këshillit mbikëqyrës, administratorët e shoqërisë, administratorët e shoqërive të tjera të të njëjtit grup, si dhe personat e lidhur me personat e mësipërm, të cilët kanë konflikt interesi¹⁸². Përcaktimi lidhur me numrin, emërimin, përbërjen dhe shkarkimin e anëtarëve të këshillit mbikëqyrës¹⁸³, vlejnë po ato të cilat janë përmendur për këshillin e administrimit. Anëtarët e këshillit mbikëqyrës, nuk kanë të drejtë që të kryejnë funksione administrimi dhe shumica e tyre duhet të jenë anëtarë të

¹⁸⁰ Po Aty, Shih nenet 154-165.

¹⁸¹ Neni 166, i Ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare i Shqipërisë.

¹⁸² Lidhur me konfliktin e interesit, personat e lidhur dhe ndalimin për t'u zgjedhur në organet e administrimit të shoqërisë, shih neni 13, i Ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare i Shqipërisë.

¹⁸³ Po Aty, Shih nenet 155-157.

pavarur. Me qëllim të sigurimit të pjesëmarrjes së punëtorëve në qeverisjen korporative, statuti i shoqërisë, mund të parashikojë që disa prej anëtarëve të këshillit mbikëqyrës mund të zgjidhen dhe shkarkohen nga punëmarrësit e shoqërisë. Edhe rregullat për shpërblimin, organizimin e brendshëm dhe marrjen e vendimeve nga këshilli mbikëqyrës, janë të ngjashme me ato të përmendura për këshillin e administrimit.

Si rrjedhojë e kësaj, anëtarët e këshillit mbikëqyrës përgjigjen për dëmet e shkaktuara nga shkelja e detyrave të tyre dhe mos përmbushjes së standardit të kujdesit, të përcaktuara si për anëtarët e këshillit të administrimit. Për shkeljet e kryera nga administratorët, anëtarët e këshillit mbikëqyrës janë përgjegjës, nëse për këto shkelje nuk njoftojnë asamblenë e përgjithshme, edhe pse kanë pasur dijeni për shkeljet e kryera. Gjithashtu, anëtarët e këshillit mbikëqyrës do të jenë përgjegjës, nëse nuk kanë zbuluar se funksioni i mbikëqyrjes, sipas kërkesave të ligjit, nuk është kryer në mënyrë korrekte e sipas standardeve të kërkuara.¹⁸⁴

5.2.2.3. *Detyra për besnikëri dhe parimi i detyrimit të besnikërisë.* - Detyrimi për besnikëri, i cili vlen për ortakët dhe aksionarët, duke marrë parasysh interesat e shoqërisë dhe të ortakëve apo të aksionarëve të tjerë, e i cili vlen edhe për administratorët dhe anëtarët e këshillit të administrimit, po ashtu vlen edhe për anëtarët e këshillit mbikëqyrës.¹⁸⁵

Njëra ndër kërkesat për detyrimin për besnikëri, është edhe kërkesa e anëtarëve të këshillit mbikëqyrës ose administratorëve për ta mbajtur Sekretin tregtar. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga ligje të posaçme, aksionarët padinë

¹⁸⁴ Neni 176 i Ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare i Shqipërisë.

¹⁸⁵ Po aty, Neni 14.

për ushtrimin e të drejtave të shoqërisë duhet ta ngrenë brenda tri viteve, nga data e kryerjes së shkeljes së pretenduar. Për ngritjen e padisë ndaj personave të sipërpërmendur zbatohen, gjithashtu, dispozitat LTSHTK-së, të përmendura për këtë qëllim, në pjesën kur është folur për përgjegjësinë e këshillit të administrimit.¹⁸⁶

5.2.2.4. *Detyrimi për përmbushjen e të drejtës së aksionarëve për informim.* - Personat përgjegjës për administrimin e shoqërisë informojnë të gjithë aksionarët për ecurinë e veprimtarisë së shoqërisë tregtare dhe me kërkesën e tyre duhet t'u vënë në dispozicion llogaritë vjetore, përfshirë llogaritë e konsoliduara, raportet për gjendjen dhe ecurinë e veprimtarisë së shoqërisë tregtare, raportet e organeve drejtuese apo të ekspertëve kontabël të autorizuar, si dhe çdo dokument tjetër të brendshëm të shoqërisë.

Ky detyrim mund të përmbushet edhe duke e vendosur këtë informacion në faqen e internetit të shoqërisë tregtare dhe duke informuar për këto të dhëna, të gjithë ata persona të cilët e bëjnë kërkesën dhe kanë të drejtën për qasje në të dhënat e përmendura. Në të kundërtën, këto dokumente duhet të vihen në dispozicion, për shqyrtim, pranë zyrës qendrore të shoqërisë tregtare, kurse çdo dispozitë e statutit, që ndalon ose kufizon ushtrimin e të drejtave të përmendura, është e pavlefshme.

Nëse personat përgjegjës për administrimin e shoqërisë nuk japin informacionin e kërkuar, aksionarët e interesuar, brenda 30 ditëve pas refuzimit, mund t'i kërkojnë gjykatës kompetente të urdhërojnë përmbaruesit gjyqësorë të ekzekutojnë kërkesën e aksionarit, duke i dorëzuar këtyre të fundit informacionin dhe dokumentet që personat përgjegjës për administrimin e shoqërisë nuk kanë dhënë. Konsiderohet se të dhënat e kërkuara nuk janë ofruar, nëse të njëjtat nuk janë prezantuar dhe dhënë, “brenda shtatë

¹⁸⁶ Për më saktësisht, po aty, shih neni 10 par.3.

ditëve nga data e marrjes dijeni për kërkesën, vlerësohet refuzim”.¹⁸⁷

5.2.2.5. Përgjegjësia për abuzimin me detyrën dhe formën e shoqërisë. - Ashtu si që përgjigjen aksionarët e shoqërisë tregtare edhe administratorët dhe anëtarët e këshillit të administrimit, që kryejnë një apo më shumë nga veprimet ose mosveprimet e përmendura në këtë kapitull, përgjigjen personalisht e në mënyrë solidare për detyrimet e shoqërisë, me të gjithë pasurinë e tyre. Veprimet ose mosveprimet për të cilat përgjigjen anëtarët e këshillit mbikëqyrës, kryesisht kanë të bëjnë me: abuzimin me formën e shoqërisë tregtare për arritjen e qëllimeve të paligjshme, nëse i trajtojnë pasuritë e shoqërisë tregtare si të ishin pasuritë e tyre. Administratorët dhe anëtarët e këshillit të administrimit, gjithashtu, do të japin llogari edhe çdoherë kur kanë marrë apo duhet të kishin marrë dijeni për gjendjen e paaftësisë paguese të shoqërisë dhe nuk marrin masat e nevojshme, për të siguruar që shoqëria të ketë kapitale të mjaftueshme, për të përmbushur detyrimet e marra përsipër ndaj palëve të treta. Palët e treta nuk mund të ngrenë padi për përmbushjen e detyrimeve të përmendura, nëse administratorët ose këshilli mbikëqyrës provojnë se i treti kishte pasur dijeni për abuzimin e bërë nga ana e administratorëve ose anëtarëve të këshillit mbikëqyrës, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për sjellje të tilla.¹⁸⁸

5.2.2.6. Ndalimi i konkurrencës. - Ashtu si edhe në juridiksionet e krahasuara, edhe në Shqipëri, administratorët dhe anëtarët e këshillit të administrimit të një shoqërie aksionare nuk mund të mbajnë një pozicion drejtues apo të jenë të punësuar në shoqëri

¹⁸⁷ Neni 15 i Ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare i Shqipërisë.

¹⁸⁸ Neni 17 i Ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare i Shqipërisë.

të tjera, që ushtrojnë veprimtari në të njëjtin sektor ekonomik me shoqërinë ku veprojnë. Gjithashtu, këta persona nuk mund të mbajnë as statusin e tregtarit të pavarur, i cili ushtron veprimtari në këtë sektor.

Përfundimisht, me statutin e shoqërisë mund të parashikohet që ndalimi i përmendur të shfuqizohet nëpërmjet një autorizimi të posaçëm. Autorizimi i përmendur, duhet të jetë i dhënë nga asambleja e përgjithshme dhe i duhet të aprovohet me tre të katërtat e votave.

Me statut mund të parashikohet që ndalimi i përmendur, mundë të prodhojë efekte juridike edhe pas humbjes së cilësive apo statusit të administratorit apo anëtarit të këshillit mbikëqyrës, por jo për një periudhë më të gjatë se një vit pas humbjes së kësaj cilësie. Nëse ndonjëri prej personave të përmendur shkel ndalimin e konkurrencës, shoqëria mund të përjashtojë administratorët dhe anëtarët e këshillit të administrimit nga shoqëria apo ta shkarkojë nga detyra, të kërkojë ndërprerjen e veprimtarisë konkurruese ose të ngrejë padi për shpërblimin e dëmit. Shoqëria tregtare ose korporata, si alternativë të ngritjes së padisë për shpërblimin e dëmit mund t'i kërkojë secilit prej personave të përmendur, që: të pranojë se transaksionet e kryera për llogari të tij të kalohen për llogari të shoqërisë, t'i transferojë shoqërisë të gjitha përfitimet që ka marrë nga kryerja e veprimeve për llogari të personave të tretë, përkatësisht t'i transferojë shoqërisë të gjitha të drejtat e kreditë, që kanë rrjedhur nga kryerja e veprimeve për llogari të personave të tretë. Për ngritjen e padisë ndaj personave të sipërpërmendur zbatohen, gjithashtu, dispozita nga neni 10 parg.3 e LTSHTSH.¹⁸⁹

¹⁸⁹ Neni 10 i Ligjit për Tregtarët dhe shoqëritë tregtare i Shqipërisë.

5.3. Këshilli i Administrimit/Këshilli Mbikëqyrës dhe administratorët dhe roli i tyre në qeverisjen e korporatave në Kroaci

Edhe Ligji për shoqëritë tregtare i Republikës së Kroacisë, ashtu si edhe shumë ligje të tjera bashkëkohore, nën ndikimin e principeve të OECD-së dhe Direktivave të UE-së¹⁹⁰, lidhur me formën e organizimit të administrimit të korporatave, është përcaktuar në at mënyrë që, ka lënë mundësinë e administrimit të korporatave me dy nivele dhe me një nivel. Si kemi theksuar më sipër, sipas legjislacionit kroat, korporata konsiderohen shoqëritë aksionare (SH.A.) dhe shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar (SH.P.K.). Për këtë arsye, kjo formë e vendosjes ose përcaktimit lidhur me organizimin e administrimit, është e paraparë, si për shoqëritë aksionare, ashtu dhe për shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar. Si rrjedhojë e kësaj, në këtë punim kemi trajtuar të dy format e organizimit të administrimit të korporatave në Kroaci. Forma e parë (*administrimi me dy nivele-two-tier board*) është rregulluar me dispozitat ligjore nga neni 239-272 të LSHTKR, kurse forma e dytë e organizimit (*administrimi me një nivel-unitary board*) është rregulluar me dispozitat ligjore nga neni 272.a-272.p, të LSHTKR.¹⁹¹

5.3.1. Administrimi i korporatës me një nivel të qeverisjes

Ashtu si është thënë për legjislacionin shqiptar, gjithashtu edhe sipas ndryshimeve të Ligjit për shoqëritë tregtare në Kroaci, aksionarëve-pronarëve të korporatave, u është lënë në dispozicion mundësia e vendosjes vullnetare, lidhur me

¹⁹⁰ Direktiva e UE-së për statutin e shoqërisë aksionare europiane (SE) nr.2157/2001 e datës 8 tetor 2001, ka paraparë konceptin dualistik të të shoqërisë në nenet 39-42 dhe konceptin monist në nenet 43-45, kurse në nenet 46-51 përmbanë dispozita të përbashkëta për zbatim në të dyja konceptet.

¹⁹¹ Për më tepër, shih nenet 239-272 dhe 272.a-272.p, i Ligjit për shoqëritë tregtare i Kroacisë.

faktin se a do të përcaktohen për organizimin e administratës me dy nivele të qeverisjes apo për organizimin e administratës me një nivel të qeverisjes. Në rastin e organizimit të administratës me një nivel, në korporatë nuk organizohet Këshilli mbikëqyrës. Në këtë formë të organizimit si organ kryesor i administrimit të korporatës, është Këshilli drejtues (*Upravni odbor*)¹⁹². Organizimi i korporatës me një nivel të qeverisjes korporative është risi në praktikën korporative kroate, e cila është paraqitur me ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shoqëritë tregtare, nr.207/2007, i cili ka hyrë në fuqi nga data 01.04.2008¹⁹³. Këshilli drejtues është organ ekzekutiv në raport me themeluesit-aksionarët, të cilët janë të organizuar në asamblenë e përgjithshme, por njëkohësisht ky organ ushtron rolin e organit mbikëqyrës në raport me Drejtorët ekzekutiv (*Izvršni direktori*)¹⁹⁴. Në këtë formë të organizimit, nuk ka ndarje strikte të kompetencave të mbikëqyrjes nga ato ekzekutive¹⁹⁵.

5.3.1.1. *Drejtoria (Uprava)*¹⁹⁶. - Drejtorinë e emëron kuvendi i shoqërisë dhe përbëhet nga një ose më shumë persona (drejtor), numri i të cilëve është i caktuar me statut. Në kuadër të drejtorisë, në mënyrë funksionale janë të ndarë anëtarët, të cilët udhëheqin

¹⁹² Emërtimi, Upravni odbor në gjuhën në gjuhën kroate, i përgjigjet emërimit:Këshilli drejtues në gjuhën shqipe. Nga:Uprava-drejtori dhe Odbor-Këshill. (Përkthim i autorit).

¹⁹³ Shoqëritë tregtare, të cilat të parat aplikuan modelin monist të qeverisjes korporative, ishin: shoqëria tregtare Arena Turist, sh.a. Pulë, Dina-Petrokemija në Omish etj. Për më tepër shih Monistički ustroj tijela dioničkog društva – hrvatska praksa (Rregullimi monist i organeve të shoqërisë aksionare-praktika kroate) Ljiljana Maurović, Marli Gonan Božac & Sabina Grgorinić - UDK. 347.725.036(497.5)

¹⁹⁴ Emërtimi, Izvršni direktori në gjuhën kroate, i përgjigjet emërimit:Drejtorët ekzekutiv në gjuhën shqipe. Nga:Izvršni-ekzekutiv dhe direktori-drejtorët. (Përkthim i autorit)

¹⁹⁵ Për më tepër shih, Barbić, J., Op. cit.fq. 425.

¹⁹⁶ Uprava në gjuhën Kroate është emërtim për drejtorinë e korporatës.

punët e shoqërisë (menaxherët ose drejtorët ekzekutiv), nga anëtarët të cilët kryejnë funksionin mbikëqyrës (drejtorët jo ekzekutiv)¹⁹⁷. Nëse administrata përbëhet nga më shumë se një person, njëri prej tyre duhet të emërohet për kryetar. Për anëtar të drejtorisë mund të emërohet personi i cili ka zotësinë e plotë afariste, kurse me statut mund të caktohen kushtet tjera te veçanta, për emërimin e anëtarëve të administratës¹⁹⁸. Ashtu siç është shpjeguar më lartë, në kuadër të të drejtës së aksionarëve për emërimin e drejtorëve; drejtor i drejtorisë nuk mund të jetë personi¹⁹⁹ i cili: është i dënuar për vepër penale, keqpërdorimi i likuidimit, keqpërdorimi i procedurës së likuidimit, dëmtimi i kreditorëve ose cenimi i detyrimit për udhëheqjen e librave tregtare dhe afariste. Personi i tillë nuk do të mund të emërohet në këtë funksion, në afat prej pesë vite pas plotfuqishmërisë së aktgjyqimit me të cilën është gjykuar. Për ushtrimin e kësaj detyre nuk do të mund të emërohet as personi, kundër të cilit është shqiptuar masa e sigurisë ndalim i ushtrimit të veprimtarisë, e cila në tërësi ose pjesërisht është e përfshirë me lëndën e afarizmit të shoqërive, për kohën deri sa zgjat kjo ndalesë²⁰⁰. Në këtë kuptim, pajtohem me mendimin e autorit Barbic Jakša, sipas të cilit qëllimi i ndalesave të përmendura nuk ka të bëjë vetëm me mbrojtjen e interesave të aksionarëve, por edhe me mbrojtjen e interesave të përgjithshme, në mënyrë që udhëheqja e punëve të shoqërisë të mos u besohet personave me të kaluar kriminale, pasi që ata do të mund të

¹⁹⁷ Për më tepër shih, Barbic. Op. cit.fq. 426.

¹⁹⁸ Lidhir me kushtet e diomosdoshme për emrimin e drejtorëve ose anëtarëve të këshillit drejtues, shih Barbic Jakša, op. cit. fq.435.

¹⁹⁹ Arsyet dhe kuptimi i qëndrimit të tillë, më hollësisht është shpjeguar në kapitullion IV, të këtij punimi, pika 4.1, fq.66-68.

²⁰⁰ Neni 239, i Ligjit për shoqëritë tregtare i Kroacisë.

ndërmernin veprime me të cilat do të dëmtonin edhe personat jashtë shoqërisë.²⁰¹

5.3.1.2. Kompetencat e drejtorisë në udhëheqjen e punëve të shoqërisë. - Drejtoria udhëheqë punët e shoqërisë në përgjegjësi të saj. Nëse drejtoria përbëhet prej disa personave, anëtarët e drejtorisë janë të autorizuar që punët t'i udhëheqin vetëm bashkërisht. Nëse votat gjatë vendosjes janë ndarë në mënyrë të barabartë, kurse kjo situatë nuk është përcaktuar ndryshe me statut, vota vendosëse është vota e kryetarit të drejtorisë²⁰².

5.3.1.3. Kompetencat e drejtorisë për përfaqësimin e korporatës. - Drejtoria e përfaqëson shoqërinë. Për të ushtruar këto kompetenca dhe autorizime, drejtoria fillimisht është e autorizuar që të ndërmerr veprimet juridike të përfaqësimit në punët para gjykatave dhe organeve tjera të pushtetit. Nëse drejtoria përbëhet nga shumë persona, kurse me statut nuk është rregulluar specifikisht se si e kryejnë drejtorët veprimtarinë e përfaqësimit, anëtarët e drejtorisë janë të autorizuar që shoqërinë ta përfaqësojnë vetëm bashkërisht. Në rastet kur personat e tretë, kanë interesin që të shprehin vullnetin e caktuar ndaj shoqërisë, është e mjaftueshme që ky vullnet, deklaram ose shprehje tjetër, t'i deklarohet edhe vetëm njërit nga anëtarët e shoqërisë. Me zbatimin e këtij qëndrimi, rezulton se, personat e tretë mjafton që kërkesat dhe pretendimet e tyre ndaj shoqërisë t'ia shprehin njërit nga drejtorët. Me statut mund të parashihet që për përfaqësim të autorizohen anëtarët e caktuar të administratës

²⁰¹ Për më tepër shih Barbić Jakša, op. cit. fq.436.

²⁰² Neni 240 i Ligjit për shoqëritë tregtare i Kroacisë.

personalisht ose së bashku me prokuruesin. Zakonisht në praktikë, emërohet njëri nga anëtarët e këshillit drejtues që ta përfaqësojë shoqërinë. Zgjidhje e tillë praktikohet kryesisht për arsye funksionale dhe praktike. Anëtarët e administratës nënshkruhen në emër të shoqërisë me ç'rast duhet ta theksojnë firmën e shoqërisë dhe cilësinë e tyre si anëtarë të drejtorisë²⁰³. Autorizimi i drejtorisë për të përfaqësuar shoqërinë nuk mund të kufizohet. Anëtarët e drejtorisë, gjithsesi, duhet që në raport me shoqërinë në udhëheqjen e punëve t'u përmbahen kufizimeve, të cilat në kuadër të rregullave u janë dhënë me statut, vendime të bordit mbikëqyrës dhe kuvendit të përgjithshëm dhe rregullores për punën e drejtorisë²⁰⁴. Përpos kompetencave të përmendura, administrata është e detyruar që me kërkesë të kuvendit të përgjithshëm, të përgatis vendimet dhe aktet e përgjithshme, aprovimi i të cilave është në kompetencë të kuvendit të përgjithshëm, të përgatis kontratat, të cilat mund të lidhen vetëm me pëlqim të kuvendit të përgjithshëm dhe të ekzekutojë vendimet të cilat kuvendi i përgjithshëm i ka sjellë në kuadër të autorizimeve të veta²⁰⁵.

5.3.1.4. Këshilli drejtues, zgjedhja dhe emërimi, përbërja dhe kompetencat. - Këshilli drejtues përbëhet së paku nga 3, dhe më së shumti 21 anëtar anëtarë, varësisht nga numri i punëtorëve dhe shuma e kapitalit të deponuar në korporatë. Në të gjitha rastet kur me ligj është e paraparë që në këshillin mbikëqyrës të jetë përfaqësuesi i punëtorëve, atëherë edhe në këshillin drejtues do të ketë përfaqësues të punëtorëve. Sa i përket

²⁰³ Neni 241 i Ligjit për shoqëritë tregtare i Kroacisë.

²⁰⁴ Po aty, Neni 142.

²⁰⁵ Po aty, Neni 243.

numrit të anëtarëve të këshillit drejtues në mënyrë reciproke, aplikohet dispozita, e cila rregullon numrin e anëtarëve të këshillit mbikëqyrës²⁰⁶. Po në këtë mënyrë vlejnë edhe ndalesat, të cilat ndikojnë që një person të mos mund të caktohet në cilësi të anëtarit në këshillin drejtues.

Për më tepër këto ndalesa kryesisht kanë të bëjnë me faktin se, në pozitën e tillë nuk mundë të emërohet, personi i cili është i emëruar në cilësi të anëtarit të drejtorisë së shoqërisë, personi i cili është anëtar i këshillit drejtues ose i këshillit mbikëqyrës në dhjetë shoqëri dhe ndalesa të tjera, të cilat personin e përmendur e bëjnë të jetë i papërshtatshëm për të kryer këtë funksion administrativ²⁰⁷.

Këshilli drejtues e udhëheq shoqërinë, përcakton bazat për zbatimin e lëndës së afarizmit, mbikëqyrë udhëheqjen e punëve të shoqërisë dhe e përfaqëson shoqërinë ndaj drejtorëve ekzekutiv të saj. Kur këshilli drejtues e përfaqëson shoqërinë kundër ndonjë drejtori ekzekutiv, në këtë rast nuk mund të bashkëveprojë asnjëri nga drejtorët ekzekutiv të shoqërisë. Këshilli drejtues është i obliguar ta thërras kuvendin e shoqërisë kur kjo është e nevojshme për të mirën e shoqërisë. Në këto situata, këshilli drejtues bie në vendim me shumicën e thjeshtë të votave. Këshilli drejtues, kryerjen e disa veprimeve lidhur me përgatitjen dhe udhëheqjen e kuvendit të përgjithshëm, mund t'ia besojë drejtorëve ekzekutiv. Këshilli drejtues duhet të kujdeset që librat afariste të shoqërisë, të udhëhiqen në mënyrë të rregullt dhe është i detyruar të marrë masat e duhura për mbikëqyrjen sistematike të çështjeve të shoqërisë, në mënyrë që me kohë të

²⁰⁶ Per me teper, po aty, shih nenin 254.

²⁰⁷ Për më tepër shif nenin 255, i Ligjit për shoqëritë tregtare i Kroacisë.

zbulojë rrethanat që rrezikojnë kompaninë dhe operacionet e sajë²⁰⁸. Këshilli drejtues, përpos të tjerash, ka detyrim ligjor për të lajmëruar me kohë asamblenë e përgjithshme, lidhur me humbjet e shoqërisë, pamundësisë së shoqërisë për pagesë dhe ngarkesës së shoqërisë me borxhe²⁰⁹ dhe të bëjë përpilimin e raporteve vjetore financiare.

5.3.1.5. Mënyra e punës së këshillit drejtues. - Anëtarët e këshillit drejtues, në mënyrën e përcaktuar me statut, nga mesi i tyre zgjedhin kryetarin dhe së paku një zëvendës të kryetarit. Për kryetarin dhe zëvendësin e parë të kryetarit të këshillit drejtues nuk mund të zgjidhet personi, i cili njëkohësisht është drejtor ekzekutiv i shoqërisë. Me statut mundë të përcaktohen disa çështje të punës së Këshillit drejtues, dhe çështjet të cilat përcaktohen me statut e obligojnë Këshillin drejtues.

5.3.1.6. Thirrja e mbledhjeve, pjesëmarrja dhe vendosja në këshillin drejtues. - Për thirrjen e mbledhjeve, pjesëmarrjen në mbledhje dhe formën e vendosjes në mënyrë adekuate, zbatohen dispozitat nga neni 265, 266, dhe 267 LSHTKR. Anëtarët e këshillit drejtues, të cilët janë edhe drejtorë ekzekutivë në shoqëri, nuk bashkëveprojnë në vendimin lidhur me emërimin dhe shkarkimin e drejtorëve ekzekutivë. Prezenca e anëtarëve të këshillit drejtues, të cilët janë drejtorë ekzekutivë nuk merret parasysh me rastin e përcaktimit të kuorumit e as shumicës së nevojshme për marrjen e vendimeve në këto çështje.²¹⁰

²⁰⁸ Për më tepër, po aty, shih nenet 250 a., 250 b. dhe 263 par.2.

²⁰⁹ Për më tepër, po aty, shih nenin 251.

²¹⁰ Për më tepër shih neni 265, 266 dhe 267, i Ligjit për shoqëritë tregtare i Kroacisë.

5.3.1.7. *Drejtorët ekzekutivë, zgjedhja, emërimi dhe kompetencat.* - Këshilli drejtues emëron një ose shumë drejtorë ekzekutivë. Emërimi i drejtorëve ekzekutivë, bëhet në periudhë të mandatuar për kohëzgjatje të mandatit, ashtu si është caktuar me statut. Afati i kohëzgjatjes për emërimin e drejtorëve ekzekutivë, i cili caktohet me statut, maksimalisht mund të jetë gjashtë vite, pasi kjo është kohëzgjatja maksimale e lejuar me ligj. Nëse këshilli drejtues, emëron më shumë se një drejtor, atëherë, njërin nga ata duhet ta emëroj në cilësinë e drejtorit kryesor ekzekutiv, i cili mundë ta ket të emruar edhe zëvendësin e tij. Sa i përket kushteve të nevojshme për t'u emëruar zëvendës i drejtorit ekzekutiv, vlejné të njëjtat kushte dhe kufizime të cilat vlejné për emërimin e zëvendësit të kryetarit të këshillit mbikëqyrës dhe këshillit drejtues. Zëvendës drejtor ekzekutiv mund të emërohen anëtarët e këshillit drejtues, por vetëm atëherë kur shumica e anëtarëve të këshillit drejtues të jenë drejtor joekzekutiv. Emri i zëvendës drejtorit ekzekutiv, gjithsesi duhet të regjistrohet në regjistrin gjyqësor. Nëse për drejtor ekzekutiv emërohen persona, të cilët nuk janë anëtarë të këshillit drejtues, atëherë duhet të plotësojnë kushtet e nevojshme të cilat parashihen për anëtarë të administratës²¹¹.

Me statut mund të parashihen edhe cilësi të tjera të nevojshme për drejtorët ekzekutivë, dhe më për së afërmi të rregullohen mënyra e emërimit nga ana e këshillit drejtues. Drejtorët ekzekutivë udhëheqin punët e shoqërisë. Nëse janë të emëruar më shumë drejtorë ekzekutivë, ata janë të autorizuar që t'i udhëheqin punët e shoqërisë vetëm bashkërisht. Me statut ose rregullore për punën e drejtorëve ekzekutivë, të cilën e sjell këshilli drejtues, mund të përcaktohet edhe mënyrë tjetër e udhëheqjes së punëve të shoqërisë. Autorizimet, të cilat me ligj i janë besuar këshillit drejtues, nuk mund të

²¹¹ Për më tepër shih neni 239 par.2, i Ligjit për shoqëritë tregtare i Kroacisë.

barten tek drejtorët ekzekutivë. Drejtorët ekzekutivë janë të obliguar që regjistrit gjyqësor t'ia paraqesin fletëparaqitjen për regjistrim në regjistrin gjyqësor dhe të paraqesin dokumente tjera, ashtu si është e paraparë për anëtarët e administratës.

Nëse nga llogaritë vjetore ose periodike financiare ose nga vlerësimi i lirë i drejtorëve ekzekutivë, del se shoqëria ka humbje në lartësi të gjysmës së kapitalit themelorë, për këtë deficit, drejtorët ekzekutiv, pa vonesë duhet ta njoftojnë kryetarin e këshillit drejtues. I njëjti detyrim vlen edhe në rastin kur shoqëria mbetet e paaftë për pagesë ose së tepërmi është e ngarkuar me borxhe. Nëse shoqëria ka shumë drejtorë ekzekutivë, ata mundë ta bëjnë rregulloren për punën e tyre, përpos nëse kjo me statut nuk i është lënë këshillit drejtues, ose nëse ky organ e ka aprovuar. Shoqërinë e përfaqësojnë drejtorët ekzekutivë, në mënyrë që, në formë adekuate aplikohen dispozitat që vlejnë për administrator (dispozitat nga neni 241 dhe 242 të LSHTKR). Këshilli drejtues e përfaqëson shoqërinë ndaj drejtorëve ekzekutivë. Drejtorët ekzekutivë mund të nënshkruajnë në emër të shoqërisë, në mënyrë që, përpos emrit të shoqërisë duhet të shënojnë edhe të dhënat me të cilat bëjnë të ditur se nënshkrimin janë duke e bërë drejtorët ekzekutivë të korporatës. Drejtorët ekzekutivë mundë të emërohen edhe nga gjykata²¹².

Një ndër detyrat kryesore të drejtorëve ekzekutivë është përfaqësimi i shoqërisë. Nëse me kontratë nuk është paraparë diçka tjetër, atëherë anëtarët e administratës bashkërisht, përfaqësojnë shoqërinë. Drejtorët ekzekutivë, nënshkruhen në atë mënyrë që së bashku me firmën e shoqërisë të japin edhe nënshkrimin e tyre. Nëse drejtoria ka

²¹² Lidhur me emërimin e drejtorëve ekzekutivë nga ana e gjykatës, shih neni 245, i Ligjit për shoqëritë tregtare, i Kroacisë.

më shumë anëtarë, me kontratë mund të përcaktohet më hollësisht mënyra e përfaqësimit të shoqërisë.²¹³

5.3.2. Administrimi i korporatës me dy nivele të qeverisjes

Nëse themeluesit e korporatës jan përcaktuar për administimin e korporatës me dy nivele të qeverisjes, atëherë korporata do të ketë strukturë organizative, të përbërë nga Administrata (**Uprava**) dhe Këshilli mbikëqyrës (**Nadzorni odbor**). Administrata mund të jetë e përbërë nga një ose më tepër drejtorë, e në rastin kur përbëhet nga më tepër drejtorë, ata së bashku do ta emërojnë kryetarin (**predsjednik**²¹⁴) e administratës. Administrata, sipas këtij organizimi merret me kryerjen e punëve ekzekutive të korporatës. Këshilli mbikëqyrës përbëhet nga më së paku tre anëtarë, kurse numri i tyre parashihet me statut dhe çdoherë duhet të jetë tek²¹⁵.

5.3.2.1. *Kërkesat ligjore për organizimin e domosdoshëm të këshillit mbikëqyrës në SH.P.K.* - Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar, domosdoshmërisht duhet të ketë një këshill mbikëqyrës në këto raste: nëse numri mesatar i të punësuarve në një vit kalendarik kalon 200 të punësuar, në qoftë se është fjala për një kompani e cila kryen një aktivitet specifik të parashikuar me ligj të veçantë, ose nëse kapitali bazë i shoqërisë

²¹³ Për më tepër, po aty, shih nenin 426.

²¹⁴ Predsjednik (në gjuhën kroate), Kryetar (në gjuhën shqipe).

²¹⁵ Shih për këtë; organizimin e korporatës INA d.o.d. Zagreb; “Struktura drejtuese e INA-s bazohet në qeverisjen dualistike-me dy nivele të qeverisjes, e cila përbëhet nga Këshilli mbikëqyrës dhe Drejtoria. Së bashku me Kuvendin e përgjithshëm paraqesin tri trupat e brendshme obligative, në pajtim me statutin dhe Ligjin për shoqëritë tregtare” ; <http://www.ina.hr/default.aspx?id=6435>,

është më i lartë se 600,000.00 kuna²¹⁶ dhe ajo ka më shumë se 50 anëtarë, si dhe raste të tjera të parapara me ligj²¹⁷. Nga kjo, arrijmë në përfundimin se, organizimi i domosdoshëm i këshillit mbikëqyrës, është i paraparë vetëm në rastin e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar. Ndërsa ky kufizim nuk ekziston për shoqëritë aksionare, pasi ato në të gjitha situatat kanë mundësinë që vullnetarisht të përcaktohen për organizimin e administratës me një nivel ose dy nivele. Si rrjedhojë e kësaj, kuptohet se shoqëria aksionare në Kroaci, organizimin e këshillit mbikëqyrës e bën vetëm nëse përcaktohet për organizimin e administratës së shoqërisë me dy nivele.²¹⁸

5.3.2.2. Përbërja dhe kushtet e nevojshme për anëtar të Këshillit mbikëqyrës. - Këshilli mbikëqyrës përbëhet nga më së paku tre anëtarë. Me statut mund të përcaktohet edhe numër më i madh i anëtarëve të këshillit mbikëqyrës²¹⁹. Numri i anëtarëve të këshillit mbikëqyrës, çdoherë duhet të jetë tek. Numri i anëtarëve të këshillit mbikëqyrës të shoqërisë, caktohet varësisht nga lartësia e kapitalit themelor. Numri minimal i tyre duhet të jetë tre anëtar, kurse numri maksimal njëzetënjë anëtar²²⁰. Anëtar i këshillit mbikëqyrës mund të jetë personi fizik, i cili ka zotësinë e plotë afariste. Me statut mund të përcaktohen kushtet, të cilat duhet t'i plotësojë personi për të qenë i emëruar në këshillin mbikëqyrës. Anëtari i këshillit mbikëqyrës mund të jetë edhe personi i cili njëkohësisht është anëtari i drejtorisë së shoqërisë si dhe anëtari i këshillit mbikëqyrës apo administrativ, i cili si i tillë nuk është i emëruar më shumë se në dhjetë shoqëri, si

²¹⁶ Kuna (HRK), monedha kombëtare kroate (1 EUR = 7,5207 HRK)

²¹⁷ Për më tepër shih nenin 434, i Ligjit për shoqëritë tregtare i Kroacisë.

²¹⁸ Shih, Barbić, J., vep. cit. fq.531.

²¹⁹ Hüffer U.(2002). *Aktiengesetz*, München, fq.468.

²²⁰ Shih neni 254, i Ligjit për shoqëritë tregtare i Kroacisë.

dhe personat të tjerë, emërimi i të cilëve është i lejuar me ligj. Me statut mundë të parashihen kushte të posaçme për anëtarët e këshillit mbikëqyrës, të cilët i zgjedh kuvendi i përgjithshëm²²¹.

5.3.2.3. Zgjedhja e anëtarëve të këshillit mbikëqyrës. - Të drejtën për emërimin e anëtarëve të këshillit mbikëqyrës mund ta kenë vetëm aksionarët e caktuar ose poseduesi i përhershëm i aksioneve të caktuara. Poseduesve të aksioneve të caktuara me statut mund t'u jepet e drejta të emërojnë anëtarët e këshillit mbikëqyrës, nëse për këtë është i nevojshëm pëlqimi i shoqërisë. Me statut caktohet numri i anëtarëve të këshillit mbikëqyrës, të cilët i emërojnë të punësuarit.²²²

Anëtarëve të këshillit mbikëqyrës nuk mund t'u caktohen zëvendësit e tyre. Nëse në këshillin mbikëqyrës nuk mbeten anëtarë të nevojshëm për të marrë vendime, anëtarët të cilët mungojnë do t'i emërojë Gjykata me propozimin e drejtorisë, me propozim të ndonjë anëtari të këshillit mbikëqyrës ose me propozim të ndonjë aksionari. Drejtoria është e detyruar t'i paraqesë kërkesë gjykatës pa shtyrje, përpos nëse nuk pritet që numri i anëtarëve të këshillit mbikëqyrës me kohë të plotësohet, deri në mbledhjen e ardhshme të këtij këshilli. Anëtarët e këshillit mbikëqyrës zgjidhen më së shumti për katër vite dhe mund të rizgjidhen përsëri. Nëse në vendim për zgjedhjen e tyre nuk është thënë diçka tjetër, mandati i anëtarit të këshillit mbikëqyrës fillon në ditën e aprovimit të këtij vendimi, përkatësisht, ditën e dhënies së deklaratës për pranimin e

²²¹ Për më tepër, po aty, shih nenin 255.

²²² Lidhur me emërimin e anëtarëve të këshillit mbikëqyrës në shoqëritë aksionare, shih; Barbiq, J., vep.cit., fq.537-540.

detyrës.²²³

5.3.2.4. *Shkarkimi dhe dorëheqja e anëtarëve të këshillit mbikëqyrës.* - Kuvendi i përgjithshëm mund të shkarkoj anëtarin e këshillit mbikëqyrës, edhe para kalimit të mandatit për të cilin është zgjedhur. Lidhur me vendimin për shkarkim të anëtarëve të këshillit mbikëqyrës, është e nevojshme shumica e votave të dhëna në kuvend. Kuvendi nuk ka nevojë që të arsyetojë arsyen për shkarkimin e anëtarit të këshillit mbikëqyrës²²⁴.

Me statut mund të përcaktohet që për shkarkimin e anëtarëve të këshillit mbikëqyrës, të jetë e nevojshme një shumicë më e lartë e votave dhe mund të parashihen edhe kushte tjera të specifikuara. Nëse konstatohet se nuk janë të plotësuara parakushtet për emërimin e anëtarit të këshillit mbikëqyrës, të cilat janë të caktuar me statut, kuvendi i përgjithshëm mundet që anëtarin e emëruar ta shkarkoj me shumicë të thjeshtë të votave. Shkarkimi i anëtarëve të këshillit mbikëqyrës mund të bëhet edhe nga ana e gjykatës. Gjykata me kërkesën e këshillit mbikëqyrës do ta shkarkojë anëtarin e këtij këshilli, nëse për këtë ekziston arsye e rëndësishme. Për ekzistencën ose jo të kërkesës së këshillit mbikëqyrës, vendoset me shumicë të thjeshtë votash. Kryetari dhe anëtari i këshillit mbikëqyrës mund të japin dorëheqje. Në rast të tillë, për pushimin e anëtarësisë në këshillin mbikëqyrës nuk është i nevojshëm vendimi i kuvendit të përgjithshëm. Dorëheqja në formë me shkrim i paraqitet shoqërisë, dhe nëse nga kjo nuk del diçka tjetër, dorëheqja është efektive që nga dita kur ajo është dhënë²²⁵. Në

²²³ Për më tepër shih nenet 255-260, i Ligjit për shoqëritë tregtare i Kroacisë.

²²⁴ Një praktikë e shkarkimit të anëtarëve të këshillit mbikëqyrës pa dhënien e sryeve për shkarkim, haset edhe në të drejtën franceze. Shih për këtë; Barbić, J., op.cit., fq.573.

²²⁵ Barbić, J., op.cit., fq.577.

raste të tilla, Drejtoria e shoqërisë është e obliguar që menjëherë t'i njoftojë të gjithë anëtarët e shoqërisë. Dorëheqja e dhënë e anëtarit të zgjedhur të këshillit mbikëqyrës mund të tërhiqet vetëm me pëlqimin e kuvendit të përgjithshëm²²⁶.

5.3.2.5. Anëtari i drejtorisë edhe inkompatibiliteti për të qenë anëtar në këshillin mbikëqyrës të shoqërisë. - Anëtar i këshillit mbikëqyrës nuk mund të jetë i emëruar edhe anëtar i drejtorisë, zëvendësi i përhershëm i anëtarit të drejtorisë, prokuruesi e as i autorizuari i shoqërisë. Këshilli mbikëqyrës mundet që, më së shumti, për kohën të cilën paraprakisht e cakton, por jo më shumë se një vit, disa anëtar të tij t'i emërojë për zëvendës të anëtarëve të drejtorisë, të cilët mungojnë ose të cilët nuk janë në gjendje të kryejnë funksionin e tyre. Këshilli mbikëqyrës kështu mundet që përsëri t'i emërojë anëtarët e vet të njëjtë, në mënyrë që mandati i tyre në tërësi, të mos zgjatë më shumë se një vit. Për kohën deri sa kryen punët në drejtorinë e shoqërisë, anëtari i këshillit mbikëqyrës, nuk mund të ushtrojë funksionin e tij si anëtar i këshillit mbikëqyrës. Për emërimin e tillë të anëtarëve të drejtorisë nuk vlen ndalesa lidhur me ndalesën e konkurrencës.²²⁷

5.3.2.6. Regjistrimi në regjistrin gjyqësor dhe lajmërimi i ndryshimit në këshillin mbikëqyrës. - Drejtoria dhe kryetari i këshillit mbikëqyrës janë të detyruar që çdo ndryshim në përbërjen e këshillit mbikëqyrës ta lajmërojnë pa shtyrje, në mënyrë që të shpallin lajmërimet e shoqërisë dhe në afatin e përcaktuar kohor t'i paraqesin gjyqit të regjistrimit, fletëparaqitjen për regjistrimin e ndryshimit në regjistrin gjyqësor.

²²⁶ Lidhur me dorëheqjen e antarëve të këshillit mbikëqyrës, shih neni 260a., i Ligjit për shoqëritë tregtare i Kroacisë.

²²⁷ Shih për këtë, nenin 261 të Ligjit për shoqëritë tregtare i Kroacisë.

Fletëparaqitjes së përmendur gjithsesi duhet t'i bashkëngjitet vendimi për shkarkimin e anëtarit të këshillit mbikëqyrës, përkatësisht dorëheqja e tij dhe vendimi për zgjedhjen e anëtarit të ri. Gjithashtu, kësaj fletëparaqitje, duhet t'i bashkëngjitet edhe deklarata e anëtarit të ri, me të cilën e pranon zgjedhjen, së bashku me të dhënat për datën e emërimit, dorëheqjes ose shkarkimit.²²⁸

5.3.2.7. *Kompetencat dhe mënyra e punës së këshillit mbikëqyrës.* - Këshilli mbikëqyrës, bën mbikëqyrjen e punëve të shoqërisë. Këshilli mbikëqyrës mund të kontrollojë dhe trajtojë librat afarist dhe dokumentacionin e shoqërisë, arkën, letrat me vlerë dhe gjëra të tjera. Për këtë qëllim, këshilli mund të shfrytëzojë ndonjërin nga anëtarët ose ekspertët e vet. Këshilli mbikëqyrës i jep urdhër revizorit për vlerësimin e raporteve vjetore financiare të shoqërisë dhe gjithashtu i paraqet Kuvendit të përgjithshëm informimin me shkrim për mbikëqyrjen e bërë siç u cek më lart. Në raport gjithsesi duhet të theksojë se, a vepron shoqëria në pajtim me ligjin dhe rregulloret e shoqërisë, si dhe në pajtim me vendimet e Kuvendit të përgjithshëm, raportet vjetore financiare, a janë bërë në harmoni me gjendjen në librat afariste të shoqërisë dhe a pasqyrojnë realisht gjendjen pasurore dhe afariste të shoqërisë, si dhe qëndrimin të cilin e ka këshilli mbikëqyrës për propozimin e administratës, lidhur me përdorimin e fitimit dhe mbulimin e humbjeve të shoqërisë. Anëtarët, të cilët nuk pajtohen me ndonjë pjesë të njoftimit ose me njoftimin si tërësi janë të obliguar që kuvendit të përgjithshëm, në formën me shkrim t'i paraqesin vërejtjet e veta. Me fjalë të tjera, këshilli mbikëqyrës “nuk duhet të ndalet vetëm në vlerësimin e veprimeve, të cilat kanë ndodhur në të kaluarën, por gjithsesi duhet të veprojë në mënyrë preventive dhe duke këshilluar

²²⁸ Po aty, Neni 162.

administratën të ndikojë në politikën afariste të shoqërisë”²²⁹.

Këshilli mbikëqyrës mundet që ta thërrasë kuvendin e përgjithshëm të shoqërisë. Ai këtë veprom duhet ta ndërmerrë në të gjitha rastet kur vlerëson se kjo është e nevojshme për të mirën e shoqërisë. Vendimin për këtë veprim, këshilli mbikëqyrës e arrin me shumicën e thjeshtë të votave. Udhëheqja e punëve të shoqërisë nuk mund të bartet në këshillin mbikëqyrës. Me statut ose me vendim të këshillit mbikëqyrës mund të përcaktohet që disa punë të caktuara të bëhen vetëm me pëlqimin paraprak të këtij këshilli. Nëse këshilli mbikëqyrës refuzon të jap pëlqimin, administrata mund të kërkojë nga kuvendi i përgjithshëm që ai të jap pëlqimin e nevojshëm. Kuvendi i përgjithshëm merr vendim për dhënien e pëlqimit me shumicën nga së paku tri të katërtat e votave të dhëna. Me statut nuk mund të përcaktohet që për këtë veprim të jetë e nevojshme një shumicë më e madhe e as nuk mund të kërkojë plotësimin e kushteve plotësuese²³⁰. Këshilli mbikëqyrës përpos kompetencave të përmendura, e përfaqëson shoqërinë edhe në kontekstet gjyqësore, të cilat zhvillohen kundër anëtarëve të administratës së shoqërisë.²³¹

Këshilli mbikëqyrës nga radhët e anëtarëve të vet zgjedhë kryetarin dhe, së paku, një zëvendës të tij. Administrata duhet t’ia prezantojë fletëparaqitjen, gjyqit të regjistrimit për t’u shtuar në regjistrin gjyqësor të personave të regjistruar. Zëvendësi ka të drejtat dhe detyrimet e kryetarit, vetëm në rast se kryetari është në pamundësi për të

²²⁹ Barbić, J., vep.cit., fq.556.

²³⁰ Neni 263, i Ligjit për shoqëritë tregtare i Kroacisë.

²³¹ Neni 268, i Ligjit për shoqëritë tregtare i Kroacisë. Kjo për faktin se këshilli mbikëqyrës e përfaqëson shoqërinë, në momentin kur ndaj anëtarit të drejtorisë, është inicuar procedurë gjyqësore në emër të shoqërisë.

kryer funksionet e tij. Për mbledhjet e këshillit mbikëqyrës mbahet procesverbali, të cilin e nënshkruan kryetari ose nënkryetari që e ka udhëhequr mbledhjen. Këshilli mbikëqyrës mund të emërojë komisione me qëllim të përgatitjes së vendimeve që nxjerrë dhe mbikëqyrë zbatimin e tyre. Komisionet nuk mund të vendosin për çështjet nga kompetencat e këshillit mbikëqyrës dhe të njëjtat janë të detyruara që për punën e vet, ta njoftojnë rregullisht këshillin mbikëqyrës²³².

5.3.2.8. Thirrja e mbledhjeve, pjesëmarrja në mbledhje dhe vendosja në Këshillin mbikëqyrës. - Secili anëtar i këshillit mbikëqyrës ose administrata mundet që me theksimin e shkaqeve dhe qëllimeve të kërkojë që, kryetari ta thërrasë mbledhjen e këshillit. Mbledhja duhet të mbahet në afat prej 15 ditësh, nga dita kur është thirrur. Nëse nuk është i kënaqur me këtë kërkesë, anëtar i këshillit mbikëqyrës ose drejtoria mund ta thërrasin mbledhjen e këshillit mbikëqyrës, duke theksuar arsyen e thirrjes dhe rendin e ditës së mbledhjes. Mbledhja e këshillit mbikëqyrës, sipas rregullit duhet të mbahet një herë në tre muaj, kurse duhet të thirret më së paku një herë në gjysmë viti. Nëse me statut nuk është e rregulluar ndryshe, vendimet e këshillit mbikëqyrës merren me shumicën e votave të dhëna. Anëtarët e këshillit mbikëqyrës të cilët mungojnë, mund të marrin pjesë në marrjen e vendimit, në mënyrë që votën e tyre ta japin në formën me shkrim. Vota në formën me shkrim mund të jepet përmes anëtarit tjetër të këshillit mbikëqyrës ose personit tjetër të autorizuar. Vota në këshillin mbikëqyrës ose në komisionin e tij mund të jepet me shkrim, telefon, telegraf, telefaks dhe me shfrytëzimin e mjeteve tjera teknike të përshtatshme për këtë veprim, nëse për këtë nuk kundërshton asnjë anëtar i këshillit mbikëqyrës ose komisionit, nëse me rregulloren për

²³² Për më tepër, shih neni 264, i Ligjit për shoqëritë tregtare i Kroacisë.

punën e tyre nuk është rregulluar ndryshe.²³³

5.3.2.9. Emërimi dhe shkarkimi i anëtarëve të drejtorisë në organizimin e administratës me dy nivele. - Anëtarët e drejtorisë dhe kryetarin, i emëron këshilli mbikëqyrës i shoqërisë, më së shumti në një afat prej 5 vitesh, në mënyrë që të mund t'i emëroj përsëri. Nëse në vendimin për emërim nuk është thënë diçka tjetër, mandati i kryetarit dhe anëtarëve të drejtorisë fillon që nga dita e nxjerrjes së vendimit për emërim, pa marrë parasysh regjistrimin e vendimit në regjistrin gjyqësor. Emërimi i përsëritur i kryetarit dhe anëtarëve të drejtorisë nuk është i mundur që të bëhet më herët se një vit nga dita kur kalon afati për kalimin e mandatit të tyre. Këshilli mbikëqyrës mund ta tërheqë vendimin e tij për emërimin e anëtarëve të drejtorisë ose kryetarit të tij kur për këtë veprim ekzistojnë arsye të rëndësishme. Arsye e rëndësishme zakonisht konsiderohet cenimi i rëndë i detyrave, paaftësia për kryerjen e rregullt të punëve të shoqërisë ose tregimi i mosbesimit në kuvendin e përgjithshëm të shoqërisë, përpos në rastet kur mosbesimi është treguar-bërë për shkak të arsyeve të pabazuara. Tërheqja-anulimi i vendimit është i vlefshëm deri sa pavlefshmëria e tij të mos vërtetohet me vendim gjyqësorë. Me shkarkimin e anëtarit ose kryetarit të administratës nuk preken dispozitat e kontratës, të cilat ata i kanë lidhur me shoqërinë²³⁴

5.3.2.10. Dorëheqja e anëtarit të drejtorisë. - Kryetari dhe anëtari i drejtorisë mund të jap dorëheqje pavarësisht nga kërkesa që shoqëria mund ta ketë për këtë arsye ndaj tyre, nga kontratat të cilat i kanë lidhur me shoqërinë. Për pushimin e anëtarësisë në drejtori

²³³ Po aty, nenet 265-267.

²³⁴ Shih për më tepër, neni 244, i Ligjit për shoqëritë tregtare i Kroacisë.

nuk është i nevojshëm vendimi i këshillit mbikëqyrës. Nëse nga deklarata, sipas të cilës është dhënë dorëheqja, nuk nënkuptohet fakti se nga cili moment ka efekt dorëheqja, dorëheqja vepron nga dita kur i është deklaruar shoqërisë (nëse për këtë ekziston arsye e rëndësishme), në të kundërtën dorëheqja vepron vetëm 15 ditë nga dita në të cilën ajo është dhënë. Dorëheqja deklarohet në formë të shkruar dhe i konfirmohet këshillit mbikëqyrës të shoqërisë, kurse me dorëheqje menjëherë duhet të njoftohen edhe anëtarët e tjerë të drejtorisë. Dorëheqja e dhënë mund të tërhiqet vetëm me pajtimin e këshillit mbikëqyrës²³⁵. Ndryshimet e drejtorisë duhet të lajmërohen në regjistrin e gjykatës dhe ky lajmërim bëhet në mënyrë të njëjtë me lajmërimin e ndryshimeve për anëtarët e këshillit mbikëqyrës²³⁶. Anëtarët e rinj të drejtorisë patjetër duhet të japin deklaratë për faktin nëse kanë pengesa elementare ligjore për emërimin e tyre si anëtarë të drejtorisë²³⁷.

5.3.2.11. Detyra e drejtorëve për të raportuar para këshillit mbikëqyrës. - Drejtoria është e detyruar që këshillin mbikëqyrës ta raportojë për: politikën afariste dhe për çështjet të tjera bazike për udhëheqjen e punëve në të ardhmen si dhe largimeve nga parashikimet e mëhershme. Raportimi duhet të përpilohet me mirëbesim dhe të jetë i vërtetë. Raportimet duhet të bëhen me kohë dhe sipas rregullit në formë të shkruar. Këshilli mbikëqyrës në çdo kohë mund të kërkojë nga drejtoria që ta raportojë për çështje, të cilat janë të lidhura me afarizmin e shoqërisë dhe të cilat rrënjësisht ndikojnë

²³⁵ Shih për këtë, neni 244a, i Ligjit për shoqëritë tregtare i Kroacisë.

²³⁶ Shih më gjerësisht, pika 5.3.2.6, të këtij kapitulli.

²³⁷ Shih për këtë neni 245a, i Ligjit për shoqëritë tregtare i Kroacisë.

në gjendjen e shoqërisë ose që me arsye mund të pritet se do të mund të ndikojë në të. Secili anëtar i këshillit mbikëqyrës ka të drejtë që të kërkojë që raportimi t'i jepet në shikim. Nëse këshilli mbikëqyrës nuk vendos ndryshe, secili anëtarë i tij ka të drejtë që me kërkesën e tij, t'i jepet një kopje e raportimit. Nëse vendos kështu këshilli mbikëqyrës, raporti duhet t'i jepet në shikim edhe anëtarëve të komisioneve të këshillit mbikëqyrës, në pajtim me këtë përfundim.

Kryetari i këshillit mbikëqyrës është i detyruar që t'i njoftoj anëtarët e këshillit mbikëqyrës, më së voni në mbledhjen e parë, e cila mbahet menjëherë pas pranimi të këtij raporti.²³⁸ Raportimi i përmendur duhet të jetë në dispozicion të publikut.²³⁹

5.3.2.12. *Detyra për kujdesin.* - Detyrimi i kujdesit dhe përgjegjësisë të anëtarëve të drejtorisë. Konsiderohet se, anëtari i drejtorisë nuk ka vepruar kundër detyrimit për mënyrën e udhëheqjes së shoqërisë, nëse i njëjti para se të ketë marrë vendimin afarist në bazë të informatave të marra në mënyrë të arsyeshme, ka mundësi që të supozojë se është duke vepruar për të mirën e shoqërisë. Në situatat kontestuese, lidhur me faktin nëse kanë vepruar për të mirën e shoqërisë, anëtarët e drejtorisë duhet të dëshmojnë se kanë zbatuar syçelësinë dhe kujdesin e ekonomistit të rregullt dhe të kujdesshëm. Anëtarët e drejtorisë, posaçërisht janë përgjegjës për dëmin e shkaktuar, nëse në kundërshtim me ligjin iu kthejnë aksionarëve atë që kanë investuar në shoqëri, iu paguajnë aksionarëve kamata ose dividendë, regjistrojnë, arrijnë, lënë peng ose tërheqin aksionet personale të shoqërisë ose të ndonjë shoqërie tjetër, japin aksione para se për to të jetë paguar vlera nominale ose vlera më e madhe për të cilën janë dhënë. Gjithashtu,

²³⁸ Neni 249, i Ligjit për shoqëritë tregtare i Kroacisë.

²³⁹ Po Aty, Neni 250 a.

anëtarët e drejtorisë, do të jenë përgjegjës, edhe nëse shpërndajnë pasurinë e shoqërisë, bëjnë pagesa pasi paraqitet paaftësia e shoqërisë për pagesë. Dhe, gjithashtu, anëtarët e drejtorisë do të jenë personalisht përgjegjës nëse, pasi ka arritur të vijë mbingarkesa e shoqërisë me borxhe, japin kompensime anëtarëve të bordit mbikëqyrës, ose të njëjtëve në një situatë të tillë, u japin kredi. Në raste të tilla, detyrimi për pagesën e dëmit nuk ekziston, nëse veprimi i anëtarëve të drejtorisë është i bazuar në vendimin e kuvendit të përgjithshëm.

Lejimi i veprimeve të përmendura nga ana e bordit mbikëqyrës, nuk përjashton detyrimin e anëtarëve të drejtorisë për përgjegjësi. Shoqëria mundë të heqë dorë nga kërkesa për kompensimin e dëmit ose për këtë çështje mundë të arrijë ujdi vetëm pas kalimit prej tri viteve nga paraqitja e kërkesës. Veprimet e sipërtheksuara për heqje dorë ose ujdi, shoqëria mund t'i bëjë vetëm atëherë, kur për këto veprime të jetë pajtuar kuvendi i përgjithshëm dhe nëse për këtë nuk kundërshton pakica, e cila disponon me aksione që paraqesin së paku një të dhjetën e kapitalit themelor të shoqërisë. Nëse mbi shoqërinë është hapur procedura e likuidimit, për kohën sa zgjat kjo procedurë, e drejta e kreditorëve të shoqërisë ndaj anëtarëve të administratës realizohet në procedurën e likuidimit, kurse këto kërkesa parashkruhen për pesë vite.²⁴⁰

5.3.3. Përgjegjësitë e veçanta të drejtorëve në korporata, në Kroaci, në të dyja

format e organizimit të administratës

5.3.3.1. Detyra për besnikëri dhe ndalimi i konkurrencës. - Anëtari i drejtorisë nuk mundet që pa pajtimin e bordit mbikëqyrës, për llogari të vet e as për llogari të huaj, të kryej punë të cilat bien ndesh në lëmin e afarizmit të shoqërisë, nuk mund të jetë anëtar i

²⁴⁰ Neni 252, i Ligjit për shoqëritë tregtare i Kroacisë.

administratës e as bordit mbikëqyrës në shoqërinë tjetër, e cila merret me punët nga lënda e afarizmit të shoqërisë, dhe nuk mundet që në lokalet afariste të shoqërisë të kryejë punë për llogari të veten e as për llogari të huaj. Nëse anëtari i administratës vepron në kundërshtim me kufizimet e sipërtheksuara, shoqëria nga ai mund të kërkojë që për shkak të mosrespektimit të kufizimeve, t'i kompensojë shoqërisë, dëmin e shkaktuar.

Në vend të kompensimit, shoqëria mund të kërkojë nga anëtari i drejtorisë, të lejojë që punët të cilat i ka lidhur për llogari të vet, të konsiderohen si punë të lidhura për llogari të shoqërisë, si dhe nga punët, të cilat ka lidhur për llogari të huaj, t'i barti shoqërisë atë që për këto punë ka pranuar, përkatësisht t'ia bartë kërkesën për pagesë për të gjitha ato që anëtari i drejtorisë do të duhej të merrte. Afati për parashkrimin absolut të kësaj kërkeje, të cilën shoqëria mund ta bëjë ndaj anëtarit të drejtorisë, është pesë vite.²⁴¹

5.3.3.2. Detyrimi për kujdes dhe përgjegjësia e anëtarëve të këshillit mbikëqyrës.

- Anëtarët e këshillit mbikëqyrës janë të detyruar që të veprojnë në interesin e shoqërisë. Për këtë detyrim të anëtarëve të këshillit mbikëqyrës në kryerjen e punëve të këshillit me kujdesin e duhur dhe në përgjegjësinë e tyre, në mënyrë përkatëse, zbatohen dispozitat nga neni 252, 273 dhe 273.a, të Ligjit për shoqëritë tregtare. Anëtarët e këshillit mbikëqyrës, posaçërisht janë të detyruar të ruajnë si sekret afarist të gjithë atë që arrijnë të dinë, në bazë të burimeve të besueshme dhe këshillave të dhëna shoqërisë.

5.3.3.3. Përgjegjësia e drejtorëve për dështimin për të vepruar. - Drejtoria është e

²⁴¹Neni 248, i Ligjit për shoqëritë tregtare i Kroacisë.

detyruar për të vepruar dhe për të ndërmarrë veprime, sidomos në momentin kur konstatohen humbje, hyrje në borxhe ose paaftësi për pagesë. Nëse gjatë punimit të llogarive vjetore financiare ose llogarive tjera, ose kur konstatohet se në shoqëri është paraqitur humbja në lartësi të gjysmës së kapitalit themelor të shoqërisë, drejtoria menjëherë duhet ta thërrasë kuvendin e përgjithshëm të shoqërisë dhe ta lajmërojë menjëherë për këtë gjendje.

Gjithashtu, nëse shoqëria nuk është e aftë për pagesë ose është e ngarkuar me obligime, drejtoria duhet që pa shtyrje, e më së voni, tri javë pas paraqitjes së shkakut, i cili sipas ligjit të veçantë është përcaktuar si shkak për fillimin e procedurës së likuidimit, do të kërkojë që të fillohet kjo procedurë. Pasi të paraqitet paaftësia për pagesë, përkatësisht para se të vijë deri te mbingarkimi me obligime, drejtoria nuk guxon që të bëjë pagesa. Kjo ndalesë nuk ka të bëjë me pagesat, të cilat, pas lajmërimit të kësaj sate, bëhen me kujdesin e ekonomistit të rregullt dhe të kujdesshëm, e të cilat bëhen me qëllimin e rritjes së aktivitetit të shoqërisë.

5.3.3.4. Ndalimi i shfrytëzimit të pozitës në shoqëri dhe përgjegjësia për dëmin e shkaktuar. - Kushdo që me qëllim të përdorimit të ndikimit të tij në shoqëri, ndikon në anëtarin e administratës, përkatësisht drejtorin ekzekutiv ose anëtarin e këshillit mbikëqyrës ose të drejtorëve, prokuruesin ose të autorizuarin e tij, në mënyrë që këta persona i shtyn të ndërmarrin diçka në dëm të shoqërisë ose aksionarëve të saj, është përgjegjës dhe i përgjigjet shoqërisë për dëmin që, me këtë veprim, ka shkaktuar. Personi përgjegjës për dëmin iu përgjigjet edhe aksionarëve, nëse ky u është shkaktuar aksionarëve, pa marrë parasysh dëmin që i është shkaktuar shoqërisë. Përpos personit

përgjegjës siç u përshkrua më lart, për dëmin e shkaktuar, përgjigjen si borxhli solidar edhe anëtarët e administratës, përkatësisht drejtorët ekzekutiv dhe anëtarët e këshillit mbikëqyrës, përkatësisht këshillit drejtues nëse në çfarëdo mënyre kanë shkelur detyrat e tyre. Në rast kontesti, anëtarët e administratës, përkatësisht drejtorët ekzekutiv dhe anëtarët e këshillit mbikëqyrës, pra, këshillit drejtues, gjithsesi duhet të dëshmojnë se në kryerjen e detyrave të tyre kanë vepruar ashtu si duhet dhe me ndërgjegje dhe mirëbesim. Anëtarët e administratës, përkatësisht drejtorët ekzekutiv dhe anëtarët e këshillit mbikëqyrës nuk e kanë këtë përgjegjësi nëse kanë zbatuar vendimin e ligjshëm të kuvendit të përgjithshëm. Lejimi i veprimit nga ana e këshillit mbikëqyrës ose drejtues, nuk përjashton detyrimin për të kompensuar dëmin. Kërkesën për kompensimin e dëmit mund ta paraqesin edhe kreditorët e shoqërisë, nëse nuk mundën që kërkesat e tyre t'i realizojnë nga shoqëria. Në raport me kreditorët, shoqëria nuk mund të lirohet nga detyrimi për kompensimin e dëmit duke shprehur gatishmëri për të hequr dorë nga kërkesa ose për kërkesën të lidhë marrëveshje. Gjithashtu, shoqëria nuk mund të lirohet nga detyrimi i përmendur, as duke u arsyetuar se veprimi është bazuar në vendimin e kuvendit të përgjithshëm. Nëse ndaj shoqërisë është hapur likuidimi, gjatë kohës sa zgjat procedura e likuidimit, të drejtat e kreditorëve të shoqërisë i realizon administratori likuidues. Këto kërkesa parashkruhen për pesë vite.

5.3.4. Të drejtat e veçanta të drejtorëve, në të dyja format e organizimit të

administratës

5.3.4.1. E drejta e drejtorëve për kompensim. - Pjesëmarrja e anëtarëve të drejtorisë në fitimin e shoqërisë. Shoqëria mundet, që anëtarëve të drejtorisë, për punën e tyre t'u

japë të drejtën të marrin pjesë në fitimin e shoqërisë. Nëse anëtarëve të shoqërisë iu jepet e drejta për pjesëmarrje në fitim, në vitin rrjedhës, pjesëmarrja e tyre llogaritet sipas këtij fitimi të zvogëluar, për humbjet e pambuluara nga vitet paraprake dhe për vlerat, të cilat sipas ligjit dhe statutit, nga fitimi i vitit rrjedhës barten në rezervat e shoqërisë. Përcaktimi tjetër i pjesëmarrjes së anëtarëve të drejtorisë në fitimin e shoqërisë është i pavlefshëm.

5.3.4.2. Parimet për shpërblimin e anëtarëve të drejtorisë. - Me rastin e përcaktimit të shpërblimeve të përgjithshme të secilit anëtar të administratës, (pagave, pjesëmarrjes në fitim, rimbursimin e shpenzimeve, pagesën e premisë së sigurimeve, provizioneve dhe të gjitha kompensimeve të tjera), këshilli mbikëqyrës gjithsesi duhet të kujdeset për faktin që, vlera e përgjithshme e shpërblimeve të jetë në proporcion të drejtë me punën që bën anëtari i drejtorisë dhe gjendjen e shoqërisë. Nëse pas ndarjes së shpërblimeve të cilat u janë bërë anëtarëve të drejtorisë, gjendja e shoqërisë vështirësohet në atë masë, sa që pagesa e mëtejshme e shpërblimeve do të paraqiste padrejtësi të madhe ndaj shoqërisë, këshilli mbikëqyrës, ose edhe me kërkesën e këtij këshilli, gjykata, janë të autorizuar që përshtatshmërisht të bëjnë zbritjen e tyre. Zbritja e shpërblimeve nuk ka ndikim në pjesët e tjera të kontratës së anëtarit të drejtorisë me shoqërinë. Anëtari i drejtorisë ka të drejtë në shkëputjen e kontratës me përfundimin e tremujorit, në mënyrë që afati denoncues për shkëputje të kontratës të jetë gjashtë javë nga dita e lajmërimit me shkrim.

5.3.4.3. Dhënia e kredive anëtarëve të drejtorisë dhe anëtarëve të këshillit mbikëqyrës.

-Shoqëria mund t'i jap kredi anëtarëve të drejtorisë, prokurueseve dhe anëtarëve të

familjes së tyre të ngushtë, vetëm në bazë të vendimit të këshillit mbikëqyrës. Vendimi mund të ketë të bëjë vetëm për kontrata të caktuara për kredinë ose llojin e kredisë, kurse kontrata për kredinë mund të lidhet më së voni tre muaj nga dita e nxjerrjes së vendimit, me të cilën kredia është lejuar. Në vendim, gjithsesi, duhet të caktohen kamatat dhe vlera e kredisë. Kredi konsiderohen edhe veprimet e tjera juridike, të cilat në kuptimin afarist mundë të barazohen me to. Ky rregull nuk vlen për kreditë të cilat nuk kalojnë pagën mujore të anëtarit të administratës. Në këto raste vendimin për dhënien e kredisë e jep këshilli mbikëqyrës i shoqërisë udhëheqëse. Nëse kredia jepet në kundërshtim me atë çka u tha më sipër, pa marrë parasysh dispozitat e kontratës duhet të kthehet menjëherë, përpos nëse këshilli mbikëqyrës më vonë do të merrte vendimin, me të cilin do të lejonte dhënien e kredisë. Në dhënien e anëtarëve të menaxhimit të kreditit dhe përfaqësuesit, si dhe për anëtarët e familjeve të tyre të ngushtë, do të zbatohen në mënyrë të përshtatshme dispozitat ligjore të Ligjit për shoqëritë tregtare. Këshilli mbikëqyrës dhe anëtarët e shoqërisë nuk mund të vendosin për të dhënë kredi në qoftë se duhet të jepen asetet e nevojshme të cilat janë të nevojshme që për të mbajtur vlerën e kapitalit. Kredia, e cila do të jepet në kundërshtim me kushtet e përmendura më sipër, duhet të kthehet menjëherë në kompani. Shoqëria mund t'i jap kredi anëtarëve të këshillit mbikëqyrës dhe anëtarëve të familjes së ngushtë të tyre, vetëm me lejen e këtij këshilli. Leja mund të jepet vetëm për punë të caktuara kreditore ose për lloje të caktuara të këtyre punëve, në mënyrë që kontrata duhet të lidhet më së voni tre muaj, pasi këshilli të ketë dhënë pëlqimin për këtë veprim. Në leje gjithsesi duhet të caktohen kamatat dhe pagesa e kredisë.

5.3.4.4. Shpërblimi për punë i anëtarëve të këshillit mbikëqyrës. - Anëtarëve të këshillit

mbikëqyrës, për punën e tyre mund t'u paguhet kompensim, i cili mundë të përcaktohet edhe me pjesëmarrjen e anëtarit të këshillit, në fitimin e shoqërisë. Kompensimi përcaktohet me statut, por mundet t'ia njoh edhe kuvendi i përgjithshëm i shoqërisë. Nëse kompensimi është i caktuar me statut, kuvendi i përgjithshëm mundet që me shumicë të thjeshtë të votave, të marrë vendim për ndryshimin e statutit, me të cilin ky kompensim zvogëlohet.

5.4. Përfundimet nga kapitulli i pestë

Në teori njihen dy mënyra ose dy modele të administrimit të korporatave. Në njërin anë është administrimi i korporatave me dy nivele (two-tier board), i cili më parë ishte karakteristikë vetëm e modelit evropian të qeverisjes së korporatave, kurse në anën tjetër është administrimi i korporatave me një nivel të qeverisjes-bordi unitar (unitary board), i cili më parë ishte karakteristikë vetëm e modelit anglosakson të qeverisjes së korporatave. Ligji për shoqëritë tregtare i Republikës së Kosovës, njeh vetëm formën e organizimit të administrimit të korporatave me një nivel (unitary board). Në këtë formë të organizimit, Bordi paraqitet si organ ekzekutiv në raport me themeluesit, por njëkohësisht ky organ paraqitet në rolin e organit mbikëqyrës në raport me drejtorët menaxhues, të cilët merren ekskluzivisht me udhëheqjen dhe ekzekutimin e punëve të shoqërisë.

Administrimi i korporatës me një nivel të qeverisjes në Shqipëri dhe Kroaci; Sipas Ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, në Shqipëri, korporatat kanë të drejtë që vullnetarisht të vendosin se a do të përcaktohen për organizimin e administratës me dy nivele apo me një nivel. Në rastin e organizimit të administratës me një nivel, në

korporatë nuk organizohet Këshilli mbikëqyrës. Në këtë formë të organizimit, si organe të shoqërisë përpos asamblesë së përgjithshme, janë edhe Këshilli i administrimit dhe administratorët. Në këtë formë të organizimit, **Këshilli i administrimit** paraqitet si organ ekzekutiv në raport me themeluesit, por njëkohësisht ky organ paraqitet në rolin e organit mbikëqyrës në raport me **administratorët**, të cilët merren ekskluzivisht me udhëheqjen dhe ekzekutimin e punëve të shoqërisë.

- Administrimi i korporatës me dy nivele në Shqipëri dhe Kroaci;

Nëse themeluesit e korporatës përcaktohen për administrimin e korporatës me dy nivele, atëherë kjo strukturë organizative e korporatës do të përbëhet nga Administrata (**Uprava**) dhe Këshilli mbikëqyrës (**Nadzorni odbor**). Administrata mund të jetë e përbërë nga një ose më tepër drejtorë, e në rastin kur përbëhet nga më tepër drejtorë, ata së bashku do ta emërojnë kryetarin (**predsjednika**) e administratës. Administrata, sipas këtij organizimi, merret me kryerjen e punëve ekzekutive të korporatës. Këshilli mbikëqyrës përbëhet nga më së paku tre anëtarë, kurse numri i tyre parashihet me statut dhe çdoherë duhet të jetë tek.

- Detyra e drejtorëve për të raportuar para këshillit mbikëqyrës;

Detyrimi i drejtorisë për t'i paraqitur Këshillit mbikëqyrës, raportet vjetore për gjendjen e shoqërisë.

Lidhur me detyrën për kujdesin dhe përgjegjësitë e veçanta të drejtorëve, në të dyja format e organizimit të administratës, parashihet detyra e drejtorëve për besnikëri dhe ndalimi i konkurrencës. Gjithashtu, parashihet edhe vëmendja e duhur dhe përgjegjësia e anëtarëve të bordit, detyrimi për kujdes dhe përgjegjësia e anëtarëve të bordit mbikëqyrës, përgjegjësia e drejtorëve për dështimin për të vepruar, ndalimi i

shfrytëzimit të pozitës në shoqëri dhe përgjegjësia për dëmin e shkaktuar etj. Të drejtat e veçanta të drejtorëve, në të dyja format e organizimit të administratës njihen; e drejta e drejtorëve ekzekutiv për kompensim, parimet e përcaktuara për shpërblimin e anëtarëve të drejtorisë, dhënia e kredive anëtarëve të drejtorisë dhe prokurueseve, dhënia kredi për anëtarë të drejtorisë dhe prokurueseve, dhënia e kredisë anëtarit të këshillit mbikëqyrës etj.

KAPITULLI VI: PËRGJEGJËSIA SOCIALE E KORPORATAVE

6.1. Përgjegjësia sociale e korporatave në Kosovë

6.1.1. Punëtorët dhe roli i tyre në qeverisjen korporative në Kosovë

6.1.1.1. *Programet për Pronësinë e Aksioneve nga Punonjësit (PPAP).* - Ligji për shoqëritë tregtare në Kosovë, ka paraparë programe të cilat miratohen nga aksionarët për t'i inkurajuar punonjësit që të blejnë aksione në shoqërinë aksionare. Këto programe, kan bërë të mundur që punonjësit si pjesëmarrës në blerjen e aksioneve, të parapaguajnë për aksione dhe ato ti marrin me çmim më të ulët, apo aksionet të ju jepen si kompensim për punën ose angazhimin e tyre në korporatë. Këto programe kan paraparë mundësinë që, po ashtu, të krijojnë mundësi për pjesëmarrësit në lidhje me aksionet që do të emetohen në të ardhmen, nga shoqëria aksionare. Ligji ka përcaktuar se, në PPAP duhet të përcaktohen kërkesa të arsyeshme të kualifikimit, të cilat një person duhet t'i plotësojë. Ndër këto kërkesa mund të jetë edhe që personi të jetë në marrëdhënie pune me orar të plotë në shoqërinë aksionare.²⁴² PPAP-ja, hyn në fuqi vetëm nëse është miratuar në një mbledhje të aksionarëve të thirrur në mënyrë të rregullt; dhe nëse një dokument, i cili përcakton të gjitha aspektet materiale të PPAP-së, u është siguruar aksionarëve, së paku, tridhjetë ditë para mbledhjes përkatëse.²⁴³

²⁴² Disa korporata kanë interpretuar gabimisht këtë dispozitë ligjore, duke pamundësuar punëtorët të cilët kishin punuar me orarë të plotë, por në kohë të caktuar, edhe pse për shumë vite me radhë. Ishte rasti ky i një punëtori në korporatën "Libri shkollor" SH.A., të cilit i ishte mohuar e drejta në blerjen e aksioneve, me arsyetim se Statuti i kompanisë kishte përcaktuar këtë kufizim. Kërkesa e punëtorit edhe pse e bazuar në ligj, me aktgjykimin C.nr.396/2013 të datës 16.03.2016, u refuzua nga Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike. Rasti është dërguar me ankesë në Gjykatën e Apelit.

²⁴³ Shih neni 209, i Ligjit për shoqëritë tregtare në Kosovë.

6.1.1.2. *Të drejtat e punëtorëve, të cilat rrjedhin nga marrëdhënia e punës*. – Si edhe në shumë vende të tjera edhe në Kosovë, janë ndërmarrë veprime për sigurimin e kushteve themelore, të cilat punëtorëve ju sigurojnë kushte minimale ligjore, për pjesëmarrjen e tyre në qeverisjen korporative. Kjo, e drejtë e punëtorëve është siguruar, nga garantimi dhe mbrojtja e të drejtave të punëtorëve, të cilat rrjedhin nga marrëdhënia e punës.²⁴⁴

Me këtë bazë ligjore, ndalohen të gjitha llojet e diskriminimit dhe ndalohet puna e dhunshme²⁴⁵ dhe njëkohësisht janë përcaktuar kushtet dhe kriteret për themelimin e marrëdhënies së punës, të drejtat e punëmarrësit me rastin e ndërrimit të punëdhënësit. Më tej, ligji ka rregulluar dhe garantuar kushtet dhe rrethanat për sistemimin e punëtorit në vendin e punës, orarin e punës, pushimin dhe mungesat nga puna, mbrojtjen dhe sigurinë në punë, pagën dhe beneficionet e të punësuarve, ndërprerjen e marrëdhënies së punës, procedurën për realizimin e të drejtave nga marrëdhënia e punës, organizatat e të punësuarve dhe punëdhënësve dhe dialogu social, kushte këto të domosdoshme për mundësimin e punëtorëve për pjesëmarrje në qeverisjen korporative.

6.1.1.3. *Të drejtat e punëtorëve në aspektin e sigurisë në punë*. - Sigurimi i kushteve për pjesëmarrjen e punëtorëve në qeverisjen korporative, bëhet edhe me sigurimin e të drejtave të punëtorëve nga aspekti i sigurimit social, i cili në Kosovë është bërë me dispozitat e Ligjit për sigurinë dhe shëndetin në punë²⁴⁶.

Sipas këtij ligji, “Punëdhënësi është përgjegjës për të krijuar kushtet e punës të

²⁴⁴ Sigurimi dhe mbrojtja e këtyre të drejtave bëhet me dispozitat e Ligjit të punës, nr. 03/L-212, i datës 1 nëntor 2010

²⁴⁵ Neni 5 dhe 6 I Ligjit të punës së Kosovës.

²⁴⁶ Ligji për sigurinë dhe shëndetin në punë Nr. 04/L-161.

sigurta dhe të shëndetshme në të gjitha aspektet e punës. Punëdhënësi është i detyruar që të mbulojë të gjitha shpenzimet për kurimin e të punësuarit që ka pësuar lëndim në punë apo sëmundje profesionale, nëse të punësuarit nuk i ka siguruar në ndonjë kompani të sigurimeve në pikëpamje shëndetësore. Sa i përket sigurisë në punë, unëdhënësi me qëllim të parandalimit të rreziqeve eventuale, është i detyruar që në vazhdimësi, të bëjë vlerësimin e hollësishëm mbi rreziqet për secilën vend të punës²⁴⁷. Gjithashtu, punëdhënësi është i detyruar të udhëhiqet nga parimi i trajtimit të barabartë në marrjen e masave të sigurisë dhe shëndetit në punë për të gjithë të punësuarit.²⁴⁸

6.1.1.4. Mbrojtja nga cenimi i të drejtave në marrëdhëniet e punës. - Me këtë zgjidhje ligjore, ligjvënësi kosovar ka pasur për qëllim të ndalojë veprimet e kundërligjshme, të cilat cenojnë barazinë dhe të drejtat e punëtorit me rastin e themelimit të marrëdhënies së punës, realizimin e të drejtave nga puna, si dhe të drejtat me rastin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës. Me sigurimin dhe garantimin e të drejtave të përmendura, mbrohen të drejtat e punëtorëve, parakusht ky i domosdoshëm për përmirësimin edhe të qeverisjes korporative, pasi që punëtorët janë ndër pretendentët shumë me rëndësi në qeverisjen e korporatave²⁴⁹.

6.1.1.5. Mbrojtja nga cenimi i të drejtave të punësimit dhe pa punësisë. - Me garantimin dhe mbrojtjen e të drejtave të përmendura, ka për qëllim të ndalojë veprimet e kundërligjshme të cilat cenojnë barazinë dhe të drejtat e punëtorëve me rastin e

²⁴⁷ Trupa Ekzekutive e Inspektoratit të punës, me aktvendimin nr.13/2016 të datës 15.01.2016 shqiptoi masën ndëshkimore për shkak se kompania nuk kishte bërë vlerësimin e hollësishëm mbi rreziqet për secilën vend të punës dhe si pasojë e kësaj në një aksident pune, një punëtor kishte humbur jetën.

²⁴⁸ Neni 5, i Ligjit për sigurinë dhe shëndetin në punë Nr. 04/L-161.

²⁴⁹ Neni 221, i Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

themelimit të marrëdhënies së punës, realizimin e të drejtave nga puna si dhe të drejtat me rastin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës²⁵⁰.

Një zgjidhje e tillë, ka bazën juridike edhe në shumë instrumente ndërkombëtare, me të cilat sigurohet barazia dhe trajtimi i njëjtë me rastin e themelimit të marrëdhënies së punës dhe punësimit në përgjithësi²⁵¹. Gjithashtu, është sanksionuar dhe garantuar edhe mbrojtja e pozitës së punëtorit gjatë kohës së papunësisë dhe në momentin e punësimit. Me këtë garantim dhe mbrojtje të të drejtave të punëtorëve, gjithashtu janë siguruar parakushte për përmirësimin e qeverisjes korporative.

6.1.1.6. Mbrojtja nga cenimi i të drejtës për grevë. - Me këto dispozita mbrohet e drejta e punëtorëve për të paraqitur pakënaqësitë e tyre lidhur me punën, nëpërmjet grevave të organizuara. Me këtë mbrohet njëra nga të drejtat themelore të punëtorëve, e cila ndikon në qeverisjen e mirë të korporatave, pasi që punëdhënësit duke respektuar të drejtat e punëtorëve të shprehura edhe përmes grevës, janë të shtyrë që të respektojnë të drejtat e punëtorëve dhe me rastin e marrjes së vendimeve në organet qeverisëse të korporatës, doemos të kujdesen që vendimet, të mos merren në dëm të interesave të punëtorëve.²⁵²

6.1.1.7. Mbrojtja nga cenimi i të drejtave nga sigurimi social. – Mbrojtja e këtyre të drejtave të punëtorëve, siguron punëtorët që t'i realizojnë dhe të mos u cenohen të drejtat e garantuara nga sigurimi social. Gjithashtu, edhe me këtë mbrojtje, sigurohet njëra nga të drejtat themelore të punëtorëve, e cila krijon kushtet elementare të

²⁵⁰ Po Aty, Neni 222.

²⁵¹ Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut, neni 14

²⁵² Neni 224, i Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

punëtorëve për pjesëmarrje dhe veprim në qeverisjen e mirë të korporatave²⁵³.

6.1.2. Konsumatorët dhe banorët rezident dhe roli i tyre në qeverisjen korporative

6.1.2.1. *Të drejtat e konsumatorëve.* - Ligji për mbrojtjen e konsumatorit²⁵⁴, “...është i zbatueshëm për çdo konsumator, i cili ka vendbanim në Republikën e Kosovës, si dhe personave të tjerë jo rezident. Ky ligj zbatohet për rregullimin e marrëdhënieve ndërmjet konsumatorëve, nga njëra anë, dhe prodhuesve, shitësve, furnizuesve, ofruesve të shërbimeve nga ana tjetër. E gjithë kjo, ka për qëllim mbrojtjen e konsumatorit nga praktikat e padrejta në tregun e mallrave dhe të shërbimeve”²⁵⁵. Nga kjo arsye mund të themi se në Kosovë, janë të garantuara të drejtat themelore të konsumatorëve.

Në vijim, vlen të theksohet e drejta për të mbrojtur interesat ekonomike të konsumatorit, si dhe të drejtën për të mbrojtur, nga rreziku, jetën, shëndetin dhe pronën e konsumatorit. Më tutje, është shumë me rëndësi të theksohet e drejta për mbrojtje ligjore të konsumatorit, e cila përfshinë të drejtën për t’u ankuar, të drejtën për kompensim në raste të caktuara edhe të drejtën për dëmshpërblim.

E drejta e konsumatorit për informim dhe edukim gjithashtu zë një vend të rëndësishëm në mesin e të drejtave të konsumatorit, me të cilën konsumatorët edukohen për t’i realizuar dhe mbrojtur të drejtat e garantuara. Dhe me qëllimin e realizimit të të drejtave të përmendura, konsumatorit i është garantuar e drejta për shfrytëzimin e shërbimeve publike, si dhe e drejta e organizimit në shoqata të konsumatorit për të

²⁵³Po Aty, Neni 226.

²⁵⁴ Ligji për mbrojtjen e konsumatorit, nr.04/L-121.

²⁵⁵ Neni 2, i Ligjit për mbrojtjen e konsumatorit.

mbrojtur interesat e tyre, ashtu si edhe të drejta të tjera të garantuara me ligj. Konsiderojmë se në juridiksionin e Kosovës ekziston një rregullore ligjore mjaft e avancuar në këtë aspekt, e cila njëkohësisht siguron mundësinë që konsumatorët si aktor ekstern-të jashtëm të qeverisjes korporative, të jenë faktor me ndikim në qeverisjen korporative.

Krijimi i këtyre kushteve ligjore, ndikon që korporatat të harmonizojnë sjelljet e tyre korporative në pajtim me interesat dhe kërkesat edhe të konsumatorëve, si aktorë të jashtëm-ekstern, por shumë me rëndësi në qeverisjen korporative.

6.1.2.2. Banorët rezident dhe qeverisja korporative. - Të gjithë banorët në Kosovë, si subjekt i pa përcaktuar i qeverisjes së korporatave, të drejtat e tyre ndaj korporatave i realizojnë përmes dispozitave ligjore të Ligjit për mbrojtjen e mjedisit²⁵⁶.

Ligji rregullon sistemin e integruar për mbrojtjen e mjedisit, zvogëlimin e rrezikut për ndotjen e mjedisit, jetën dhe shëndetin e njeriut sipas konceptit të zhvillimit të qëndrueshëm. Ligji, gjithashtu, synon: “shfrytëzimin racional të resurseve natyrore dhe kufizimin e emisioneve shkarkimeve të ndotjes së mjedisit, parandalimin e dëmtimit, rehabilitimin dhe përmirësimin e mjedisit të dëmtuar. Më tej, si pikësynim mbetet përmirësimi i kushteve mjedisore, që lidhen me cilësinë e jetës dhe mbrojtjen e shëndetit të njeriut, ruajtjen dhe mirëmbajtjen e resurseve natyrore, të përtëritshëm dhe të papërtëritshëm, si dhe menaxhimin e qëndrueshëm të tyre. Përpos kësaj, janë siguruar kushte për bashkërendimin e veprimtarive shtetërore për të përmbushur

²⁵⁶ Ligjit për mbrojtjen e mjedisit, Nr. 03/L-025

kërkesat për mbrojtjen e mjedisit, duke siguruar bashkëveprimin rajonal dhe ndërkombëtar në fushën e mjedisit dhe duke bërë edhe nxitjen dhe pjesëmarrjen e publikut në veprimtaritë për mbrojtjen e mjedisit. Me garantimin e këtyre të drejtave, si qëllim i fundit strategjik mbetet që të sigurohet se zhvillimi në Kosovë është i qëndrueshëm në mënyrë që dheu, ajri, uji dhe burimet e jetesës të mbrohen dhe ruhen në të mirë të gjeneratave të ardhshme, të promovohen masa regjionale dhe ndërkombëtare për ruajtje, mbrojtje dhe përmirësim të cilësisë së mjedisit, si dhe të bëhet përshtatja e ligjeve, akteve nënligjore, procedurave dhe institucioneve të Kosovës me legjislacionin e Bashkimit Evropian, kushte këto të cilat janë të detyruara të respektojnë edhe korporatat, gjatë ushtrimit të aktiviteteve të tyre biznesore”.²⁵⁷

Nga përmbajtja e asaj që u theksua më lart, rezulton se, në Kosovë ekziston një rregullore mjaft e avancuar në këtë aspekt, e cila njëkohësisht siguron mundësinë që banorët rezident të jenë faktor me ndikim në qeverisjen korporative. Krijimi i këtyre kushteve ligjore, ndikon që korporatat të harmonizojnë sjelljet e tyre korporative në pajtim me interesat dhe kërkesat edhe të banorëve, si aktorë të jashtëm-ekstern, por shumë me rëndësi në qeverisjen korporative.

6.2. Përgjegjësia sociale e korporatave në Shqipëri

6.2.1. Punëtorët dhe roli i tyre në qeverisjen korporative në Shqipëri

Në përpjekje për të siguruar mbrojtjen e të drejtave të punëmarrësve, si dhe pjesëmarrjen e tyre në qeverisjen korporative, Ligji për tregtarët dhe shoqëritë Tregtare i Republikës së Shqipërisë, ka përcaktuar edhe të drejtën e punëtorëve për formimin e

²⁵⁷Po aty, Neni 2.

Këshillit të punëmarrësve. Kështu, këshilli i punëmarrësve ka të drejta dhe detyrime, të cilat janë të drejtuara nga monitorimi i zbatimit të ligjeve, të kontratave kolektive dhe dispozitave të statutit, si dhe përfaqëson interesat e punëmarrësve të shoqërisë. Këshilli merr pjesë në vendimmarrjen për shfrytëzimin e fondeve të posaçme dhe të aktiveve të tjera të shoqërisë, të parashikuara në kontratat kolektive dhe në statut, si dhe për shpërndarjen e pjesës së fitimeve, që asambleja e përgjithshme vendos t’ia shpërndajë punëmarrësve²⁵⁸. “Përfaqësuesi ligjor i shoqërisë, ka për detyrë që këshillin e punëmarrësve ta mbajë të informuar për veprimtaritë dhe ecurinë e shoqërisë tregtare e në mënyrë të veçantë për efektet e politikave të shoqërisë për kushtet e punës, pagat, sigurinë në punë, ndarjen e mundshme të fitimeve, ndryshimin e statusit, sistemin e pensioneve të shoqërisë, ristrukturimin dhe pjesëmarrjen e shoqërisë në shoqëri të tjera”. Me këtë përcaktim, ligjvënësi e ka detyruar përfaqësuesin e shoqërisë, që këshillin e punëmarrësve ta mbajë të informuar për të gjitha çështjet, të cilat kanë të bëjnë në mënyrë direkte ose indirekte me interesat e punëtorëve. Këshilli i punëmarrësve, gjithashtu, mund të informojë veten drejtpërdrejt për performancën e shoqërisë tregtare dhe të sigurojë qasje në librat e dokumentet e shoqërisë, duke u dhënë mendime dhe sugjerime organeve drejtuese për çështjet e përmendura. Në rast se nuk pranohen mendimet dhe sugjerimet e këshillit të punëmarrësve, përfaqësuesi ligjor i korporatës, është i detyruar ta informon këshillin e punëmarrësve për arsyet e mospranimit të mendimeve dhe të sugjerimeve të këtij këshilli. Statuti i korporatës, në asnjë rast nuk mund ta pengojë apo kufizojë ushtrimin e të drejtave të përmendura më lartë, me përjashtim të rasteve kur për një kufizim të tillë është rënë dakord ndërmjet

²⁵⁸ Shih neni 19, i Ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare i Shqipërisë.

përfaqësuesit ligjor dhe këshillit të punëmarrësve, për një sistem ekuivalent informimi. Nëse përfaqësuesi ligjor i korporatës nuk pranon të japë informacionet e përmendura, këshilli i punëmarrësve, brenda dy javëve pas refuzimit, mund t'i drejtohet gjykatës përkatëse për të marrë një vendim detyrues për informimin. Këshilli i punëmarrësve i raporton asamblesë së punëmarrësve të shoqërisë, për veprimtaritë e veta, të paktën dy herë në vit ose sa herë e kërkon shumica e punëmarrësve. Kostot e zgjedhjes dhe të funksionimit të këshillit të punëmarrësve, mbulohen nga shoqëria tregtare.”²⁵⁹ Me këto rregulla është siguruar edhe mundësia e pjesëmarrjes së punëmarrësve në administrimin e shoqërive aksionare, në mënyrë që: “Përfaqësuesi ligjor i shoqërisë tregtare dhe këshilli i punëmarrësve mund të bien dakord që, ky i fundit, të emërojë persona për të përfaqësuar”.²⁶⁰

Më tutje, Kodi i punës së Republikës së Shqipërisë, me dispozita taksative ka rregulluar të drejtat e punëmarrësve, duke siguruar kushte për lirinë e punës dhe ndalimin e punës së detyruar. Dhe në fund, gjithashtu është e garantuar edhe lirina sindikale, sipas së cilës punëtori në asnjë rrethanë, nuk mund të pësojë si rezultat i angazhimit të tij në organizata sindikale²⁶¹.

6.2.1.1. Detyrimi i besnikërisë së punëmarrësit ndaj punëdhënësit. - Punëmarrësit janë të detyruar që të ruajnë me besnikëri interesat e ligjshme të punëdhënësit. Gjatë kohës deri sa kontrata është e vlefshme, punëtorët nuk mund të ushtrojnë punë, të cilat e dëmtojnë punëdhënësin ose të cilat në çfarëdo forme i bëjnë konkurrencë punëdhënësit.

²⁵⁹ Shih neni 20, i Ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare i Shqipërisë.

²⁶⁰ Po aty, Shih nenin 21.

²⁶¹ Shih nenin 10, Kodi i punës i Shqipërisë.

Gjithashtu punëmarrësi ka për detyrim që të ruaj sekretin e fabrikimit dhe të veprimtarisë. Përfundimisht nga kjo që u tha më lartë, “punëmarrësi ka të drejtë të denoncojë në organet kompetente, veprat penale, shkeljet e legjislacionit të punës ose të kontratës, për të cilat ai ka dijeni”.²⁶²

6.2.1.2. Përgjegjësia e punëmarrësit për shkeljen e besnikërisë. - Punëmarrësi përgjigjet ndaj punëdhënësit për dëmin që i shkakton kur shkel detyrimet kontraktuale me dashje ose nga pakujdesia. Shkalla e kujdesit, që duhet të tregojë punëmarrësi në punë, varet nga njohuritë teknike, të nevojshme për të kryer punën e caktuar, duke pasur parasysh aftësitë dhe cilësitë e punëmarrësit, që punëdhënësi i njihet ose duhet t’i kishte njohur. Dëmi, që lidhet në mënyrë të qenësishme me kryerjen e punës, përballohet nga punëdhënësi.

Dëmi përfshin dëmin real dhe fitimin e munguar. Gjykata mund të shkarkojë plotësisht ose pjesërisht punëmarrësin nga detyrimi për shpërblimin e dëmit, kur: punëmarrësi ka vepruar me pakujdesi të lehtë; punëdhënësi, në organizimin dhe kontrollin e punës, bën të njëjtin gabim që lidhet me shkaktimin e dëmit; detyrimi për të zhdëmtuar plotësisht dëmin s’është i përballueshëm, duke pasur parasysh burimet e të ardhurave të punëmarrësit.²⁶³

6.2.1.3. Ndalimi i konkurrencës pas përfundimit të marrëdhënieve të punës.

- Punëmarrësi mbi 18 vjeç mund të zotohet me shkrim kundrejt punëdhënësit që, pas përfundimit të marrëdhënieve të punës, nuk do t’i bëjë atij konkurrencë në asnjë lloj

²⁶² Po aty, Neni 125.

²⁶³ Neni 126-127, Kodi i punës i Shqipërisë.

mënyre, veçanërisht nuk do të formojë një sipërmarrje konkurrençe, nuk do të punojë dhe nuk do të interesohet për të. Marrëveshja për ndalimin e konkurrencës është e vlefshme vetëm nëse raportet e punës i kanë dhënë mundësinë punëmarrësit të ketë dijeni për sekretet e fabrikimit ose të veprimtarisë së punëdhënësit dhe nëse përdorimi i këtyre sekreteve mund t'i shkaktojë punëdhënësit një dëm të rëndë. Punëdhënësi mund të kërkojë zbatimin e marrëveshjes për ndalimin e konkurrencës vetëm nëse i ofron punëmarrësit, gjatë periudhës së ndalimit, jo më pak se 75 për qind të pagës që ai do të merrte po të vazhdonte të punonte për punëdhënësin. Kur paga është e ndryshueshme, shpërblimi llogaritet mbi bazën e pagës mesatare të vitit të mëparshëm dhe indekssohet.²⁶⁴

6.2.1.4. Kufizimet dhe përfundimi i ndalimeve. - “Marrëveshja duhet të përcaktojë qartë ndalimin e konkurrencës për vendin, kohën dhe llojin e veprimtarisë, për të mos dëmtuar të ardhmen ekonomike të punëmarrësit. Afati i ndalimit nuk mund të jetë më shumë se një vit. Gjykata mundë të zvogëlojë elementet e sipërpërmendura për ndalimin e konkurrencës së tepruar, duke pasur parasysh të gjitha rrethanat e rastit. Ajo mban parasysh, veçanërisht, se shpërblimi i dhënë nga punëdhënësi e tejkalon minimumin e parashikuar të ndalimit të përmendur më lartë. “Ndalimi i konkurrencës merr fund në afatin e caktuar në marrëveshje. Pavarësisht nga afati i caktuar në marrëveshje, ndalimi i konkurrencës përfundon, nëse vërtetohet se punëdhënësi nuk ka më asnjë interes për vazhdimin e saj. Marrëveshja për ndalimin e konkurrencës nuk zbatohet kur punëdhënësi zgjidhë kontratën për shkaqe të pajustificuara ose kur punëmarrësi zgjidhë kontratën për një shkak të justifikuar, që lidhet me

²⁶⁴ Po aty, Neni 28.

punëdhënësin.”²⁶⁵

6.2.1.5. *Detyrime të përgjithshme të punëdhënësit.* - “Punëdhënësi respekton dhe mbrohet në raportet e punës, personalitetin e punëmarrësit. Ai duhet të parandalojë çdo qëndrim që cenon dinjitetin e punëmarrësit.

6.2.1.6. *Përgjegjësia e punëdhënësit.*- “Punëdhënësi për të parandaluar aksidentet dhe sëmundjet profesionale duhet të përcaktojë qartë rregullat e sigurimit teknik. Punëdhënësi, duhet të paguaj diferencën midis dëmit dhe shpërblimit që merr punëmarrësi nga sigurimet shoqërore, kur aksidenti ose sëmundja profesionale është pasojë e fajësisë së rëndë të punëdhënësit. Kur punëdhënësi nuk ka regjistruar punëmarrësin në sigurimet shoqërore, ai duhet të përballojë të gjitha shpenzimet që ka bërë punëmarrësi, si rezultat i aksidentit ose sëmundjes profesionale, si dhe të gjitha dëmet si pasojë e mosregjistrimit”.²⁶⁶

6.2.1.7. *E drejta e punëmarrësit për pjesëmarrje në rezultatet e korporatës dhe interesat në raste vonese.* - “Kur në bazë të kontratës, punëmarrësi ka të drejtë të përfitojë një shpërblim, në raport me rezultatin e shfrytëzimit, ky llogaritet mbi bazën e rezultatit vjetor, i përcaktuar në bazë të ligjit dhe veprimeve tregtare, përgjithësisht të pranuar. “Nëse palët bien dakord, punëdhënësi i jep punëmarrësit një shpërblim të veçantë mbi pagë, në fund të vitit, duke marrë parasysh cilësinë e punës së tij ose mbarëvajtjen e ndërmarrjes. Megjithatë, kur ai paguan një shpërblim vjetor tre vjet rresht pa rezerva të shprehura, punëdhënësi është i detyruar të vazhdojë pagesën edhe në të ardhmen. Në këtë rast, me përjashtim të rezervave të shprehura nga ana e

²⁶⁵ Neni 29-30, Kodi i punës i Shqipërisë.

²⁶⁶ Po Aty. Neni 39.

punëdhënësit, nëse marrëdhëniet e punës përfundojnë përpara momentit të përfitimit të shpërblimit, ky jepet përpjesëtimisht me kohën e punës së kryer”. “Në rast të pagesës së pagës me vonesë, përqindja vjetore e interesit është jo më pak se 10 për qind e inflacionit gjatë periudhës së vonesës”²⁶⁷.

6.2.2. Detyrat fiduciare ndaj kreditorëve

Mbrojtja e interesave të kreditorëve bëhet me dispozitat e LTSHTSH dhe dispozitat e Ligjit për falimentimin.²⁶⁸ Me këto ligje është vënë baza juridike për mbrojtjen e interesave të konsumatorëve, si një nga pretendentët në qeverisjen e korporatave.

6.2.3. Detyrat fiduciare ndaj konsumatorëve

Në Shqipëri, ekziston ligji për mbrojtjen e konsumatorëve²⁶⁹, qëllimi primar i të cilit, është “mbrojtja e interesave të konsumatorëve në treg, si dhe përcaktimi i rregullave dhe ngritja e institucioneve përkatëse për të mbrojtur të drejtat e konsumatorëve”²⁷⁰.

“Ky ligj përfshin të gjitha llojet e marrëdhënieve ndërmjet tregtarëve dhe konsumatorëve, që kanë të bëjnë me mallrat e konsumatorëve apo shërbimeve, përveç atyre që parashikohen në dispozitat e ligjeve të veçanta”.²⁷¹

²⁶⁷ Neni 113-114 dhe 120, Kodi i punës i Shqipërisë.

²⁶⁸ Ligji për falimentimin, Nr. 8901, datë 23.5.2002, I azhurnuar me: Ligjin Nr.9919, datë 19.5.2008 dhe Ligjin Nr.10 137, datë 11.5.2009.

²⁶⁹ Ligji për mbrojtjen e konsumatorëve, nr. 9902, datë 17.4.2008,.

²⁷⁰ Po aty, Neni 1.

²⁷¹ Po aty, Neni 2.

6.3. Përgjegjësia sociale e korporatave në Kroaci

6.3.1. Punëtorët dhe roli i tyre në qeverisjen korporative në Kroaci

6.3.1.1. *Një shënim i përgjithshëm mbi punonjësit në korporatat në Kroaci.* - Mbrojta e punëtorëve në Kroaci, garantohet me Ligjin e punës të Kroacisë²⁷², (LPKR). Është me rëndësi të theksohet fakti se, në nenin 2 të ligjit, janë të emërtuara 13 direktivat e Unionit European, të cilat kanë të bëjnë me mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve në punë, çka sipas ligjit janë të bartura dhe të inkorporuara në këtë ligj²⁷³. Gjithashtu, sipas dispozitave të këtij ligji është shpjeguar se është e detyrueshme paraqitja e raportimeve të rregullta, me të cilat korporata duhet të deklarohe lidhur me zbatimin e Direktivave të përmendura. Raporti bëhet me përmbajtjen dhe në afatet e përcaktuara me direktiva, gjë të cilën qeveria e Republikës së Kroacisë e ka marrë për obligimin, që lidhur me zbatimin e këtyre direktivave t'i raportojë Komisionit European.²⁷⁴

Në kreun I, me dispozitat e përgjithshme të këtij ligji janë rregulluar barazia gjinore, evidenca e punëtorëve të punësuar te punëdhënësi, regjistrimi elektronik i të dhënave të punëtorëve, detyrimet themelore dhe të drejtat nga marrëdhënia e punës, detyrimi për respektimin e dispozitave lidhur me marrëdhënien e punës dhe liria e kontraktimit.²⁷⁵

Në kreun II, nën numrin rendor 1, është rregulluar themelimi i marrëdhënies së punës, i cili përmban dispozita mbi lidhjen e kontratës për punë, kontratat e punës në kohë të pacaktuar dhe kohë të caktuar, kushtet e punës së punëtorëve të cilët punojnë në

²⁷² Zakon o radu NN 93/14- nga data, 07.08.2014.

²⁷³ Shih nenin 2 par.1, te Ligjit të Punës së Republikës së Kroacisë.

²⁷⁴ Neni 2, par.2, te Ligjit të Punës së Republikës së Kroacisë.

²⁷⁵ Po aty, Shih nenet 1-9.

bazë të kontratës së punës në kohë të caktuar, format e kontratave të punës, përmbajtja e detyruar e përmbajtjes së kontratës së shkruar të punës, përkatësisht vërtetimit të shkruar për lidhjen e kontratës për punë, përmbajtja e detyruar e kontratës së shkruar të punës për punët e përhershme sezonale, përmbajtja e detyruar e kontratës së shkruar të punës për punët në vendet e ndara të punës, përmbajtja e detyruar e kontratës së shkruar të punës në rastin e dërgimit të punëtorit jashtë vendit, moshën më të ultë të punës, zotësinë afariste të të miturve për lidhjen e kontratës së punës, ndalimi i punës së të miturve në punë të caktuara, mbikëqyrja e punës së të miturve në punët e caktuara, kushtet e posaçme për lidhjen e kontratës së punës, detyrimin e punëtorit për ta njoftuar punëdhënësin për sëmundjen ose rrethana të tjera, të dhënat të cilat punëtorit nuk mund t'i kërkohej.²⁷⁶ Nën numrin rendor 2 të ligjit janë rregulluar çështje të cilat kanë të bëjnë me rregulloret e punës të punëdhënësi. Nën numrin rendor 3 janë përcaktuar mbrojtja e jetës, shëndetit dhe privatësisë, kurse nën numrin rendor 4 janë përcaktuar mbrojtja e shtatzënave, prindërve dhe adoptuesve.²⁷⁷

Më tej, në numrin rendor 5 është trajtuar mbrojtja e punëtorëve të paaftë për punë, përkohësisht ose në mënyrë të përhershme²⁷⁸. Më tej është rregulluar, punësimi i përkohshëm, puna provuese si dhe përgatitja dhe aftësimi për punë, koha e punës, pushimet, mundësitë tjera të rregullimit të kohës së punës, puna e natës, paga dhe kompensimi i pagës.²⁷⁹

Shpikjet dhe përparimet teknike, ndalimi i konkurrencës së punëtorit ndaj

²⁷⁶ Neni 10-25 të Ligjit të Punës së Republikës së Kroacisë.

²⁷⁷ Po aty, Nenet 26-36.

²⁷⁸ Po aty, Nenet 37-43.

²⁷⁹ Po aty, Nenet 44-97.

punëdhënësit, kompensimi i dëmeve, ndërprerja e kontratës së punës, realizimi i të drejtave dhe detyrimeve nga marrëdhënia e punës²⁸⁰, si dhe pjesëmarrja e punëtorëve në vendosje (këshilli i punëtorëve, tubimet e punëtorëve, përfaqësimit të punëtorëve në organet e punëdhënësit).²⁸¹

Kreu IV-VIII trajton marrëdhëniet kolektive të punës, shoqatat e punëtorëve dhe punëdhënësve, themelimi dhe regjistrimi i shoqatave, pasuria e shoqatave, funksionimi i shoqatave, pushimi i veprimit të shoqatave, kontratat kolektive, grevat dhe zgjidhja e kontesteve kolektive të punës si dhe këshilli ekonomik social.²⁸², mbikëqyrja e zbatimit të dispozitave të punës, dispozitat e posaçme, të cilat i referohen të drejtave të punëtorëve që zgjidhen për kryerjen e funksioneve publike, masat administrative dhe dispozitat kundërvajtëse, kundërvajtjet e lehta të punëdhënësit, kundërvajtjet e rënda të punëdhënësit dhe kundërvajtjet më të rënda të punëdhënësit, kundërvajtjet e sindikatës dhe të bashkësive të sindikatës të nivelit të lartë dhe kundërvajtjet e bashkësive të punëdhënësve dhe bashkimeve të punëdhënësve të niveleve të larta.²⁸³

Me këtë konsiderojmë se në Republikën e Kroacisë ekziston një platformë e duhur për mbrojtjen e interesave të punëtorëve, gjë e cila siguron kushtet elementare për pjesëmarrjen e punëtorëve në kuadër të qeverisjes së korporatave.

6.3.2. Detyrat fiduciare ndaj kreditorëve

Kërkesë për kompensimin e dëmit mund të paraqesin kreditorët e shoqërisë, nëse kërkesat e tyre nuk mund t'i përmbushin nga shoqëria. Në raport me kreditorët,

²⁸⁰ Po aty, Nenet 98-139.

²⁸¹ Po aty, Nenet 140-164.

²⁸² Po aty, Nenet 165-221.

²⁸³ Nenet 222-231, të Ligjit të Punës së Republikës së Kroacisë.

shoqëria detyrohet që të kompensojë dëmin, nuk mund të mënjanohet, në mënyrë që shoqëria të heqë dorë nga kërkesat ose për kërkesën të arrijë ujdinë e as mbi atë që veprimi është bazuar mbi vendimin e kuvendit të përgjithshëm. Nëse mbi shoqërinë është hapur procedura e likuidimit, për kohën sa zgjat kjo procedurë, e drejta e kreditorëve të shoqërisë ndaj anëtarëve të administratës realizohet në procedurën e likuidimit. Këto kërkesa parashkruhen për 5 vite. Si rrjedhojë e atyre që u theksuan më lartë, rezulton se në Republikën e Kroacisë ekziston një platformë e duhur për mbrojtjen e interesave të kreditorëve, dhe ndikimin e tyre në qeverisjen e korporatave.

6.3.3. Detyrat fiduciare ndaj konsumatorëve

Për mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve bën fjalë Ligji për mbrojtjen e konsumatorëve, qëllim kryesor i të cilit është “mbrojtja e të drejtave themelore të konsumatorëve gjatë blerjes së prodhimeve dhe shërbimeve, si dhe gjatë formave të tjera të sigurimit të prodhimeve dhe ushqimeve në treg, dhe: të drejtën në mbrojtjen e interesave ekonomike të konsumatorëve; të drejtën në mbrojtjen nga rreziqet për jetën, shëndetin dhe pasurinë; të drejtën për sigurinë juridike të konsumatorëve; të drejtën për informimin dhe edukimin e konsumatorëve; të drejtën për asociimin e konsumatorëve me qëllim të mbrojtjes së interesave të tyre; të drejtën për përfaqësimin e konsumatorëve dhe bashkëpjesëmarrjen e përfaqësuesve të konsumatorëve në punën e trupave të cilat vendosin çështje nga interesi i tyre²⁸⁴. Më tutje, praktika e pandershme

²⁸⁴ Neni 1, i Ligjit për mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve në Kroaci (Urednički pročišćeni tekst “Narodne novine”, broj 79/07, 125/07 - ispravak, 75/09 - Zakon o potrošačkom kreditiranju, 79/09, 89/09-ispravak i 133/09 - Zakon o platnom prometu).

afariste është trajtuar në kuadër të ligjit dhe në të gjitha rasteve kur aplikohen praktikat jo të ndershme afariste, të cilat tregtari i aplikon ndaj konsumatorit ose i shfrytëzon para, gjatë dhe pas lidhjes së punës juridike, lidhur me një produkt të caktuar. Ndalimi i praktikave jo të ndershme, është përcaktuar me normë imperative nga neni 108, ku në mënyrë shprehimore është përcaktuar, se: “Praktika jo e ndershme afariste është e ndaluar”. Nocioni i praktikës jo të ndershme afariste është përcaktuar gjithashtu me ligj, ashtu si janë përcaktuar dhe sanksionuar edhe praktikat mashtruese afariste si dhe praktika agresive afariste²⁸⁵.

Më tej, në ligj janë trajtuar dhe përcaktuar bartësit e mbrojtjes së konsumatorit, programi nacional për mbrojtjen e konsumatorit, si dhe edukimi i konsumatorit. Në fund janë trajtuar mbrojtja e të drejtave të konsumatorit (mbrojtja jashtëgjyqësore e të drejtave të konsumatorit dhe mbrojtja kolektive e interesave të konsumatorëve, padia për mbrojtjen e interesave kolektive të konsumatorëve, si dhe dispozitat kundërvajtëse për shkeljet e dispozitave të sanksionuara me ligjin e përmendur²⁸⁶.

6.4. Përfundimet nga kapitulli i gjashtë

Në kapitullin e gjashtë, në të cilin janë trajtuar: përgjegjësia sociale e korporatave dhe sigurimi i platformës ligjore për mbrojtjen e të drejtave të palëve të interesuara, pretendentëve ose aktorëve të tjerë, përkatësisht: punëtorëve, konsumatorëve, si dhe të banorëve, me vështirësi të posaçëm në krijimin e kushteve për pjesëmarrje në qeverisjen korporatave. Sa i përket krijimit të kushteve për pjesëmarrje

²⁸⁵ Shih nenet 107 dhe 109-115, i Ligjit për mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve në Kroaci.

²⁸⁶ Shih nenet 107-147, i Ligjit për mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve në Kroaci.

në qeverisjen e korporatave, përmes sigurimit të mbrojtjes së të drejtave të punëtorëve, si grup më i rëndësishëm i pretendentëve në qeverisjen e korporatave, në të tria sistemet janë analizuar dispozitat ligjore, të cilat i referohen ligjeve, përkatësisht, kodeve të punës si dhe mbrojtjes në punë.

Lidhur me krijimin e kushteve për pjesëmarrje e kreditorëve në qeverisjen e korporatave, përmes sigurimit të infrastrukturës ligjore për mbrojtjen e kreditorëve, kryesisht i jemi referuar ligjeve për shoqëritë tregtare, si dhe ligjeve për riorganizimin dhe falimentimin e personave juridik. Me këto dispozita ligjore, është siguruar pozita juridike e kreditorëve, si gjatë kohës së ushtrimit të veprimtarisë tregtare të korporatës, ashtu edhe pas likuidimit të saj, si dhe mundësia e ndikimit për pjesëmarrje në qeverisjen e korporatave. Edhe mbrojtja e investitorëve është siguruar me dispozitat e ligjeve për shoqëritë tregtare, kurse kur është fjala për investimet e huaja direkte, mbrojtja e këtyre investitorëve bëhet edhe me ligjin për investimet e huaja. Me këto dispozita, është siguruar pozita juridike e investitorëve si gjatë kohës së ushtrimit të veprimtarisë tregtare të korporatës, ashtu edhe pas likuidimit të saj, si dhe mundësia e ndikimit për pjesëmarrje në qeverisjen e korporatave .

Mbrojtja e konsumatorëve është siguruar me ligjet për mbrojtjen e konsumatorit, të cilat në mënyrë mjaft të detajuar kanë rregulluar mbrojtjen e këtij grupi shumë të rëndësishëm të pretendentëve në qeverisjen e korporatave. Me këto dispozita ligjore, është siguruar pozita juridike e konsumatorëve, si gjatë kohës së ushtrimit të veprimtarisë tregtare të korporatës, si dhe mundësia e ndikimit për pjesëmarrje në qeverisjen e korporatave. Mbrojtja e banorëve dhe e të gjithë rezidentëve, të cilët jetojnë në vendin ku vepron një korporatë, është mbrojtur përmes dispozitave të Ligjit

për mbrojtjen e natyrës dhe ligjeve të ngjashme, sipas së cilave, kjo kategori e pretendentëve të qeverisjes së korporatave, ka të drejtën e patjetërsueshme për ambiente të qëndrueshme dhe natyrë të pastër. Gjithashtu, me këto dispozita, është siguruar pozita juridike e banorëve për ndikimin e tyre dhe pjesëmarrje në qeverisjen e korporatave .

KAPITULLI VII: KODET E BRENÐËSHME DHE ROLI I TYRE NË QEVERISJEN E KORPORATAVE

7.1. Aplikimi i kodit të qeverisjes së korporatave në Kosovë

Kodet e qeverisjes së korporatave në Kosovë, njihen si dokumente të kohës së fundit, e të cilat tani kan filluar të gjejnë zbatim praktik në qeverisjen korporative. Ministria e zhvillimit Ekonomik - Njësia për politika dhe monitorim të ndërmarrjeve publike, ka publikuar Kodin e Etikës dhe Qeverisje Korporative për ndërmarrjet publike në Kosovë.²⁸⁷

Ky kod ka për qëllim përmirësimin e sistemit të qeverisjes së korporatave në ndërmarrjet publike në Kosovë, sipas udhëzimeve të OECD-së. Kodi në përmbajtjen e tij ka për qëllim të kultivojë llogaridhënien si dhe vlerësimin e performancës së ndërmarrjeve publike në vend. Në shpjegimin e terminologjisë sipas kodit, me qeverisje të korporatave, përpos tjerash “gjithashtu, përfshihen raportet në mes të disa grupeve të përfshira të interesit, si dhe qëllimeve për të cilat ndërmarrja udhëhiqet”. Gjithashtu, nga përmbajtja e kodit kuptohet se grupet kryesore të interesit, në ndërmarrjet publike janë: “njerëzit e Kosovës (të përfaqësuar nga qeveria), të punësuarit, konsumatorët, furnitorët dhe Bordi i Drejtorëve”.²⁸⁸

Sipas Kodit, parim kryesor i sjelljes etike është që: ndërmarrja (korporata) duhet të mbahet me besnikëri për interesa të aksionarëve, të punësuarve, për personat me të

²⁸⁷ http://www.trainkos.com/wp-content/uploads/2012/03/KODI-I-ETIKES-I_RIBOTUAR.pdf, shikuar për herë të fundit me 30.03.2016.

²⁸⁸ Kodi i përmendur, fq.8.

cilët ndërmarrja kontraktin marrëveshje si dhe, gjithashtu, për publikun e përgjithshëm, pasi ndërmarrja është në pronësi publike. Nga kjo shihet se me këtë qasje, aq sa i kushtohet vëmendje plotësimit dhe realizimit të interesave të aksionarëve, po aq vëmendje i kushtohet edhe plotësimit dhe realizimit të interesave të pretendentëve të tjerë, siç janë të punësuarit, konsumatorët, furnitorët etj. Kodi ka gjithsej 30 nene dhe përmbajtja e tij është e ndarë në tri pjesë.

Pjesa e parë, nenet 3-12 i dedikohet sjelljes etike që kërkohet nga çdo i punësuar, zyrtar dhe drejtor, e që ka të bëjë me: Librat dhe shënimet korporative, konfidencialitetin, komunikimet, përdorimin e aseteve të ndërmarrjes, konfliktet e interesit, mitmarrja dhe korrupsioni, politikat e biznesit, standardet për të drejtat e njeriut, interesat shoqërore dhe protokollat e tjera të punësimit.

Pjesa e dytë, nenet 13-29 i dedikohet qeverisjes korporative, dhe ka të bëjë me: politikat pronësore të qeverisë, objektivat dhe parimet e qeverisjes korporative, detyrat, përgjegjësit dhe autoriteti i Bordit, roli, detyrat dhe përgjegjësit e drejtorit, kryesuesi, drejtori i pavarur senior, sekretari i korporatës, komisioni i auditimit, komiteti i financave, komiteti për staf dhe shpërblime, komiteti për teknologji dhe hulumtime, takimet e bordit, kryeshefi ekzekutiv, menaxhmenti i ndërmarrjes, raportimi, vlerësimi i performancës dhe shpërblimet.

Pjesa e tretë, neni 30 i dedikohet mënyrës së implementimit të këtij kodi në praktikë. Në tërësi, kodi ka për qëllim që të jap shpjegim për standardin e sjelljes për një qeverisje të mirë të korporatave. Duhet theksuar se ky kod iu referohet vetëm ndërmarrjeve (korporatave) publike, të cilat sipas dispozitave të kodit janë të detyruara që sjelljet dhe veprimet e tyre t'i harmonizojnë me dispozitat e këtij kodi, përfundojmë

se një iniciativë e tillë duhet të ndërmerret sa më parë edhe për korporatat në pronësi private.

7.2. Aplikimi i kodit të qeverisjes së korporatave në Shqipëri

Drejtoria e politikave të konkurrueshmërisë së ekonomisë në Republikën e Shqipërisë, e mbështetur nga ekspertët ndërkombëtar të IFC-së, ka publikuar kodin e drejtimit të brendshëm të shoqërive tregtare²⁸⁹, për të cilin është thënë se: “është i mbështetur në praktikat më të mira ndërkombëtare.” Në fillim, kodi është emërtuar si: Kodi i drejtimit të brendshëm të shoqërive aksionare jo të regjistruara në bursë. Kodi është i mbështetur në udhëzuesin dhe parimet për drejtimin e brendshëm, për shoqëritë në Europë, jo të regjistruara në bursë - një nismë e “ecoDa”²⁹⁰.

Kodi i përmendur ka për qëllim të tregojë vetëm praktikën e mirë për shoqëritë në Shqipëri, të cilat nuk janë të regjistruara në bursë me synim ndërtimin e një kuadri të praktikave më të mira, që duhet të jenë shumë më lart se kërkesat ligjore minimale. Kodi nuk paraqet një rregullore të cilën janë të detyruara ta zbatojnë shoqëritë tregtare. Po kështu, nuk është as një legjislacion fakultativ në lidhje me të cilin shoqëritë do të duhet të raportojnë nëse e zbatojnë apo jo, apo të shpjegojnë përse nuk e zbatojnë (sipas parimit “zbato ose shpjego”). Përkundrazi, kjo është një pamje e përgjithshme e

²⁸⁹ http://www.ecgi.org/codes/documents/cg_code_unlisted_companies_albania_14apr2008_al.pdf, shikuar për herë të fundit, me 10.08.2015, ora 14,45h.

²⁹⁰ “ecoDa, the European Confederation of Directors' Associations” (Konfederata Europiane e Shoqatave të Anëtarëve të Këshillave të Administrimit), është shoqatë jofitimprurëse e cila vepron si “zëri evropian i anëtarëve të këshillave drejtues”, dhe është aktive prej muajit mars 2005, me seli në Bruksel. Për më shumë informacion, mund të shihni hapësirën në internet: www.ecoda.org.

praktikave më të mira në lidhje me drejtimin e brendshëm të shoqërive jo të regjistruara në bursë, siç janë në momentin e hartimit të këtij kodi, dhe synon të shërbejë si material mbështetës dhe frymëzues për shoqëritë tregtare shqiptare, që këto të fundit të zhvillojnë një kuadër të shëndoshë të drejtimit të brendshëm. Kodi i Drejtimit të Brendshëm të Shoqërive Tregtare në Shqipëri, është hartuar nga ekspertë ndërkombëtarë të International Finance Corporation (IFC). Një kontribut të veçantë për përshtatshmërinë e Kodit me legjislacionin e shoqërive tregtare dhe legjislacionin vendas në tërësi, kanë dhënë edhe ekspertët ndërkombëtarë dhe vendas të GIZ-it.²⁹¹

Nga analiza e përmbajtjes së Kodit, rezulton se kodi është i ndarë në dy pjesë. Në pjesën e parë të këtij kodi janë përfshirë 14 parime, të cilat vlejnë për shoqëritë aksionare jo të regjistruara në bursë. Nga ato janë përcaktuar nëntë (parimet 1-9), parime të zbatueshme për të gjitha shoqëritë aksionare jo të regjistruara në bursë.

Parimi i parë i referohet nevojës që aksionarët e shoqërisë të ngrenë kuadrin e duhur themelues dhe drejtues të shoqërisë. Sipas parimit të dytë, shoqëria duhet të bëjë përpjekje për të krijuar një këshill të efektshëm, i cili do të mbajë përgjegjësi solidare për suksesin afatgjatë të shoqërisë. Në parimin e tretë është përcaktuar se madhësia dhe përbërja e këshillit duhet të pasqyrojë shkallën dhe kompleksitetin e shoqërisë. Në parimin e katërt, këshilli duhet të mbledhet rregullisht në mënyrë të mjaftueshme për të përmbushur detyrimet e veta, dhe duhet të marrë informacionet e duhura në kohë të duhur. Sipas parimit të pestë, nivelet e shpërblimit të punës duhet të jenë të mjaftueshme për të tërhequr, mbajtur dhe motivuar anëtarët administrator dhe joadministrator të këshillit, me cilësitë e nevojshme për ta drejtuar me sukses shoqërinë,

²⁹¹ Kodi i drejtimit të brendshëm të shoqërive tregtare , fq.4.

kurse individët nuk duhet të kenë kompetencë për vendosjen e pagës së tyre. Me qëllimin e zbatimit të këtij kriteri është përcaktuar se, mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të këshillit duhet ta aprovojnë aksionarët. Në parimin e gjashtë është përcaktuar se këshilli është përgjegjës për kontrollin mbikëqyrës të risqeve dhe duhet të mbajë një kontroll të shëndoshë të brendshëm për t'i mbrojtur interesat e shoqërisë dhe investimet e aksionarëve. Parimi i shtatë i referohet dialogut midis këshillit dhe aksionarëve, mbështetur në kuptimin e njëjtë të objektivave dhe në këtë aspekt, këshilli ka përgjegjësinë solidare për t'u kujdesur për zhvillimin e një dialogut të kënaqshëm me të gjithë aksionarët. Sipas parimit të tetë, të gjithë anëtarët e këshillit duhet të ndjekin një instruktim fillestar për t'u anëtarësuar në këshill dhe duhet të përditësojnë dhe rifreskojnë njohuritë rregullisht. Dhe në fund, sipas parimit të nëntë, shoqëria e kontrolluar nga një familje duhet të ngrejë mekanizma familjare të drejtimit të brendshëm, të cilat nxisin bashkërendimin dhe mirëkuptimin reciprok midis anëtarëve të familjes, si edhe t'i organizojë marrëdhëniet ndërmjet drejtimit të aktiviteteve tregtare të familjes dhe drejtimit të shoqërisë. Sa i përket pesë parimeve (parimet 9-14) të zbatueshme për shoqëritë aksionare të mëdha dhe/ose komplekse, jo të regjistruara në bursë, ato i referohen çështjeve si në vijim; Sipas parimit të dhjetë: Duhet të ketë një ndarje të qartë të përgjegjësisë në kryesinë e shoqërisë ndërmjet drejtimit të këshillit dhe drejtimit të aktiviteteve tregtare të shoqërisë. Gjithashtu, në këtë parim është përcaktuar se asnjë individ i vetëm nuk duhet të ketë kompetenca të papenguara vendimmarrje. Sipas parimit të njëmbëdhjetë, këshilli duhet të ketë anëtarë me gërshetimin e aftësive dhe përvojës. Asnjë person i vetëm (apo asnjë grupim i vogël individësh) nuk duhet të mbizotërojë në vendimmarrjen e këshillit. U duhet kushtuar vëmendje e duhur

përparësive të larmisë në këshill, duke përfshirë edhe përbërjen gjinore. Sipas parimit të dymbëdhjetë: Këshilli duhet të ngrejë komitetet e duhura të këshillit, për të mundësuar një përmbushje më të efektshme të detyrave.

Sipas parimit të trembëdhjetë: Këshilli duhet të kryejë një vlerësim periodik të performancës së vet dhe të performancës së çdo anëtarit të tij. Dhe sipas parimit të katërbëdhjetë: Këshilli duhet të paraqesë një analizë vlerësuese të ekuilibruar dhe të kuptueshme, të gjendjes dhe të ardhmes së shoqërisë tregtare, për grupet e interesit, dhe të krijojë një program të përshtatshëm për angazhimin e grupeve të interesit. Në pjesën e dytë të kodit, janë shtjelluar të gjitha këto parime.²⁹²

7.3. Aplikimi i kodit të qeverisjes së korporatave në Kroaci

Agjencia kroate për mbikëqyrjen e shërbimeve financiare²⁹³, ka publikuar Kodin e qeverisjes korporative (*Kodeks korporativnog upravljanja*)²⁹⁴. Kodi ndahet në pesë pjesë.

Pjesa e parë i referohet dispozitave hyrëse ku janë dhënë parimet themelore të kodit, si: transparenca në punë, procedurat e përcaktuara qartë për punën e këshillit mbikëqyrës, drejtorisë si dhe organeve dhe strukturave tjera të cilat marrin vendime, largimit të konflikteve të interesit, përcaktimi i kontrollit të brendshëm dhe përcaktimit të përgjegjësisë. Kodi dhe rekomandimet e tij janë të bazuara në parimin “VEPRO OSE

²⁹² Po aty fq.5 dhe6.

²⁹³ Hrvatska agencija za nadzor finansijkih usluga-HANFA (përkthim i autorit)

²⁹⁴ <http://www.hanfa.hr/getfile/6627/Kodeks%20korporativnog%20upravljanja.pdf>,

shikuar me

SHPJEGO”. Nga parimet e kodit, “shoqëritë janë të detyruara që në formularin e posaçëm (pyetësin vjetor i cili është pjesë përbërëse e kodit) të tregojnë nëse i janë përmbajtur rekomandimeve të kodit apo jo. Një qëndrim i tillë është në harmoni me Direktivat e UE-së dhe të drejtën komunitare²⁹⁵. Në situatën kur shoqëria nuk i është përmbajtur rekomandimeve të kodit, shoqëria është e detyruar që në pyetësin vjetor të arsyetojë se përse ka ardhur deri te mos zbatimi ose largimi nga rekomandimet”²⁹⁶.

Pjesa e dytë e kodit, i referohet bartësve të qeverisjes së korporatave. Kreu i parë në kuadër të kësaj pjese i referohet aksionarëve dhe kuvendit të përgjithshëm, i cili fillimisht trajton pozitën e barabartë dhe mbrojtjen e të drejtave të aksionarëve. Nën-kreu dy i kësaj pjese i referohet kuvendit të përgjithshëm të aksionarëve, në të cilën kryesisht janë përcaktuar: mënyra e thirrjes së kuvendit të përgjithshëm, e drejta e bashkëveprimit në kuvendin e përgjithshëm, kushtet për bashkëveprim, rendi i ditës, të autorizuarit, shfrytëzimi i teknologjisë bashkëkohore të komunikimit, vendimet me rëndësi si dhe pagesa e fitimit (dividendët). Nën-kreu i tretë, kryesisht i referohet kërkesave lidhur me raportimet të cilat i bëhen kuvendit të përgjithshëm, që shpjegohen përmes: raportimeve që bënë Këshilli Drejtues ose Këshilli Mbikëqyrës, Raporti vjetor për gjendjen e shoqërisë dhe publikimin e vendimeve.

Kreu i dytë, i referohet drejtorisë dhe trupave mbikëqyrëse. Në nën-kreun një të këtij kreu, flitet për Këshillin mbikëqyrës, ku janë të përcaktuara kriteret për emërimin e anëtarëve të këshillit mbikëqyrës, përbërja e këshillit mbikëqyrës, detyrat dhe

²⁹⁵ Shih për këtë, Direktivën e UE-së 2006/46/EC; <http://eur-lex.europa.eu/eli/dir/2006/46/oj>,

²⁹⁶ Burimi i përmendur fq.6.

përgjegjësitë, kohën e nevojshme për kryerjen e detyrave në këshillin mbikëqyrës, konfliktin e interesit, raportimin për konfliktet e interesit, shpërblimet, raportin karshi administratës, punët në mes të palëve të ndërlidhura, ndalimin e konkurrencës, kontratat në mes të anëtarëve të këshillit mbikëqyrës dhe shoqërisë, komisionet dhe trupat punuese. Lidhur me komisionet, janë përcaktuar; komisioni për emërime, komisioni për shpërblime, komisioni për revizion. Më tutje janë përcaktuar rregullat procedurale për mbledhjet e këshillit mbikëqyrës, anëtarësimi në këshillin mbikëqyrës, drejtues ose drejtorinë e shoqërisë tjetër, arsimimin e anëtarëve të këshillit mbikëqyrës dhe vlerësimin e punës. Nën-kreu i dytë, i referohet këshillit drejtues, ku janë përcaktuar rregullat për zgjedhjen ose emërimin e anëtarëve të këshillit drejtues, detyrat dhe përgjegjësitë, drejtorët ekzekutiv, raportin e këshillit drejtues dhe drejtorëve ekzekutiv, kohën e domosdoshme për kryerjen e punëve në këshillin drejtues dhe konfliktet e interesit. Gjithashtu janë trajtuar; raportimi për konfliktet e interesit, shpërblimet, punët në mes të palëve të ndërlidhura, ndalimi i konkurrencës, kontratat në mes të anëtarëve të këshillit drejtues dhe shoqërisë, komisionet, anëtarësimi në këshillat mbikëqyrës dhe drejtuese të shoqërive të tjera, arsimi i anëtarëve të këshillit drejtues dhe vlerësimi i punës.

Nën-kreu i tretë i referohet administratës së korporatës, ku flitet për detyrat dhe përgjegjësitë, përbërja, shpërblimet dhe struktura dhe metodat e përcaktimit dhe publikimit të tyre, përgjegjësinë, konfliktin e interesit, punët në mes shoqërisë dhe anëtarëve të drejtorisë, ndalimin e konkurrencës, anëtarësia në këshillat mbikëqyrës dhe drejtuese të shoqërive tjera, raportimi për konfliktin e interesit, raportin me këshillin mbikëqyrës, përgjegjësitë shtesë kur shoqëria është pjesë e shoqërisë koncern.

Pjesa e tretë i është përkushtuar revizionit dhe mekanizmave të kontrollit intern. Kreu i parë i kësaj pjese i referohet revizorëve të jashtëm. Kreu i dytë i kësaj pjese i referohet revizorëve të brendshëm.

Pjesa e katërt i referohet transparencës dhe publicitetit të afarizmit. Kreu një i kësaj pjese i referohet shpalljeve publike, fakteve materiale, informacioneve të privileguara dhe raporti financiar, raporteve vjetore, gjashtëmujore dhe tremujore financiare, kalendari i ngjarjeve të rëndësishme, strukturën e aksioneve, aksionet e përbashkëta, aksionet e anëtarëve të këshillit mbikëqyrës dhe drejtues dhe faktorët e rrezikut.

Kreu i dytë i referohet raporteve me investitorët, strategjia, shfrytëzimi i internetit dhe bartësit e interesit.

Pjesa e pestë i referohet zbatimit të kodit të qeverisjes korporative, çka duhet të bëhet përmes pyetësorit vjetor, të cilin korporatat duhet ta bëjnë çdo vit, kurse ky pyetësor është pjesë përbërëse e këtij kodi (Kodit për qeverisjen e korporatave). Pyetësi përmban 68 pyetje të cilave korporata duhet t'iu përgjigjet e të cilat kanë lidhje me pjesën përmbajtjesore të këtij kodi.

Këshilli mbikëqyrës përkatësisht këshilli drejtues i shoqërisë aksionare, aksionet e të cilës shiten në tregun e rregulluar, janë të obliguar që të sigurohen se administrata, përkatësisht drejtorët ekzekutivë të shoqërisë, në pjesën e posaçme të raportit vjetor për gjendjen e shoqërisë, të theksojnë së paku: të dhënat për kodin e qeverisjes korporative, i cili e obligon, ose për kodin e qeverisjes korporative, të cilin shoqëria vullnetarisht e zbaton, ose për praktikën e qeverisjes korporative, të cilën e aplikon jashtë asaj që kërkohet me dispozita, si dhe të dhënat ku janë publikuar kodet përkatëse të qeverisjes

